

BANKA E SHQIPËRISË

SISTEMI BANKAR SHQIPTAR PROBLEME TË ZHVILLIMIT TË TIJ Analizë vrojtimi

Dr. Shkëlqim Cani
Prof. Dr. Marta Muço
Teuta Baleta[?]

GUSHT 2000

[?] Dr. Shkëlqim Cani është Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Prof. Dr. Marta Muço është Shefe e Kabinetit të Guvernatorit. Znj. Teuta Baleta është Drejtore e Departamentit të Kërkimeve dhe Publikimeve.

*Për realizimin e vrojtimit "Sistemi bankar shqiptar.
Probleme të zhvillimit të tij" kanë punuar:*

I. FORMULIMI I PYETËSORËVE U REALIZUA NGA:

1. Eljana Xhani, Departamenti i Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë¹.
2. Sonila Taçi, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.
3. Enkelejda Shabani, Departamenti i Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë².
4. Klodian Shehu, Departamenti i Operacioneve Monetare, Banka e Shqipërisë.
5. Marta Muço, Kabineti, Banka e Shqipërisë.
6. Teuta Baleta, Departamenti Kërkimeve dhe Publikimeve, Banka e Shqipërisë.

**II. INTERVISTIMI I BANKAVE, I ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR DHE
AKADEMIKËVE U KRYE NGA:**

Sonila Taçi, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

III. HEDHJA E TË DHËNAVE U KRYE NGA:

1. Monika Haxhillari, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Banka e Shqipërisë.
2. Sonila Taçi, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

IV. PËRPUNIMI STATISTIKOR I INFORMACIONIT U REALIZUA NGA:

Kliti Ceca, Sektori i Informacionit, Banka e Shqipërisë.

V. RECENSENTË:

1. Dr. Evelina Çeliku, Departamenti Kërkimeve dhe Publikimeve, Banka e Shqipërisë.
2. Kliti Ceca, Sektori i Informacionit, Banka e Shqipërisë.

¹ Aktualisht nuk është më punonjëse e Bankës së Shqipërisë.

² Aktualisht nuk është më punonjëse e Bankës së Shqipërisë.

Abstrakt

Sistemi bankar shqiptar përbëhet nga banka tregtare me kapital shtetëror, të huaj e të përbashkët. Në dekadën e viteve '90 ai është ballafaquar me një sërë problemesh. Karakteristikë ka qenë shkalla e ulët e ndërmjetësimit të tij dhe marrëdhënie të kufizuara me klientët (biznese e individë). Por, mbi të gjitha, gjithmonë e më tepër po shtrohet pyetja: “Pse nuk çelen banka private me kapital shqiptar?” Kjo pyetje shërbeu si pikënisje për ndërmarrjen e një vërtetimi mbi këtë problem dhe çështje të tjera të sistemit bankar.

Në vazhdim është prezantuar një material i tipit përshkrues-analizues i të gjithë informacionit të mbledhur. Ky informacion, duhet theksuar, është një bazë e vlefshme edhe për studime e analiza të tjera më të thelluara, të cilat mund të synojnë nxjerrjen e konkluzioneve të tjera më të përgjithshme ose më të përqëndruara në drejtime apo fusha specifike³.

³ Opinionet e shprehura në këtë analizë vërtetimi janë mendime personale të autorëve dhe jo qëndrime zyrtare të Bankës së Shqipërisë, pavarësisht nga pozicionet e tyre.

Përmbajtja:

Hyrje	9
I. Qëllimi i vrojtimit	9
II. Metodologjia e vrojtimit	9
III. Mangësitë e vërejtura gjatë vrojtimit	11
Kapitulli I: Rezultatet e dala nga analiza sistematike e pyetjeve të të dy pyetësorëve	13
I.1. Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit të parë	13
I.1.1. Informacion i përgjithshëm	13
I.1.2. Pyetjet me karakter të përgjithshëm	14
I.1.3. Pyetjet e rubrikës së parë	16
I.1.4. Pyetjet e rubrikës së dytë	19
I.1.5. Pyetjet e rubrikës së tretë	32
I.1.6. Shënime në fund të pyetësorit	33
I.2. Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit të dytë	34
I.2.1. Informacion i përgjithshëm	34
I.2.2. Pyetjet e rubrikës së parë	34
I.2.3. Pyetjet e rubrikës së dytë	35
I.2.4. Pyetjet e rubrikës së tretë	41
I.2.5. Shënime në fund të pyetësorit	43
Kapitulli II: Rezultatet e dala nga analiza sistematike e pyetjeve të kombinuara të të dy pyetësorëve	44
II.1. Rezultatet e dala nga kombinimi i informacionit të pyetësorit të parë	44
II.1.1. Kombinime të pyetjeve të rubrikës “Informacion i përgjithshëm”	44
II.1.2. Kombinime të pyetjeve të rubrikës së parë	45
II.1.3. Kombinime të pyetjeve të rubrikës së dytë	49
II.2. Rezultatet e dala nga kombinimi i informacionit të pyetësorit të dytë	55
II.2.1. Kombinime të pyetjeve të rubrikës së dytë	55
II.2.2. Kombinime të pyetjeve të rubrikës së tretë	57
Kapitulli III: Komente mbi rezultatet e dala nga analiza sistematike e pyetjeve të të dy pyetësorëve	58
III.1. Informacion i përgjithshëm (komente mbi rubrikën “Informacion i përgjithshëm” i pyetësorit të biznesit)	58
III.2. Çelja e bankave private me kapital shqiptar	59
III.3. Zgjerimi i aktivitetit bankar në të ardhmen	65
III.4. Shkalla e realizimit të planeve të bankave	67
III.5. Aktiviteti kreditues	69
III.5.1. Ndikimi i faktorëve të tjerë në aktivitetin kreditues	71
III.6. Aktiviteti depozitues	72

III.6.1. Ndikimi i faktorëve të tjerë në aktivitetin depozitues	73	
III.7. Shërbimi i pagesave		74
III.8. Aktiviteti bankar dhe rregullat e Bankës së Shqipërisë		75
III.9. Konkurrenca		75
III.10 Tregu valutor		77
III.10.1. Vlerësimi i tregut valutor nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor	78	
III.10.2. Tregu joformal	79	
III.11. Bonot e thesarit		80
III.12. Të tjera		81
III.12.1. Shkalla e ruajtjes së informacionit	81	
III.12.2. Pse një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit prodhues e tregtar zhvillohet jashtë sistemit bankar	82	
III.12.3. Marrëdhëniet me punonjësit e bankave	82	
III.12.4. Niveli i sigurisë që ofrojnë bankat	83	
Kapitulli IV: Konkluzione dhe propozime		84
IV.1. Konkluzione		84
IV.1.1. Çelja e bankave shqiptare	84	
IV.1.2. Zgjerimi i aktivitetit bankar	85	
IV.1.3. Transparenca dhe publiciteti	85	
IV.1.4. Tregu jozyrtar	85	
IV.2. Propozime		86
IV.2.1. Çelja e bankave shqiptare	87	
IV.2.2. Zgjerimi i aktivitetit bankar	88	
IV.2.3. Transparenca dhe publiciteti	88	
IV.2.4. Tregu jozyrtar	89	
IV.2.5. Të tjera propozime	90	
Anekset		91
Aneks I: Pyetësorët e shpërndarë		93
I.1. Pyetësori i parë – Pyetësori për biznesin		93
I.2. Pyetësori i dytë – Pyetësori për bankat dhe akademikët		100
Aneks II: Tabela të rezultateve për disa nga pyetjet		105
II.1. Pyetësori i parë – Pyetësori për biznesin		105
II.2. Pyetësori i dytë – Pyetësori për bankat dhe akademikët		114
Tabelat		
TABELA 1: Shpërndarja e bizneseve sipas origjinës së kapitalit dhe aktivitetit ekonomik (%)		45
TABELA 2: Shpërndarja e bizneseve që do të transferojnë llogarinë jashtë, sipas origjinës së kapitalit		50
TABELA 3: Numri i bizneseve që do të transferojnë llogarinë jashtë, sipas llojit të aktivitetit		51
TABELA 4: Shpërndarja e përgjigjeve sipas numrit të transaksioneve dhe		52

vlerës së tij (në raste)	
TABELA 5: Shpërndarja e përgjigjeve sipas numrit të transaksioneve dhe vlerës së tij (në %)	53
TABELA 6: Mesataret e ponderuara të vlerave për çdo grup transaksioni	53
TABELA 7: Mesatarja e ponderuar e numrit të transaksioneve për çdo grup vlerash të tyre	53
TABELA 8: Shkalla e njohjes së secilës kërkesë	62
TABELA 9: Koeficientët e korrelacionit (të asocimit)	63
TABELA 10: Rastet e përgjigjeve	63
TABELA 11: Viti i krijimit të biznesit	105
TABELA 12: Arsyet që kanë ndikuar që bizneset të mos mendojnë për çelje banke	105
TABELA 13: Kërkesat që njihen nga bizneset për çeljen e një banke	106
TABELA 14: Burimi i financimit të biznesit	106
TABELA 15: Llogaritë në banka	106
TABELA 16: Lloji i llogarive në banka (në raste)	107
TABELA 17: Lloji i llogarive në banka (në %)	107
TABELA 18: Pagesat që kryhen nëpërmjet bankave (në raste)	107
TABELA 19: Pagesat që kryhen nëpërmjet bankave (në %)	107
TABELA 20: Përdorimi i mjeteve të pagesës të ndryshme nga <i>cash</i>	108
TABELA 21: Niveli i komisioneve në banka (në raste)	108
TABELA 22: Niveli i komisioneve në banka (në %)	108
TABELA 23: Llojet e reja të instrumenteve dhe shërbimeve që kërkohen nga bizneset	109
TABELA 24: Veprimtaria eksport-import	109
TABELA 25: Arsyet që një biznes ka ndërruar operator	109
TABELA 26: Numri mesatar i transaksioneve valutore në një muaj	110
TABELA 27: Sasia e valutës e këmbyer zakonisht në një transaksion të vetëm	110
TABELA 28: Veprimet për shmangien e humbjeve nga aktiviteti i këmbimit valutor	110
TABELA 29: Paqartësitë që ka biznesi në lidhje me procedurat e pjesëmarrjes në ankandin e bonove të thesarit	111
TABELA 30: Vëllimi i transaksioneve me tregun valutor në raport me bankat dhe ndryshimi i tij	111
TABELA 31: Masat për rikuperimin e ndryshimeve negative që mund të kenë ndodhur në lidhje me aktivitetin e zyrave të këmbimit valutor	111
TABELA 32: Përqendrimi i klientëve për zyrat e këmbimit valutor në dy momente të ndryshme kohore	111
TABELA 33: Arsyet që mendohet se kanë ndikuar në ndryshimin e përqendrimit të klientëve të zyrave të këmbimit valutor	112
TABELA 34: Opinione mbi nevojën e çeljes së bankave të reja	112
TABELA 35: Opinione të përgjithshme të dhëna në fund të pyetësorit	113
TABELA 36: Arsyet e moshapjes së bankave me kapital shqiptar në Shqipëri	114
TABELA 37: Masa e realizimit të planeve të bankës për thithjen e depozitave	114
TABELA 38: Arsyet e realizimit të planeve të bankës për thithjen e depozitave	115
TABELA 39: Masa e realizimit të planeve të bankës për dhënie kredish	115
TABELA 40: Arsyet e realizimit të planeve të bankës për dhënie kredish	116

TABELA 41: Opinione mbi ndikimin e kufirit të kreditit në aktivitetin kredidhënës të bankës	116
TABELA 42: Arsyet që jepen nga bankat dhe individët të cilat e konsiderojnë të pamjaftueshëm nivelin e publicitetit të bankave	116
TABELA 43: Aktivitetet ku mendohet se ekziston monopoli në tregun bankar	117
TABELA 44: Komentet mbi shmangien e josimetrisë në konkurrencën e tregut të bonove të thesarit	117
TABELA 45: Vërejtjet mbi tregun e bonove të thesarit	118
TABELA 46: Arsyet që jepen për të shpjeguar mungesën e shërbimeve bankare në rrethe që do të sjellë privatizimi i bankave shtetërore	118
TABELA 47: Arsyet që jepen për të shpjeguar përse duhet ose jo skema formale e sigurimit të depozitave në Shqipëri	119
TABELA 48: Arsyet që një pjesë e aktivitetit tregtar/prodhues nuk kryhet nëpërmjet sistemit bankar	120
TABELA 49: Aktivitetet ku bankat mendojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre për 1-2 vitet e ardhshme	120
TABELA 50: Qytetet ku mendohet të shtrihet aktiviteti i bankave	121
TABELA 51: Arsyet pse bankat mendojnë të mos zgjerojnë veprimtarinë e tyre në qytete të tjera	121
TABELA 52: Llojet e bankave që mendohen si më të suksesshme	121
TABELA 53: Komentet mbi opinionin e dhënë në tabelën 51	122
TABELA 54: Opinione të përgjithshme të dhëna në fund të pyetësorit	123

Grafikët

GRAFIKU 1: Format e regjistrimit të biznesit	14
GRAFIKU 2: Forma e pronësisë së bizneseve	14
GRAFIKU 3: Lloji i aktivitetit të bizneseve	15
GRAFIKU 4: Shpërndarja e biznesit sipas vitit të krijimit	16
GRAFIKU 5: Kërkesat që njihen për hapjen e një banke	18
GRAFIKU 6: Format e financimit të bizneseve	20
GRAFIKU 7: Shpërndarja e opinioneve mbi rregullat për pagesat me jashtë	23
GRAFIKU 8: Shpërndarja e opinioneve mbi publicitetin e bankave	24
GRAFIKU 9: Transaksionet e këmbimit valutor sipas operatorëve	27
GRAFIKU 10: Shpërndarja e përgjigjeve për numër transaksionesh	28
GRAFIKU 11: Realizimi i planit depozita - kredi nga bankat	37
GRAFIKU 12: Shpërndarja sipas llojit të aktivitetit	54
GRAFIKU 13: Shpërndarja e bizneseve sipas vitit të krijimit	59

HYRJE

I. Qëllimi i vrojtimit

Qëllimi i organizimit të vrojtimit ishte evindentimi i disa prej problemeve të sistemit bankar, marrëdhëniet bankë-klient dhe disa ide për të ardhmen e afërt të sistemit bankar.

II. Metodologjia e vrojtimit

Për përmbushjen e këtij qëllimi në vrojtimit u përfshinë bankat e nivelit të dytë, zyrat e këmbimit valutor, 200 bizneset më të mëdha dhe individë (punonjës bankash e akademikë). Kjo siguroi trajtimin e problemit nga dy këndvështrime: atë profesionist (banka dhe individë) dhe atë të klientit (biznese). Në fakt, këto kategori përbëjnë hapin e parë të përcaktimit të përbërjes së zgjedhjes. Nga ana tjetër, synohet që sadopak të trajtohet tregu bankar, oferta për shërbimet bankare dhe niveli i kërkesës për to.

VROJTIMI U REALIZUA NË KËTO FAZA:

1. Formulimi i pyetësorëve.
2. Zgjedhja e popullatës për intervistim.
3. Intervistimi.
4. Hedhja e informacionit dhe pastrimi i tij.
5. Përpunimi statistikor dhe analiza e rezultateve.

1. **Formulimi i pyetësorëve.** Për të realizuar qëllimin e vrojtimit, nisur nga gjerësia e problemeve dhe për të ballafaquar opinionet bankë-klient-profesionist, u gjykua që ishte e përshtatshme të hartoheshin dy pyetësorë⁴: pyetësori për bizneset (përfshi zyrat e këmbimit valutor) dhe pyetësori për bankat dhe individët. I pari do të merrte opinionin nga pikëpamja e përdoruesve të shërbimeve bankare. I dyti do të siguronte opinionin profesionist (e bankave, e bankierëve dhe e akademikëve). Më tej, në varësi të problemit të trajtuar, secili prej pyetësorëve u strukturua në disa rubrika. Çdo rubrikë përmbledhonte problemet më të ngjashme dhe përbëhej nga grupi përkatës i pyetjeve. Pyetjet u ndërtuan, sipas qëllimit që i shërbenin, të thjeshta ose me shkallëzime. Ato ofronin si përgjigje alternativa të drejtpërdrejta, plotësuese ose përjashtuese. Në përgjithësi, nuk u synua të merret informacion sasior. Pyetjet e kësaj natyre janë të pakta.

⁴ Pyetësorët e plotë jepen në aneksin I.

Në tërësi pyetjet kërkojnë zgjedhje alternativash, bërje komentesh ose arsyetim të përgjigjes së dhënë. Pyetësorët u konsultuan edhe me specialistin përkatës në INSTAT. Ky konsultim u bë me qëllim që të sigurohej një paraqitje sa më e përshtatshme e pyetësorit për plotësim dhe përpunim.

2. **Zgjedhja e popullatës për intervistim.** Për të arritur qëllimin e vrojtimit u konsiderua e përshtatshme të intervistoheshin ato grupe, të cilat konsiderohen si më të afërta me bankat dhe veprimtarinë e tyre. Për këtë qëllim u zgjodhën:

- * *të gjitha bankat* që vepronin në Shqipëri, 11 të tilla (vrojtim i përgjithshëm);
- * *të gjitha zyrat e këmbimit valutor* që vepronin në Shqipëri, 15 të tilla (vrojtim i përgjithshëm). Këto zyra u menduan si të përshtatshme për shkak se biznesi i tyre është një veprimtari financiare dhe në aktivitetin e përditshëm këto zyra kanë lidhje të ngushta me bankat;
- * *individë profesionistë dhe akademikë* (vrojtim me zgjedhje). Si individë profesionistë u zgjodhën individë të njohur si ekspertë në bankat e nivelit të dytë dhe në bankën qendrore. Akademikët u përzgjedhën nga Fakulteti Ekonomik, kryesisht pedagogë të lëndëve bankare e financiare. Gjithsej u përzgjedhën 35 të tillë. Kjo shifër plotëson kushtin e nivelit të mirë të përfaqësueshmërisë së mendimit akademik me zgjedhje;
- * *të gjitha bizneset më të mëdha si taksëpagues*, gjithsej 200 të tillë (vrojtim i përgjithshëm). U veçua ky grup nga moria e shoqërive të biznesit pasi ai mendohet si grupi më i fuqishëm financiarisht dhe me njohuri më të plota e më profesioniste si pasojë e nevojës për administrim ndërmarrjesh relativisht të mëdha. Ky biznes priret të ketë lidhje me bankat dhe të renditet ndër klientët e rëndësishëm të bankave. Ky numër përbën një përfaqësueshmëri statistikisht të pranueshme, që i shërben qëllimit të vrojtimit. Megjithatë, gjithsej u realizuan 187 intervista. Pjesa tjetër (13 biznese) nuk u intervistuan pasi rezultoi me adresë të ndryshuar dhe nuk u gjendën; kishin mbyllur aktivitetin ose thjesht nuk pranuan të përgjigjeshin.

3. **Intervistimi.** Përpara fillimit të procesit të intervistimit, për të siguruar cilësi në plotësimin e pyetësorëve, u organizua një seancë trajnimi me intervistuesit. Kjo fazë u zhvillua në periudhën janar - mars 1999. Nisur nga popullata e zgjedhur e cila konsiderohej si profesioniste u mendua që intervistimi të zhvillohej në dy forma. Banka e Shqipërisë shpërndau për plotësim pyetësorët për bankat, zyrat e këmbimit valutor dhe individët. INSTAT organizoi intervistimin e 200 bizneseve të mëdha. Në secilin rast u ruajt anonimat. Pyetësori nuk kërkonte identifikimin e plotësuesit të tij. Intervistimi u realizua gjatë periudhës mars - korrik 1999.

4. **Hedhja e informacionit dhe pastrimi i tij.** Gjerësia e problemeve të trajtuara në pyetësor dhe numri relativisht i madh i pyetjeve dhe i alternativave të ofruara për përgjigje rritën shkallën e vështirësisë në hedhje dhe përpunim të dhënash. Pyetësori i parë përmbante 63 pyetje dhe i dyti 30 të tilla. Duke mos patur në Bankën e Shqipërisë njësi të specializuara për këtë proces, u rrit

koha e hedhjes dhe e përpunimit të të dhënave. Gjatë hedhjes së të dhënave u eliminuan problemet dhe mangësitë në plotësimet.

5. **Përpunimi statistikor dhe analiza e rezultateve.** Rezultatet e dala nga përpunimi statistikor u paraqitën me tekste, tabela e grafikë duke ndjekur rradhën e pyetjeve të çdo pyetësi. Kjo paraqitje është bërë veçmas për çdo pyetësor. Në kapitullin e parë janë përshkruar rezultatet për çdo pyetje. Rezultatet, sipas nevojës, janë dhënë në përqindje ose në raste dhe/ose në formë tabelore apo grafike. Në kapitullin e dytë, përsëri jepen rezultatet, por jo për pyetje të veçanta, por për kombinime të tyre. Rezultatet komentohen në kapitullin e tretë. Komentet janë renditur sipas problemeve duke grupuar pyetje të natyrës së njëjtë të të dy pyetësorëve. Kapitulli i katërt jep konkluzionet dhe disa propozime tentative. Në aneksin e parë jepen të plotë të dy pyetësorët e shpërndarë. Ndërsa, aneksi i dytë paraqet, në formë tabelore, një pjesë të informacionit për pyetjet e veçanta të pyetësorëve.

III. Mangësitë e vërejtura gjatë vrojtimit

Në procesin e vrojtimit u vërejtën disa mangësi, të cilat duhet të kihen parasysh për organizimin e vrojtimit të ngjashme në të ardhmen. Kështu:

- intervistimi i realizuar direkt nga Banka e Shqipërisë rezultoi me një nivel të ulët përgjigjesh. Kjo ndodh për arsye se mungojnë njerëzit e specializuar për këtë aktivitet. Po kështu, kryerja e intervistimit në emër të Bankës së Shqipërisë, pavarësisht nga theksimi i elementit të ruajtjes së anonimatit, shkakton hezitim dhe stepje për t'u prononcuar;
- përpunimi statistikor i të dhënave kërkoi një periudhë relativisht të gjatë kohe (gusht 1999 – mars 2000). Siç u theksua më sipër, Bankës së Shqipërisë i mungojnë njësitet dhe burimet njerëzore për këtë qëllim si dhe ekspertiza;
- shkalla e bashkëpunimit të të intervistuarve, në përgjithësi, është e ulët.

KËTO MANGËSI SUGJEROJNË QË BANKA E SHQIPËRISË DUHET:

së pari, të krijojë njësi të veçantë, të specializuar për organizimin e vrojtimit. Kjo njësi do të duhet të ketë për detyrë kryesore përshtatjen e pyetësorëve për përpunim informatik, ndjekjen e vrojtimit të rregullta periodike ose jo, përcaktimin e popullatës, që do të anketohet, dhe të kritereve të përzgjedhjes me qëllim që rezultatet të jenë statistikisht të vlefshme; hedhjen e të dhënave, pastrimin e tyre dhe përpunimin statistikor duke përdorur edhe programet përkatëse për këtë qëllim;

së dyti, të angazhojë në procesin e intervistimit persona, organizata apo institucione të treta për cilësinë e punës së të cilëve është e bindur. Për këtë, Bankës i duhet të përpilojë të gjithë rregullat e nevojshme të këtij bashkëpunimi;

së treti, të mbështesë financiarisht një proces të tillë duke synuar cilësi në kryerjen e vrojtimit;

së katërti, të angazhohet në edukimin e publikut dhe shpjegimin e rëndësisë që ka bashkëpunimi për dhënie informacioni. Kjo ndihmon Bankën e Shqipërisë për të përmirësuar procesin vendimmarrës. Por, ky bashkëpunim ndihmon dhe vetë publikun, e sidomos bizneset, pasi do të rritet shkalla e njohjes prej tyre të mjedisit ekonomik dhe për pasojë do të merren vendime më të mira e të dobishme.

KAPITULLI I: REZULTATET E DALA NGA ANALIZA SISTEMATIKE E PYETJEVE TË TË DY PYETËSORËVE

I.1 – Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit të parë (biznese dhe zyra këmbimi valutor)⁵

I.1.1 Informacion i përgjithshëm

Pyetësi për biznesin u shpërnda për plotësim në 200 bizneset e klasifikuar si biznese të mëdhenj dhe në të gjitha, 15, zyrat e këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë, që vepronin si operatore të tregut të këmbimeve valutore në periudhën e kryerjes së vrojtimit. Qëllimi i zgjedhjes së këtij grupi, siç është theksuar, nga moria e bizneseve që veprojnë në Shqipëri, qëndronte në zbulimin e nivelit të marrëdhënieve të tij me sistemin bankar, pasi gjykohej që bizneset e mëdhenj dhe zyrat e këmbimit valutor janë më të afërta me bankat se çdo lloj biznesi tjetër nisur nga interesat që kanë, fuqia financiare, njohuritë etj..

Nga bizneset e mëdhenj dhanë përgjigje 187 ose 93.5 e të pyeturve gjithsej. Ky nivel përgjigjesh është mjaft i mirë për të nxjerrë konkluzione. Megjithatë, siç do të shihet në vijim, kjo shkallë përgjigjeje nuk ruhet edhe për pyetje të veçanta.

Nga zyrat e këmbimit valutor dhanë përgjigje vetëm 4 ose 26.7 për qind e të pyeturve gjithsej. Krahasuar me bizneset, shkalla e përgjigjeve është dukshëm më e ulët për zyrat e këmbimit valutor. Megjithatë, është gjykuar që paraqitja e informacionit të marrë, sado i mangët të jetë ky, është me vlerë. Nga ana tjetër, nuk është pretenduar që të arrihen konkluzione të sakta dhe të prera. Është tentuar vetëm të bëhen komentet përkatëse. Për pyetje të veçanta, gjithashtu, nuk ruhet e njëjta shkallë përgjigjeje si për pyetësin.


Totali i rasteve të shqyrtuara arrin në 191 ku 97.9 për qind janë biznese dhe 2.1 për qind janë zyra të këmbimit valutor. Shkalla e përgjigjes arrin mesatarisht në 88.8 për qind, e cila gjykohej optimale për të konkluduar mbi problemet që trajtohen në pyetësor.

⁵ Pyetësi i plotë jepet në aneksin I.

I.1.2 Pyetjet me karakter të përgjithshëm⁶


I. Forma e regjistrimit të biznesit.

Kjo pyetje ka karakter të përgjithshëm informues dhe synon të shikojë se si është shpërndarja midis formave të ndryshme të biznesit. Nga përgjigjet e dhëna rezulton se 80.6 për qind e të intervistuarve janë organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 13.6 për qind si shoqëri anonime dhe 5.8 për qind janë organizuar në forma të tjera.



II. Lloji i pronësisë.


Kjo pyetje ka karakter të përgjithshëm informues dhe synon të shikojë se si është e shpërndarë pronësia e 200 bizneseve më të mëdhenj dhe zyrave të këmbimit valutor. Nga përgjigjet e dhëna rezulton se 60.2 për qind e të intervistuarve janë biznese me kapital tërësisht shqiptar, 16.8 për qind me kapital të huaj dhe 23 për qind me kapital të përbashkët, shqiptar dhe të huaj.



⁶ Për të lexuar pyetjet e plota shih aneksin I.


III. Lloji i aktivitetit.

Kjo pyetje ka karakter të përgjithshëm informues dhe synon të shikojë se si është shpërndarë aktiviteti, që kryejnë bizneset në fusha të ndryshme të ekonomisë. Alternativat e ofruara për përgjigje lidhur me llojin e aktivitetit korrespondojnë deri diku me strukturën e ekonomisë shqiptare në tërësi (përfshirë bujqësinë). Nga përgjigjet e dhëna rezultojnë se 18.8 për qind e bizneseve ishin angazhuar në prodhim, 36.6 për qind në tregti, 18.8 për qind në shërbime, 23.0 për qind në ndërtim dhe 2.6 të tjera, që në rastin konkret përfaqëson kryesisht (4 nga 5 rastet e përgjigjura) aktivitetin e këmbimit valutor, domethënë këtu përfshihen zyrat e këmbimit valutor.



IV. Viti i themelimit të biznesit.

Kjo pyetje ka karakter të përgjithshëm informues dhe synon të shikojë se cila është "mosha" e biznesit të madh shqiptar. Nga përgjigjet e dhëna kemi këtë shpërndarje: 21.5 për qind janë themeluar në vitin 1994, 18.8 për qind në vitin 1993, 15.7 për qind në vitin 1992, 12.6 për qind në vitin 1996, 11 për qind në vitin 1995; 5.2 për qind në vitin 1997; 4.2 për qind në vitin 1991; nga 1.6 për qind përkatësisht në vitet 1990 dhe 1998; 1 për qind në vitin 1999 dhe nga 0.5 për qind përkatësisht në secilin nga vitet 1928, 1938, 1941, 1948, 1957, 1964, 1973, 1974, 1987 dhe 1989. Ndërsa 1.6 për qind e bizneseve nuk e kanë plotësuar këtë të dhënë.



I.1.3 Pyetjet e rubrikës së parë.

Pyetjet e rubrikës së parë kanë për qëllim të zbulojnë nivelin e njohurive dhe mundësitë e biznesit për të çelur një bankë. Kjo rubrikë përbëhet nga 9 pyetje. Kësaj rubrike i përgjigjen bizneset dhe zyrat e këmbimit valutor.

Pyetja 1,

kërkon të zbulojë nëse bizneset kanë dijeni se në Shqipëri lejohet çelja e bankave private. Sipas përgjigjeve të dhëna rezulton se këtë fakt e dinë 97.4 për qind e të intervistuarve, ndërsa 2.6 për qind pohojnë të kundërtën.

Pyetja 2,

kërkon të zbulojë nëse bizneset kanë menduar ndonjëherë të çelin bankë. Nga përgjigjet rezulton se vetëm 7.9 për qind e të intervistuarve kanë pasur një mendim të tillë. Pjesa më e madhe e tyre, 92.1 për qind, nuk kanë menduar për këtë gjë.

Pyetja 3,

synon të zbulojë arsyet, që i kanë shtyrë bizneset të mos mendojnë për çeljen e një banke nëpërmjet kërkesës për klasifikimin e këtyre arsyeve (në pyetje

renditen 5 arsye). Kësaj pyetjeje i japin përgjigje vetëm bizneset, që kanë zgjedhur alternativën “Jo” në pyetjen 2.

Nga 172 biznese, që nuk kanë menduar ndonjëherë të çelin bankë, 48.3 për qind e tyre (83 biznese) nxjerrin si arsye mungesën e kapitalit të mjaftueshëm (ose 43.5 për qind e të të intervistuarve gjithsej). Kjo arsye, siç shihet, zë një peshë të konsiderueshme duke sugjeruar, në vështrim të parë, që kërkesa për kapital, e shtruar nga Banka e Shqipërisë, është disi e tepruar, pasi gati gjysma e bizneseve të mëdha, domethënë e bizneseve më të fuqishme në vend, deklarojnë të mos kenë kapital të mjaftueshëm.

Nga 172 biznese, që nuk kanë menduar ndonjëherë të çelin bankë, një numër relativisht i vogël i tyre, 9.3 për qind (16 biznese), nxjerrin si arsye faktin që biznesi bankar nuk konsiderohet si biznes fitimprurës.

Nga 172 biznese, që nuk kanë menduar ndonjëherë të çelin bankë, 22.1 për qind e tyre (38 biznese) nxjerrin si arsye mungesën e specialistëve të kësaj fushe.

Nga 172 biznese, që nuk kanë menduar ndonjëherë të çelin bankë, 25.6 për qind e tyre (44 biznese) nxjerrin si arsye mosnjohjen e këtij lloji biznesi.

Nga 172 biznese, që nuk kanë menduar ndonjëherë të çelin bankë, 17.4 për qind e tyre (30 biznese) nxjerrin arsye të tjera.

Përqindjet janë llogaritur bazuar edhe në numrin gjithsej të të intervistuarve (191) për të parë peshën e tyre kundrejt totalit të të intervistuarve. Nga përgjigjet del se 44.0 për qind e të intervistuarve theksojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm, 8.4 për qind nuk e shohin çeljen e një banke si biznes fitimprurës, 19.9 për qind pohojnë se nuk kanë specialistë të kësaj fushe, 23 për qind nuk e njohin këtë lloji biznesi dhe 15.7 për qind kanë arsye të tjera.


Pyetja 4,

kërkon të evidentojë nëse bizneset e dinë se cili është institucioni, që jep licencën për të çelur një bankë. Qëllimi është të shihet shkalla e njohjes së Bankës së Shqipërisë si institucioni licencues dhe për të marrë sinjale për të vepruar në të ardhmen. Nga përgjigjet del se 78.5 për qind e tyre e dinë cili është institucioni, që e kryen këtë veprimtari dhe 19.9 për qind nuk e dinë cili është organi licencues. Për të parë saktësinë e përgjigjes dhe për t'u siguruar që pyetja është kuptuar drejt, ajo është organizuar në dy shkallë: së pari, pyetet vetëm nëse njihet institucioni dhe së dyti, pyetet se cili është ky institucion. Në përgjithësi identifikohen dy institucione, që mendohet se japin licenca për bankat: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave. Banka e Shqipërisë përmendet nga 119 biznese ose 62.3 për qind e të intervistuarve; Ministria e Financave 19.9 për qind dhe në një rast përmendet gjykata. Gjithashtu, në rastet, që njohin Bankën e Shqipërisë si institucioni licencues, përdoren edhe emërtime të tjera si

Banka Kombëtare (15 raste), Banka Shqiptare (5 raste) dhe Banka e Shtetit (3 raste). Ndërsa në Ministrinë e Financave janë përfshirë edhe dy raste kur të anketuarit kanë përmendur Këshillin e Ministrave.

Pyetja 5,

kërkon informacion mbi njohjen e kërkesave, që shtrohen për hapjen e një banke dhe rendit 8 zgjedhje. Gjithashtu, për të marrë një informacion më të plotë mbi shkallën e njohjes, pyetja është konceptuar që mund të zgjidhet si përgjigje më shumë se sa një alternativë. Nga përgjigjet rezulton se kërkesa për kapital minimal njihet nga 48.7 për qind e të intervistuarve; kërkesa për deklarimin e burimit të të ardhurave njihet nga 46.6 për qind e të intervistuarve; kërkesa për krijimin e ambjenteve të përshtatshme njihet nga 38.2 për qind e të intervistuarve; kërkesa për planin e biznesit njihet nga 40.3 për qind e të intervistuarve; kërkesa për administratorë të kualifikuar njihet nga 46.1 për qind e të intervistuarve; kërkesa për raportin financiar sekret njihet nga 33.0 për qind e të intervistuarve; kërkesa për hartimin e procedurave dhe të rregulloreve të brendshme njihet nga 32.5 për qind e të intervistuarve; dhe 45.5 për qind nuk njohin asnjë kërkesë.



Pyetja 6,

kërkon të dijë si vlerësohen kërkesat për çeljen e një banke. Pyetja kërkon që përgjigje të japë ai grup biznesesh që ka njohuri për këto kërkesa. Nga përgjigjet rezulton se 2.6 për qind e të intervistuarve i vlerësojnë kërkesat si konservatore, 47.1 për qind si të përshtatshme dhe 3.1 për qind si liberale.

Pyetja 7,

bëhet me qëllim që të mësojmë nëse të intervistuarit ndiejnë nevojën për më shumë informacion rreth kërkesave për çeljen e një banke të re. Nga përgjigjet rezulton se 52.4 për qind e të intervistuarve e ndiejnë këtë nevojë dhe 45.0 për qind nuk e ndiejnë atë.

Pyetja 8,

kërkon të dijë nëse bizneset do të blinin aksione të bankave shtetërore të privatizuara, nëse u ofrohen. Edhe kjo pyetje është hartuar për të kuptuar se sa të gatshme janë bizneset për t'u angazhuar në biznesin bankar. Nga përgjigjet rezulton se 28.8 për qind e të intervistuarve janë të gatshëm ndërsa 71.2 për qind e tyre konfirmojnë të kundërtën.

Pyetja 9,

bëhet për të zbuluar arsyet e mungesës së gatishmërisë së bizneseve për të blerë aksione të bankave. Kjo pyetje është hartuar për t'u përgjigjur nga ata të intervistuar, që kanë zgjedhur alternativën "Jo" në pyetjen 8. Arsyet klasifikohen në tre. Nga përgjigjet rezulton se 94.8 për qind e tyre janë prononcuar për të treguar këto arsye. Nga të përgjigjurit negativisht 31 për qind (20.9 për qind e totalit të të intervistuarve) kanë pohuar se nuk e shohin si alternativë të mirë investimi, 32.5 për qind (22.0 për qind e totalit të të intervistuarve) kanë pohuar se nuk kanë dijeni për procedurat dhe 36.4 për qind (24.6 për qind e totalit të të intervistuarve) gjejnë të tjera arsye.

I.1.4 Pyetjet e rubrikës së dytë.

Pyetjet e rubrikës së dytë kanë për qëllim të marrin informacion mbi nivelin e shërbimeve, që ofrojnë bankat dhe sa i përgjigjet ky nivel kërkesave të klientëve. Pra, është një rubrikë, që i dedikohet marrëdhënieve bankë-klient, parë nga këndvështrimi i klientit. Përsëri, vrojtimi është përqendruar tek bizneset më të mëdha dhe zyrat e këmbimit valutor pasi gjykohet që, aktualisht, këto janë grupet, që pritet të kenë marrëdhënie më të ngushta ose më intensive me bankat. Kjo rubrikë përbëhet nga 50 pyetje. Kësaj rubrike i përgjigjen bizneset dhe zyrat e këmbimit valutor si më poshtë:


- * pyetjeve 10-29 i përgjigjen të dy grupet. Ky grup pyetjesh synon të sqarojë nivelin e shërbimeve (në sasi dhe në cilësi) që bankat i ofrojnë bizneseve;
- * pyetjeve 30-44 i përgjigjen vetëm 200 bizneset e mëdha. Ky grup pyetjesh synon të qartësojë disa fenomene të tregut valutor dhe të tregut të bonove të thesarit. Pyetjet 30-38 përqendrohen në marrjen e informacionit mbi tregun valutor, ndërsa pyetjet 39-44 përqendrohen në marrjen e informacionit mbi

tregun e bonove të thesarit. Megjithatë, llogaritjet janë bërë nisur nga numri total i të intervistuarve (191) pasi kësaj rubrike i janë përgjigjur dhe zyrat e këmbimit valutor. Duke konsideruar se përgjigjet e zyrave nuk mund të ndikojnë, në përmbysje, tendencën e përgjigjeve të biznesit dhe faktin që vetë zyrat e këmbimit valutor janë biznese, përgjigjet e tyre nuk u përjashtuan;

- * pyetjeve 45-59 i përgjigjen vetëm zyrat e këmbimit valutor. Duhet theksuar se janë përgjigjur vetëm 4 zyra. Për këtë arsye rezultatet do të jepen pa llogaritur përqindje, por në raste. Përgjigjet e zyrave mund të konsiderohen vetëm orientuese.

Pyetja 10,

kërkon të zbulojë burimin (burimet) e financimit të aktivitetit të bizneseve, cili prej tyre paraqitet si më kryesori dhe ajo që ka më rëndësi, cila është shkalla e financimit me kredi bankare. Për këtë u dhanë 6 alternativa dhe pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Ajo që rezultoi është se u përgjigjen për opsionin e parë, pra financim nga fitimet e veta, 172 të intervistuar ose 90.1 për qind të tyre. Ky përbën burimin kryesor për pjesën më të madhe të të intervistuarve. Ndërkaq, vetëm 3.1 për qind pohuan se financohen nga firma të tjera, 3,7 për qind nga individë, 10.5 për qind nga kredia bankare, 13.1 për qind nga parapagimi i porosisë dhe 7.9 për qind përdorin të tjera forma financimi.



Pyetja 11,

kërkon të dijë nëse është kërkuar kredi nga bankat dhe nga cilat prej tyre duke ofruar dy kategori, shtetëroret dhe privatet si dhe lejon zgjedhjen e njëkohshme të të dyja alternativave për përgjigje. Për bankat shtetërore rezultoi se nga 191 të pyetur, 34 ose 17.8 për qind kanë kërkuar kredi prej tyre. Për bankat private

rezulton e njëjta përgjigje, pra po 17.8 për qind e të intervistuarve kanë kërkuar kredi prej tyre.

Pyetja 12,

kërkon të vlerësojë se ç'pjesë e të intervistuarve e ka përfutur kredinë bankare. Nga përgjigjet rezulton se 17.3 për qind e totalit të tyre, apo 33 biznese, e kanë përfutur kredinë. Kjo do të thotë se rreth gjysma e atyre që kanë kërkuar kredi, në bankat shtetërore apo private, e kanë përfituar atë. Me fjalë të tjera, në çdo dy kërkesa për kredi, një miratohet.

Pyetja 13,

kërkon një vlerësim për procedurat e marrjes së kredisë duke ofruar përsëri dy grupe bankash, shtetërore dhe private, duke lejuar zgjedhjen e njëkohshme të të dyja alternativave për përgjigje. Për bankat shtetërore 25.7 për qind e të intervistuarve i konsiderojnë ato burokratike (kjo përbën 81.6 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) dhe vetëm 5.8 për qind (kjo përbën 18.4 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) i konsiderojnë ato normale. Për bankat private 11.5 për qind i konsiderojnë burokratike (kjo përbën 38.6 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) dhe 18.3 për qind (kjo përbën 61.4 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) mendojnë se ato janë normale.

Pyetja 14,

kërkon një vlerësim për kushtet e kredidhënies për secilin nga grupet e bankave duke lejuar zgjedhjen e të dyja alternativave për përgjigje. Nga rezultati del se për bankat shtetërore 6.8 për qind e të intervistuarve (kjo përbën 22.4 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) i konsiderojnë ato të favorshme dhe 23.6 për qind (kjo përbën 77.6 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) të pafavorshme. Për bankat private raportet janë më të ekuilibruara: 16.8 për qind e të intervistuarve (kjo përbën 57.1 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) i konsideron kushtet e kredidhënies të favorshme dhe 12.6 për qind (kjo përbën 42.8 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) i sheh ato si të pafavorshme.

Pyetja 15,

mbledh informacion mbi faktin nëse bizneset kanë llogari bankare duke lejuar zgjedhjen e të dyja alternativave për përgjigje. Rezulton se 85.9 për qind e të intervistuarve (kjo përbën 89.6 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje) kanë llogari pranë bankave shtetërore, ndërsa pranë bankave private kanë llogari vetëm 52.9 për qind e tyre (kjo përbën 60.1 për qind të atyre, që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje).

Pyetja 16,

kërkon të dijë se në emër të kujt është hapur llogaria bankare. Rezulton se 172 biznese ose 90.1 për qind e të intervistuarve përgjigjen se llogaria është hapur në emër të shoqërisë. Pjesa tjetër, 9.9 për qind, konfirmon se llogaria është hapur në emër të pronarit.

Pyetja 17,

u kërkon bizneseve të thonë nëse do ta transferonin llogarinë e tyre jashtë po të lejohej një veprim i tillë. Rezulton se 64.4 për qind e të intervistuarve nuk do ta transferonin llogarinë jashtë dhe vetëm 33.5 për qind e tyre do ta bënë këtë.

Pyetja 18,

kërkon të marrë informacion mbi llojin e llogarisë, që përdorin më shumë bizneset, duke ofruar zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Rezulton se 95.8 për qind e tyre kanë llogari rrjedhëse në lekë dhe vetëm 2.6 për qind kanë llogari të tilla në valutë. Ndërkaq, vetëm 6.8 për qind e të intervistuarve kanë llogari me afat në lekë kur 1.6 për qind kanë të tilla në valutë.

Pyetja 19,


kërkon të marrë informacion për kryerjen e pagesave, institucionin që preferohet dhe llojin e tyre, duke ofruar zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Nga përgjigjet rezulton se 83.7 për qind e të intervistuarve kryejnë pagesa nëpërmjet bankave shtetërore nga të cilat 98 për qind janë pagesa me brenda dhe vetëm 2 për qind janë pagesa me jashtë. Po ashtu, rezulton se 52.3 për qind e të pyeturve kryejnë pagesa nëpërmjet bankave private nga të cilat 85 për qind janë pagesa me brenda dhe 15 për qind me jashtë.

Pyetja 20,

kërkon të marrë informacion nëse bizneset përdorin mjete pagese të ndryshme nga *cash*-i dhe cilën formë alternative përdorin më shumë. Nga përgjigjet rezulton se 80.1 për qind e tyre përdorin mjete pagese të ndryshme nga *cash*-i dhe vetëm 11.5 për qind nuk i përdorin ato. Nga ana tjetër, 8.4 për qind e të intervistuarve nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje. Nga bizneset, që përdorin forma të tjera alternative vërejmë se 10.5 për qind përdorin kartë krediti, 77.0 për qind përdorin çeqe dhe 24.1 për qind përdorin forma të tjera. Edhe kjo pyetje ofron zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje.

Pyetja 21,

kërkon të dijë opinionin e bizneseve lidhur me rregullat për pagesat me jashtë. Nga përgjigjet rezulton se 45.1 për qind e të intervistuarve i konsiderojnë ato si të favorshme, 18.7 për qind si të pafavorshme dhe 33.2 për qind e tyre nuk i njohin këto rregulla.



Pyetja 22,

kërkon të klasifikojë opinionin e bizneseve lidhur me nivelin e komisioneve, që paguhet në banka për shërbimin e pagesës. Pyetja është hartuar që të marrë përgjigje edhe për të dyja grupet e bankave njëkohësisht. Niveli i komisioneve në bankat shtetërore konsiderohet i ulët nga 5.8 për qind e të intervistuarve, i lartë nga 35.6 për qind dhe i pranueshëm nga 45.0 për qind. Ndërsa, në bankat private vetëm 1.6 për qind e konsiderojnë nivelin e komisionit të ulët, 23.0 për qind e konsiderojnë të lartë dhe 35.1 për qind të pranueshëm.

Pyetja 23,

bëhet për të ditur nëse bizneset e ndjejnë nevojën për instrumente të reja dhe shërbime të tjera nga sistemi bankar. Nga përgjigja rezulton se 77.0 për qind të tyre e ndjejnë këtë nevojë.


Pyetja 24,

bëhet për të specifikuar llojet e shërbimeve të reja, që bizneset preferojnë të përdorin më shumë në të ardhmen. Pyetja lejon dhënien e përgjigjes për më shumë se një alternativë, ndërkohë që ofron tetë të tilla. Ajo që rezulton nga përgjigjet është se bizneset kërkesat më të mëdha, 59.2 për qind e të intervistuarve, i kanë për kartat e kreditit, e ndjekur nga 44.5 për qind për letër

kredinë, 23.6 për qind për shërbime arke, 22.5 për qind për shërbime konsulence, 15.2 për qind për investimet, 13.1 për qind për çertifikata depozitimi 11.0 për qind për pranimet bankare dhe vetëm 2.1 për qind për të tjera shërbime.

Pyetja 25,

kërkon mendimin e biznesit mbi nivelin e reklamës, që bëjnë bankat për shërbimet që ato ofrojnë. Përsëri edhe në këtë pyetje bëhet ndarja në banka shtetërore dhe në ato private dhe lejohet dhe zgjedhja e njëkohshme e tyre. Rezulton se 33.5 për qind e të pyeturve pohojnë se bankat shtetërore bëjnë reklamë të mjaftueshme për shërbimet, që ofrojnë, dhe 58.1 për qind e tyre e konsiderojnë atë të pamjaftueshme. Përsa i përket bankave private 29.3 për qind e konsiderojnë këtë reklamë të mjaftueshme dhe 34.6 për qind të pamjaftueshme.



Pyetja 26,

është bërë për të testuar marrëdhëniet e bizneseve me bankat. Këtu janë nënkuptuar korrektësia, shpejtësia në kryerjen e veprimeve e shërbimeve, mirësjellja e punonjësve të bankave etj.. Edhe në këtë pyetje bankat ndahen në dy kategori dhe mund të zgjidhet secila prej tyre njëkohësisht. Në bankat shtetërore këto marrëdhënie rezultojnë të jenë miqësore për 51.8 për qind të të intervistuarve, formale për 33.0 për qind të tyre dhe jo të mira për 3.1 për qind. Ndërsa, në bankat private 34.6 për qind i konsiderojnë këto marrëdhënie miqësore, 21.5 për qind si formale dhe 0.5 për qind si jo të mira.

Pyetja 27,

kërkon të evidentojë se në cilat banka, shtetërore apo private, biznesi i ndjen më të sigurtat paratë e veta. Nga përgjigjet rezulton se 58.1 për qind e bizneseve i ndjejnë paratë e tyre më të sigurtat në bankat shtetërore, 28.8 në bankat private

dhe 13.1 për qind nuk janë përgjigjur. Edhe kjo pyetje është konceptuar në dy shkallë. Së pari, kërkohet të evidentohet se në cilin grup bankash mendohet që janë më të sigurtat paratë. Së dyti, kërkohet të dihet edhe arsyeja për një mendim të tillë.

Në përgjigjet, që preferojnë bankat shtetërore janë përdorur mjaft arsye. Vërehet se dominon arsyeja që siguria vjen si pasojë e të qenit bankë shtetërore e shprehur si: "bankat shtetërore janë më të sigurtat se privatet; ato nuk falimentojnë; shteti është në mes; shteti është garant; shteti nuk falimenton; shteti të rimbursion". Ky grup arsyesh jepet në 97 raste ose 50.8 për qind. Ka edhe arsye të tilla si:

- * nga privatët u dogjëm;
- * interesa më të përshtatshme;
- * mungesa e informacionit për bankat private;
- * eksperiencia e bankave private është e vogël;
- * po investojmë vetëm në bono;
- * paraqet më siguri për pagesat etj..

Në favor të preferencave për bankat private arsyetimi mbështetet, në pjesën më të madhe, tek cilësia e shërbimit, që ka të bëjë me "shpejtësinë e shërbimit; kushte më të mira shërbimi; korrektësi më e madhe; burokraci më e vogël; përvoja; reputacioni; kanë kontroll më të mirë". Ky grup arsyesh jepet në 39 raste ose 20.4 për qind. Ka edhe arsye të tilla si:

- * besimi tek bankat private rrjedh nga zbatimi më i mirë i legjislacionit;
- * besimi tek bankat private rrjedh nga pamundësia e shtetit për të ndërhyrë arbitrarisht, për pasojë janë më të pavarura dhe sekretet ruhet më mirë. Madje në një rast shkruhet "*garantohet mostërheqja me forcë e mjeteve monetare nga zyra e tatimeve*";
- * besimi tek bankat private rrjedh nga lehtësitë, që u ofrohen bizneseve me kapitale të huaja të njëjta me bankat, që kanë kapital me origjinë nga të njëjtat vende. Sidomos theksohet ky fakt për Bankën Italo-Shqiptare:
- * shteti padroni më i keq.

Megjithatë, 3.1 për qind e të intervistuarve shprehen se nuk kanë besim në asnjë bankë, ndërsa 4.2 për qind se nuk kanë preferencë për asnjë grup banke.

Pyetja 28,

kërkon të dijë opinionin e bizneseve për shkallën e ruajtjes së informacionit nga ana e bankave. Nga përgjigjet rezulton se 74.9 për qind e bizneseve të intervistuarat janë të kënaqura me shkallën të ruajtjes së informacionit dhe vetëm 24.1 pohojnë të kundërtën.

Pyetja 29,

kërkon opinionin e bizneseve lidhur me ndikimin që do të kishte në besimin tek bankat botimi i bilancit të tyre. Është një pyetje, që kërkon të dijë se sa e mbështesin bizneset idenë për më shumë transparencë nga ana e bankave. Rezulton se 83.8 për qind e të intervistuarve pranojnë se kjo do të ndikonte në rritjen e besimit tek bankat, 5.2 për qind thonë se kjo nuk do të ndikonte dhe 8.4 për qind pohojnë se nuk e dinë se çdo të ndodhte.

Pyetja 30,


kërkon informacion mbi shpërndarjen e bizneseve të mëdha në veprimtarinë e eksport-importit. Pyetja ofron katër alternativa dhe lejohet zgjedhja e një alternative të vetme. Nga përgjigjet rezulton se 6.3 për qind e tyre kanë veprimtari eksporti, 41.9 për qind kanë veprimtari importi, 15.7 për qind ushtrojnë të dyja këto veprimtari dhe 36.1 për qind asnjërin prej tyre.

Pyetja 31,

kërkon të zbulojë nëse firmat kryejnë apo jo transaksione valutore. Nga përgjigjet rezulton se 80.1 për qind e bizneseve kryejnë të tilla transaksione dhe 18.8 për qind e tyre jo.

Pyetja 32,

kërkon të marrë informacion mbi operatorin apo tregun, që përdorin bizneset për të kryer transaksionet e këmbimit valutore. Pyetja ofron katër alternativa dhe lejon një mundësi zgjedhjeje. Nga përgjigjet del se 37.2 për qind e tyre i kryejnë këto veprime me bankën, 18.3 për qind me zyrat e këmbimit valutore, 13.1 për qind me tregun jozyrtar dhe 26.2 për qind të rasteve i kryejnë këto transaksione të kombinuara. Rreth 5.2 për qind nuk prononcohet.



Pyetja 33,


kërkon të marrë informacion mbi faktin nëse firmat kanë ndërruar apo jo operator. Rezulton se 26.2 për qind e të intervistuarve kanë ndërruar operator dhe 56.0 për qind nuk e kanë ndërruar atë.

Pyetja 34,

kërkon të gjejë arsyet e ndërrimit të operatorëve të firmave në tregun e transaksioneve valutore duke renditur 8 të tilla. Rreth 17.8 për qind e të intervistuarve theksojnë se operatori i ri ofron një çmim më konkurrues, 16.8 për qind e tyre synojnë shpejtësinë, për 3.1 për qind ky ndërrim lidhet me evoluimin e kompanisë, 9.4 për qind synojnë korrektësinë dhe sigurinë, 3.7 për qind e të intervistuarve i lidhin arsyet e ndërrimit të operatorit me shërbime specifike (shtesë) që ofron operatori i ri, 5.2 për qind mendojnë se është më komode, 3.1 për qind mendojnë të përfitojnë nga lehtësira të tjera (këshillime etj.) dhe vetëm 1 për qind mendon se ka arsye të tjera, që nuk varen nga ata. Edhe në këtë pyetje zgjedhjet e përgjigjeve mund të jenë më shumë se një.

Pyetja 35,

kërkon të sigurojë informacion mbi numrin mesatar të transaksioneve valutore të kryera në një muaj. Rezulton se 38.2 për qind e bizneseve të intervistuar kryejnë mesatarisht 1-2 transaksione në muaj, 28.3 për qind 3-5 dhe 16.2 për qind kryejnë mbi 5 transaksione çdo muaj. Duhet thënë se 17.3 për qind e të intervistuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.



Pyetja 36,

kërkon të sigurojë informacion mbi sasinë e valutës, që këmbehet mestarisht në treg në një transaksion të vetëm duke renditur 4 zgjedhje. 42.9 për qind e të intervistuarve raportojnë vlerën deri në 10 mijë dollarë amerikanë, 30.4 për qind 10-50 mijë dollarë amerikanë, 5.2 për qind 50-100 mijë dollarë amerikanë dhe 3.7 për qind mbi 100 mijë dollarë amerikanë. Ata, të cilët nuk janë përgjigjur zënë 17.8 për qind të të intervistuarve.

Pyetja 37,

kërkon të zbulojë se sa kanë arritur bizneset të shmangin humbjet nga ndryshimi i kursit të këmbimit. Me fjalë të tjera, kërkohet të dihet se cila është shkalla e mbrojtjes nga rreziku i këmbimit valutë prej bizneseve. Rezulton se 21.5 për qind janë përgjigjur se kanë arritur të shmangin humbjet, 32.5 për qind nuk kanë arritur, 29.8 për qind i kanë provuar të dyja këto situata dhe 16.2 për qind nuk janë përgjigjur.

Pyetja 38,

kërkon të marrë informacion mbi mënyrën se si është vepruar në rastin kur bizneset i janë shmangur humbjeve. Përgjigjet rezultojnë të jenë nga më të ndryshmet. Por si alternativë më e shpeshtë del ndjekja e vazhdueshme e tregut të këmbimeve valutore (në 12.6 për qind të rasteve).

Pyetja 39,

kërkon të evidentojë nëse bizneset njohin bonot e thesarit. Nga përgjigjet del se 61.3 për qind e të intervistuarve e dinë se ç’janë bonot e thesarit dhe 38.2 për qind jo.

Pyetja 40,

u kërkon bizneseve opinion nëse paraqet interes për ta investimi në bono thesari. Vetëm 13.6 për qind e të intervistuarve i janë përgjigjur - po kësaj pyetjeje kur 85.3 për qind nuk tregon asnjë interes për këtë lloj investimi.

Pyetja 41,

kërkon arsyet, që shpjegojnë mungesën e interesit për investim në bono thesari. Pyetja është hartuar për t'u përgjigjur vetëm nga ai grup, që ka zgjedhur alternativën "Jo" në pyetjen 40. Pyetja ofron disa arsye për këtë. Nga përgjigjet rezulton se 64.4 për qind e atyre, që kanë thënë "jo" (ose 55 për qind e totalit të të intervistuarve) e lidhin këtë përgjigje me natyrën e kompanisë së tyre (kapitali i saj është tepër qarkullues), 23.3 për qind e tyre (ose 19.9 për qind të totalit të të intervistuarve) pohojnë se nuk kanë dijeni për procedurat e investimit në bono thesari dhe vetëm 4.2 për qind (ose 3.7 për qind të totalit të të intervistuarve) kanë patur arsye të tjera.

Pyetja 42,

kërkon të dijë nëse është investuar në bono thesari nga grupi i bizneseve të interesuar për këtë investim (kanë zgjedhur alternativën "Po" në pyetjen 40). Nga përgjigja rezulton se vetëm 1.6 për qind e të intervistuarve ose 3 biznese kanë investuar në bono.

Pyetja 43,

kërkon të marrë informacion mbi faktin nëse bizneset janë të qarta për procedurat e pjesëmarrjes në një ankand të bonove të thesarit. Nga përgjigjet rezulton se 14.7 për qind e të intervistuarve janë të qartë dhe 84.3 për qind e tyre nuk janë të qartë për to.

Pyetja 44,

bëhet për të sqaruar se ku qëndron paqartësia më e madhe për bizneset lidhur me procedurat e pjesëmarrjes në ankandet e bonove të thesarit. Jepen 6 alternativa, që nga përgjigjet rezultojnë të shpërndara në këtë mënyrë: 2.6 për qind pohojnë se janë të paqartë për vendin e paraqitjes, 6.3 për qind për mënyrën e paraqitjes, 58.6 për qind për procedurat, 4.7 për qind për kohën, 5.8 për qind për fitimin dhe 17.8 për qind për të tjera arsye, të cilat nuk i specifikojnë.

Pyetja 45,

kërkon të dijë vlerësimin e zyrave të këmbimit valutë lidhur me vëllimin e transaksioneve në tregun jozyrtar në krahasim me atë formal bankar tre vjet më

parë. Të katër të përgjigjurit mendojnë se tre vjet më parë vëllimi i transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar ishte më i madh se ai i kryer në tregun bankar. Me tre vjet më parë nënkuptohet viti 1996.

Pyetja 46,

kërkon të dijë vlerësimin e zyrave të këmbimit valutor lidhur me vëllimin e transaksioneve në tregun jozyrtar në krahasim me atë zyrtar bankar aktualisht, që do të thotë në vitin 1999 kur u krye vrojtimi. Një nga të përgjigjurit mendon se është më i madh, dy prej tyre se është më i vogël dhe një tjetër se është i barabartë.

Pyetja 47,

kërkon të dijë vlerësimin e zyrave të këmbimit valutor lidhur me vëllimin aktual ditë të transaksioneve të tregut jozyrtar (në dollarë amerikanë). Nga përgjigjet rezulton se një nga zyrat e këmbimit valutor vlerëson se ky treg kryen një volum transaksionesh deri në 500 mijë dollarë amerikanë në ditë ndërsa tre prej tyre e vlerësojnë këtë aktivitet me një vëllim mbi 1 milionë dollarë amerikanë në ditë.

Pyetja 48,

kërkon të marrë mendim mbi faktin nëse pjesa e tregut të këmbimeve valutore të zotëruara nga zyrat e këmbimit valutor në tre vitet e fundit ka ardhur në rritje. Nga përgjigjet rezulton se tre të anketuar pranojnë se ka rritje dhe vetëm një prej tyre se ka rënie.

Pyetja 49,

kërkon marrjen e informacionit mbi disa nga masat që mendojnë të ndërmarrin zyrat e këmbimit valutor nëse pjesa tyre në tregut ka rënë. Janë përgjigjur vetëm dy zyra të këmbimit valutor nga 4 që kanë kthyer përgjigje dhe rezulton se njëra mendon si rrugëzgjdhje formalizimin e tregut të valutave; ndërsa tjetra se këto ndryshime nuk varen prej tyre.

Pyetja 50,

kërkon informacion për renditjen, sipas rëndësisë të përdorimit, të katër valutave kryesore në momentin e intervistimit, që do të thotë 1999, dhe përpara tre vitesh, pra 1996. Për vitin 1996 rezulton se dy nga të intervistuarit kanë rradhitur të parin dollarin amerikan, të dytën liretën italiane, të tretën markën gjermane dhe të katërtën drahminë greke. Ndërsa dy të tjerë kanë vendosur vetëm një të parë dhe ky është dollari amerikan. E njëjta strukturë renditjeje rezulton edhe për periudhën e vitit 1999.

Pyetja 51,

kërkon informacion për statusin e klientëve të zyrave të këmbimit valutor para tre vitesh të ndarë në gjashtë kategori. Nga përgjigjet rezulton:

Zyra këmbimit valutor nr. 1: ka patur shumicën e klientëve firma biznesi;
Zyra këmbimit valutor nr. 2: ka patur shumicën e klientëve qytetarë;
Zyra këmbimit valutor nr. 3: ka patur shumicën e klientëve firma biznesi, kambistë të thjeshtë dhe qytetarë;
Zyra këmbimit valutor nr. 4: ka patur shumicën e klientëve qytetarë.

Pyetja 52,

kërkon të njëjtin informacion si pyetja 51, por për një moment tjetër kohor, atë të periudhës së intervistimit. Nga përgjigjet rezulton (ruhet e njëjta renditje zyrash për efekt krahasimi):

Zyra këmbimit valutor nr. 1: ka patur shumicën e klientëve qytetarë;
Zyra këmbimit valutor nr. 2: ka patur shumicën e klientëve qytetarë;
Zyra këmbimit valutor nr. 3: ka patur shumicën e klientëve firma biznesi, kambistë të thjeshtë dhe qytetarë;
Zyra këmbimit valutor nr. 4: ka patur shumicën e klientëve banka dhe qytetarë.

Pyetja 53,

kërkon të hedhë dritë mbi faktorët, që kanë çuar në ndryshimin e klientit kryesor të zyrave të këmbimit valutor duke renditur 7 alternativa. Arsyet, që paraqiten janë:

Zyra këmbimit valutor nr. 1: tendenca e qytetarëve për të operuar në mënyrë të sigurtë;
Zyra këmbimit valutor nr. 2: të tjera;
Zyra këmbimit valutor nr. 3: rritja e numrit të zyrave;
Zyra këmbimit valutor nr. 4: të tjera.

Pyetja 54,

kërkon të dijë si e konsiderojnë zyrat e këmbimit valutor ndarjen e pjesëmarrësve të tregut të brendshëm valutor në “aktorë kryesorë” dhe “aktorë të dytë”. Nga përgjigjet rezulton se të katër zyrat mendojnë se kjo ndarje është normale.

Pyetja 55,

kërkon të dijë se në ç’grup i vendosin zyrat e këmbimit valutor “aktorët kryesorë” duke ofruar tri alternativa. Nga përgjigjet rezulton se dy prej tyre quajnë bankat si

të tilla, një prej tyre vlerëson zyrat e këmbimit valutor si aktorë kryesorë dhe një tjetër vlerëson kambistët si më të rëndësishmit.

Pyetja 56,

dëshiron të marrë vlerësimin, që i bëjnë zyrat e këmbimit valutor faktit nëse kursi i këmbimit "i diktuar" nga "aktorët kryesorë" shpreh gjithmonë kursin e dëshiruar nga tregu. Nga përgjigjet rezulton se tri zyra këmbimi valutor, pra shumica zyrave që përgjigjen, mendojnë se ai e shpreh këtë kurs ndërsa njëra pohon të kundërtën.

Pyetja 57,

kërkon komentet e zyrave të këmbimit valutor, të cilat i përgjigjen negativisht pyetjes 56. Meqenëse vetëm një zyrë ka zgjedhur alternativën "Jo" në pyetjen e mësipërme, atëherë është marrë dhe një koment i vetëm ku shprehet se ky devijim mund të eliminohet kur bankat kryesore të ofrojnë shërbime më komplekse.

Pyetja 58,

kërkon të dijë opinionin e zyrave të këmbimit valutor mbi kohën që kërkohet për procesin e eliminimit të devijimit, pra nëse është një proces afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë. Nga përgjigjet rezulton se zyrat e këmbimit valutor kanë mendim të ndryshëm. Secila prej tyre ka zgjedhur njërin nga opsionet e ofruara.

Pyetja 59,

kërkon të marrë vlerësimin e zyrave të këmbimit valutor mbi faktin nëse statusi që ato kanë u përgjigjet zhvillimeve të fundit. Vetëm një nga zyrat e këmbimit valutor ka dhënë përgjigje pozitive. Dy të tjera kanë zgjedhur alternativën "Jo" dhe një zyrë nuk është përgjigjur.

I.1.5 Pyetjet e rubrikës së tretë.

Pyetjet e rubrikës së tretë kanë për qëllim të marrin informacion mbi hapësirat, që mund të ekzistojnë për shtrirje më të madhe të sistemit bankar. Është një rubrikë, që kërkon një vlerësim të perspektivave të sistemit bankar parë nga këndvështrimi i bizneseve. Ajo përbëhet nga 4 pyetje (60-63) dhe i përgjigjen bizneset dhe zyrat e këmbimit valutor.

Pyetja 60,

kërkon të mbledhë informacion mbi cilësinë e shërbimit bankar në rrethe. Sipas rezultateve del se 13.1 për qind e të intervistuarve janë përgjigjur se ky shërbim është i mirë, 13.1 për qind i mjaftueshëm dhe 19.4 për qind i dobët. Megjithatë, më shumë se gjysma e të intervistuarve, 54.5 për qind, nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Pyetja 61,

kërkon të dijë nëse bizneset gjykojnë se duhet të hapen banka të reja. Pyetja ofron tre alternativa përgjigjeje dhe lejon zgjedhjen e njëkohshme të alternativës së parë dhe të dytë. Nga përgjigjet rezulton se 73.8 për qind e të intervistuarve mendojnë se duhet të hapen banka private shqiptare kurse 6.8 për qind mendon se nuk duhen hapur ato. Nga ana tjetër, 67.0 për qind pohon se bankat e reja, që hapen, duhet të jenë private të huaja dhe 7.9 e të intervistuarve nuk e mbështesin këtë ide. Vetëm 10.5 për qind e të pyeturve janë përgjigjur se nuk dinë të gjykojnë për këtë problem.

Pyetja 62,

kërkon të dijë nëse bizneset e ndjejnë nevojën për më shumë sportele nga bankat ekzistuese. Nga përgjigja rezulton se 93.2 për qind e të pyeturve gjykojnë se duhet të ketë më shumë sportele nga bankat ekzistuese.

Pyetja 63,

kërkon të dijë vlerësimin e të intervistuarve mbi përshtatshmërinë e shtrirjes gjeografike të sporteleve. Nga përgjigjet rezulton se 36.1 për qind e të intervistuarve mendojnë se kjo shtrirje është e përshtatshme dhe 63.4 për qind thonë se ajo nuk është e tillë.

I.1.6 Shënime në fund të pyetësorit.

Pyetësori për biznesin ofron në fund dhe rubrikën “Shënime” ku secili prej të intervistuarve ka të drejtë të bëjë shënime shtesë, komente apo sugjerime si për problemet, që trajtohen në pyetësor ashtu edhe për të tjera jashtë këtij pyetësori.

Kjo rubrikë rezulton të jetë mbushur nga rreth gjysma e të intervistuarve. Nga këto shënime del se:

- * një numër i madh i bizneseve të intervistuar, rreth 41 për qind, nuk e njohin shërbimin bankar në rrethe, pra ato pohojnë të mos jenë në gjendje t'i kthejnë përgjigje pyetjes 60;

- * në një ose dy raste bëhen edhe komente të tjera si për shembull nëse bankat nuk japin kredi nuk bëhet fjalë për një zhvillim normal të biznesit nga i vogli tek i madhi;
- * ka vërejtje të tilla (në përgjigje të pyetjes 61) që, sipas të intervistuarit, duhet të ketë edhe banka shtetërore.

I.2 – Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit të dytë (banka dhe akademikë)⁷

I.2.1 Informacion i përgjithshëm

Pyetësi i dytë u shpërnda për plotësim në 11 banka dhe 35 individë. Qëllimi i zgjedhjes së këtij grupi ishte të kuptohej se si gjykohen problemet e sistemit bankar shqiptar nga vetë bankat, pjesë e këtij sistemi, dhe nga një grup individësh, që përfaqësonin punonjës të bankës qendrore, të bankave tregtare dhe akademikë, për të zbuluar mendimin profesional.

Nga bankat dhanë përgjigje vetëm 6 ose 54.5 për qind e të pyeturve gjithsej. Ky nivel përgjigjesh konsiderohet relativisht i kënaqshëm. Megjithatë, siç do të shihet në vijim, kjo shkallë përgjigjeje nuk ruhet edhe për pyetje të veçanta.

Nga individët dhanë përgjigje 14 ose 40 për qind e të pyeturve gjithsej. Krahasuar me bankat, shkalla e përgjigjeve është më e ulët për individët, megjithatë, konsiderohet e vlefshme për të marrë sinjale. Për pyetjet e veçanta, gjithashtu, nuk ruhet e njëjta shkallë përgjigjeje si për pyetësin.

Kështu, totali i rasteve të shqyrtuara arrin në 20 ku 30 për qind janë banka dhe 70 për qind janë individë. Shkalla e përgjigjes arrin mesatarisht në 48.8 për qind, e cila gjykohet e pranueshme. Megjithatë, numri i rasteve është mjaft i vogël, krahasuar me pyetësin e parë, kështu që përgjigjet mund të mos shprehin tendenca të përgjithësuara. Sidoqoftë, ato japin sinjale të vlefshme për t'u marrë në konsideratë.

I.2.2 Pyetjet e rubrikës së parë

Pyetjet e rubrikës së parë kanë për qëllim të tërheqin mendime mbi çështjen e çeljes së bankave me kapital shqiptar. Kjo rubrikë përbëhet nga 3 pyetje. Kësaj rubrike i përgjigjen bankat dhe individët.

⁷ Shih pyetësin në aneksin I.

Pyetja 1,

kërkon të marrë opinionin e të intervistuarve mbi mjaftueshmërinë e bankave, që veprojnë në Shqipëri. Nga përgjigjet rezulton që 20 për qind pohojnë se ato janë të mjaftueshme, 75 për qind pohojnë se ato nuk janë të mjaftueshme dhe 5 për qind nuk japin asnjë përgjigje.

Pyetja 2,

kërkon të hulumtojë disa nga arsyet si dhe arsyen (arsyet) kryesore, që ndikon (ndikojnë) në mosçeljen e bankave me kapital shqiptar duke tërhequr mendimin profesionist. Pyetja liston gjashtë zgjedhje për përgjigje. Prej zgjedhjeve të bëra rezulton që, 25 për qind mendojnë se nuk ka kapital të mjaftueshëm, 15 për qind shprehen se biznesi bankar nuk shihet si biznes fitimprurës, 5 për qind konfirmojnë se nuk njihen rregullat e licencimit, 10 për qind mendojnë se rregullat e licencimit janë shumë të shtrënguara, 15 për qind shprehen se konkurrenca nga bankat ekzistuese nuk lejon depërtimin në treg të bankave të reja dhe 70 për qind janë përgjigjur për arsye të tjera. Pyetja ofron zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Ndërsa, alternativa e gjashtë kërkon edhe specifikim, nga i cili rezultojnë arsye mjaft të ndryshme dhe nuk mund të evidentohet njëra si më kryesore.

Pyetja 3,

kërkon vlerësimin e të intervistuarve për rregullat e çeljes së një banke duke ofruar tri alternativa. Nga përgjigjet rezulton se 15 për qind mendojnë se ato janë konservatore, 80 për qind se janë të përshtatshme dhe 5 për qind se ato janë liberale.

I.2.3 Pyetjet e rubrikës së dytë

Pyetjet e rubrikës së dytë kanë për qëllim të zbulojnë se sa të kënaqura janë bankat me ecurinë e biznesit të tyre, sidomos në raport me planet që ato kanë bërë. Po kështu, rubrika jep informacion mbi gjykimin e bankave për tregun e bonove të thesarit, shtrirjen e rrjetit bankar dhe si mendohet zgjidhja e disa prej problemeve. Përsëri, vrojtimi është përqendruar te bankat dhe individët. Kjo rubrikë përbëhet nga 20 pyetje. Kësaj rubrike i përgjigjen të dyja grupet me klasifikimin e mëposhtëm:

- * pyetjeve 4-11 i përgjigjen vetëm bankat. Ky grup pyetjesh synon të sqarojë nivelin e realizimit të planeve, që kanë bërë vetë bankat, arsyet përkatëse si dhe ndikimi i faktorëve të tjerë;
- * pyetjeve 12-16 i përgjigjen bankat dhe individët. Ky grup pyetjesh synon të marrë opinion mbi deformimin e tregut bankar dhe të bonove të thesarit si dhe mendime mbi eliminimin e deformimeve;
- * pyetjes 17 i përgjigjen vetëm bankat;

- * pyetjeve 18-21 i përgjigjen të dyja grupet. Ky grup pyetjesh nuk ka një objekt të caktuar. Synimi është të thithet mendimi profesionist mbi çështje të ndryshme. Për këtë arsye, këto lloj pyetjesh kanë më tepër karakter cilësor;
- * pyetjes 22 i përgjigjen vetëm bankat;
- * pyetjes 23 i përgjigjen të dyja grupet.

Pyetja 4,


u drejtohet bankave për të mësuar se në ç'masë është realizuar plani i tyre për thithjen e depozitave duke ofruar tri alternativa. Pyetja është hartuar e tillë që lejon një mundësi zgjedhjeje dhe tenton të marrë një informacion sasior. Një nga bankat pohon se ka realizuar planin deri në 50 për qind, tri prej tyre e kanë realizuar në masën 50-100 për qind dhe dy banka e kanë realizuar këtë plan mbi 100 për qind.

Pyetja 5,

kërkon arsyet e realizimit të planit për thithjen e depozitave të deklaruar në pyetjen 4. Nëpërmjet pyetjes 5 synohet të kuptohen shkaqet, që ndikojnë më së shumti në aktivitetin depozitues. Një nga bankat përgjigjet se janë normat e interesit arsye e mundshme të tij, tre prej tyre kanë pohuar shërbimin dhe katër banka kanë specifikuar arsye të tjera si: garancia, ekzistenca në shumë qytete, pasiguria si dhe emri i bankës. Nga ana tjetër, asnjë nga bankat nuk ka konfirmuar publicitetin si arsye për realizim ose mosrealizim të planit.

Pyetja 6,

është e ngjashme me pyetjen 4, por fokusohet në një tjetër aktivitet. Kjo pyetje kërkon të dijë se në ç'masë është realizuar plani i kredidhënies. Në ndryshim nga pyetja 4, pyetja 6 ofron katër alternativa, tre të parat janë të njëjta ndërsa e katërta grupon rastet kur nuk është dhënë fare kredi. Alternativa e katërt është shtuar nisur nga specifika e sistemit bankar: kreditim në nivel të ulët. Edhe kjo pyetje është hartuar që të ofrojë si përgjigje vetëm një alternativë. Nga përgjigjet rezulton që dy banka vlerësojnë se realizimi është deri në 50 për qind, një bankë 50-100 për qind, një bankë mbi 100 për qind dhe dy banka nuk kanë dhënë asnjë kredi.



Pyetja 7,

është hartuar në ngjashmëri me pyetjen 5. Ajo kërkon nga bankat të vlerësojnë arsyet e shkallës së realizimit të planeve për aktivitetin kredidhënës. Nga përgjigjet rezulton se një bankë ka pohuar normat e interesit si arsye e nivelit të realizimit të kreditimit, një bankë ka vlerësuar shërbimin dhe një bankë kuadrin ligjor. Tre banka kanë specifikuar arsye të tjera si: mungesa e besimit te bankat shqiptare, ndalesat nga Banka e Shqipërisë dhe shpejtësia në marrjen e vendimeve. Njësoj si në pyetjen 5, edhe për këtë aktivitet, asnjë bankë nuk ka pranuar publicitetin si arsye të realizimit apo mosrealizimit të planit përkatës.

Pyetja 8,

kërkon të dijë nëse klientela depozituese e bankave është rritur me ritmet e parashikuara prej tyre. Nëse në pyetjen 4 bëhej fjalë për realizimin e planit për vëllim të depozitave, kjo pyetje kërkon të zbulojë nëse bankat kanë realizuar edhe parashikimet për tërheqjen e numrit të përshtatshëm të klientëve, pra, për të siguruar diversifikimin e burimeve. Katër prej bankave kanë pohuar se ajo është rritur me ritmet e parashikuara prej tyre dhe dy prej tyre pohuan të kundërtën.

Pyetja 9,

është e njëjtë në natyrë me pyetjen 8, por fokusohet në diversifikimin e portofolit të kredive. Ajo kërkon të dijë nëse klientela kredimarrëse e bankave është rritur me ritmet e parashikuara prej tyre. Dy prej bankave kanë pohuar se ajo është rritur me këto ritme dhe tri prej tyre pohojnë të kundërtën. Një nga bankat e intervistuarat nuk i është përgjigjur kësaj pyetjeje.

Pyetja 10,

është konceptuar si një pyetje cilësore dhe e drejtpërdrejtë. Ajo kërkon të dijë opinionet lidhur me kufirin e kreditit të përdorur në aktivitetin e bankës duke rreshtuar tre opsione. Pyetja është organizuar në dy shkallë pasi kërkon dhe arsyetim të opinionit të shprehur. Katër nga bankat kanë pohuar alternativën e parë dhe dy prej tyre të dytën. Asnjë bankë nuk ka zgjedhur alternativën e tretë.

Është për t'u shënuar edhe komenti, që kanë dhënë tre individë. Megjithëse pyetja është hartuar për të marrë përgjigje vetëm nga bankat, përsëri është e dobishme të jepen këto komente:

- * dy prej individëve kanë theksuar se kufiri i kreditit nuk ndikon fare sepse investohet në bono thesari;
- * individi i tretë pohon se kufiri i kreditit e ndihmon aktivitetin kredidhënës duke argumentuar se ai pengon keqësimin e strukturës së portofolit të kreditit.

Pyetja 11,

kërkon opinionin e bankave mbi faktin se si e gjykojnë ato krijimin e një regjistri të kredive. Pyetja lejon tre zgjedhje, që janë përjashtuese të njëra-tjetrës. Pyetjes i janë përgjigjur të gjashtë bankat dhe të gjitha mendojnë se krijimi i regjistrit do ta ndihmonte punën e tyre.

Pyetja 12,

kërkon të dijë si konsiderohet publiciteti i bërë nga bankat nisur nga këndvështrimi i vetë bankave dhe i individëve, pra jo më nga pozitat e biznesit (klientit). Pyetja ka dhe një shkallëzim, nëse zgjidhet alternativa e dytë si përgjigje, pasi kërkon edhe arsyen e këtij opinionit. Nga përgjigjet rezulton se 25 për qind e të intervistuarve pohojnë se ky shërbim është i mjaftueshëm, 50 për qind e tyre thonë se është i pamjaftueshëm dhe pjesa tjetër, pra 25 për qind, nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Nëse merren në shqyrtim vetëm bankat, shihet se katër prej tyre e konsiderojnë të mjaftueshëm publicitetin e bërë dhe dy prej tyre jo.

Si nga bankat dhe nga individët jepen dhe komentet përkatëse.

Pyetja 13,

kërkon të dijë gjykimin e bankave dhe të individëve mbi konkurrencën midis bankave. Nga përgjigjet rezulton se 40 për qind e të intervistuarve pohojnë se bankat kanë mundësi të njëjta konkurrence, 40 për qind se ato nuk kanë të njëjtat mundësi dhe 15 për qind përgjigjen se nuk e dinë.

Pyetja 14,

u kërkon të intervistuarve të rendisin se në cilat aktivitete ata mendojnë se ekziston monopoli në tregun bankar.

Nga përgjigjet, që kanë dhënë individët, del se ata vlerësojnë që ekziston monopoli në rradhë të parë në depozitat (8 nga 14 të pyeturit, pra rreth 60 për qind e tyre). Pjesa më e madhe e tyre përcaktojnë depozitat në lekë si treg monopol, por ka edhe raste kur përgjigjet specifikojnë depozitat e vogla, kursimet apo depozitat e Bankës së Kursimeve. Pesë të tjerët, që janë përgjigjur, përcaktojnë si të parë likuidimin e pagesave, portofolin e bonove të thesarit, kreditimin, transfertat me jashtë. Shërbime të tjera, që përcaktohen nga përgjigjet se kanë situata monopol, janë administrimi i pagesave, shërbimet për qeverinë, transfertat me gjeografi të përcaktuar dhe tregu sekondar i bonove të thesarit.

Nga përgjigjet, që kanë dhënë bankat, rezulton se nga gjashtë prej tyre vetëm 5 i janë përgjigjur pyetjes. Nga këto, 4 pohojnë se monopoli ekziston në rradhë të parë në depozitat në lekë. Si aktivitet tjetër me karakteristika monopoli ato kanë pohuar, gjithashtu, pagesat me Italinë apo Greqinë, pra me shpërndarje të caktuar gjeografike si dhe tregun e bonove të thesarit.

Opinionin se nuk ka monopol në tregun bankar është shprehur nga një individ dhe nga një bankë. Banka madje ka argumentuar se në strategjinë e tyre, bankat, parapëlqejnë dhe ushtrojnë ato aktivitete që gjykojnë vetë.

Pyetja 15,

kërkon të zbulojë se si konsiderohet konkurrenca në tregun e bonove të thesarit duke ofruar tre alternativa. Nga përgjigjet rezulton që 5 për qind e të intervistuarve pohojnë se ky është një treg konkurrues simetrik, 40 për qind e tyre thonë se ai është konkurrues josimetrik, 40 për qind pohojnë se nuk e dinë dhe 15 për qind nuk kthejnë përgjigje.

Pyetja 16,

është një shkallëzim i pyetjes 15. Kjo pyetje kërkon të marrë opinione mbi mënyrën se si mund të shmangët konkurrenca josimetrike e tregut të bonove të thesarit.

Nga përgjigjet e 3 individëve rezulton se: duhet të ndryshojë raporti i shitjeve të bonove në favor të publikut dhe bankat të luajnë edhe rolin e ndërmjetësit por gjithmonë mbi bazën e porosisë së klientit; të stimulohet tregtimi i bonove të thesarit; dhe se kjo situatë mund të shmangët duke qenë pjesmarrës në këtë treg përveç bankave edhe individët dhe kompanitë që ushtrojnë aktivitete të ndryshme në Shqipëri.

Nga përgjigjet e të dyja bankave rezulton se sipas tyre duhet të eliminohet pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë me të drejta të padiskutueshme, pra ajo të marrë pjesë si të gjitha bankat e tjera. Një bankë shprehet se duhet të eliminohet trajtimi preferencial i dhënë Bankës Kursimeve.

Pyetja 17,

kërkon të dijë nga bankat nëse ato marrin pjesë në tregun e bonove me kërkesa konkurruese ose jokonkurruese. Nga përgjigjet del se 4 banka kanë deklaruar që marrin pjesë në tregun e bonove me kërkesa konkurruese dhe 3 prej tyre me kërkesa jokonkurruese. Dy prej bankave kanë marrë pjesë me të dyja llojet e kërkesave. Një nga bankat nuk është përgjigjur fare.

Pyetja 18,

është një pyetje cilësore, që kërkon të zbulojë vërejtjet mbi tregun sekondar të bonove të thesarit.

Nga përgjigjet e individëve dhe të të trija bankave rezulton se ata paraqesin një sërë vërejtjesh. Vërejtja më e përsëritur është që ky treg pothuaj nuk ekziston.

Pyetja 19,

kërkon të dijë opinionin e të intervistuarve nëse privatizimi i bankave do të krijojë një mungesë shërbimesh në rrethet ku nuk ka banka private. Pasi është marrë mendimi i bizneseve kjo pyetje synon të marrë dhe gjykimin e profesionistëve. Po kështu, pyetja detajohet më tej, në rastin ku zgjidhet alternativa e parë si përgjigje, duke kërkuar arsyetimin për zgjedhjen përkatëse. Nga përgjigjet rezulton se 50 për qind e të intervistuarve pranojnë se do të ketë mungesa ndërsa 45 për qind thonë që nuk do të ketë. Arsyetimi i alternativës së parë në të shumtën e rasteve justifikohet me mbylljen e degëve jorentabël.

Pyetja 20,

kërkon vlerësimin e të intervistuarve për rregulloret në fuqi të Bankës së Shqipërisë duke kërkuar edhe arsyetimin përkatës në rast se si përgjigje zgjidhet alternativa e dytë dhe e tretë. Nga përgjigjet rezulton se 35 për qind e të intervistuarve i vlerësojnë ato si të përshtatshme, 25 për qind e tyre i vlerësojnë si jo të plota, 20 për qind si jo të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u zbatuar dhe 20 për qind të tjerë nuk janë përgjigjur. Komenti i vetëm, që është bërë për të specifikuar përgjigjen se ato janë jo të lehta për t'u kuptuar e zbatuar, është se *“ekziston konflikti midis termave “aktivitet financiar” dhe “biznes financiar”*

Pyetja 21,

kërkon opinione mbi skemën e sigurimit të depozitave, nëse duhet një skemë e tillë dhe pse. Nga përgjigjet rezulton se 85 për qind e të intervistuarve përgjigjen pozitivisht dhe vetëm 15 për qind e tyre përgjigjen negativisht.

Pyetja 22,

kërkon të dijë nëse klientët janë të kënaqur nga shkalla e ruajtjes së informacionit në banka sipas këndvështrimit të vetë bankave. Nga përgjigjet rezulton se pothuaj të gjitha bankat, me përjashtim të njëjës, që nuk përgjigjet, deklarojnë se klientët e tyre janë të kënaqur me konfidencialitetin që ato u ofrojnë.

Pyetja 23,

kërkon nga të intervistuarit të rradhitin arsyet kryesore pse një pjesë e aktivitetit prodhues/tregtar nuk kryhet nëpërmjet sistemit bankar. Është një pyetje me karakter cilësor, që kërkon të gjejë shpjegime mbi një fenomen karakteristik për Shqipërinë: mospërdorimi i kanaleve bankare për aktivitetin prodhues e tregtar.

I.2.4 Pyetjet e rubrikës së tretë

Pyetjet e rubrikës së tretë kanë për qëllim të marrin informacion mbi planet për zgjerimin e aktivitetit të bankave ekzistuese në të ardhmen e afërt (1-2 vjet). Është një rubrikë, që kërkon një vlerësim të perspektivave të sistemit bankar parë nga këndvështrimi i bankave. Kjo rubrikë përbëhet nga 7 pyetje (24-30). Kësaj rubrike i përgjigjen bankat. Ndërsa individët i përgjigjen vetëm pyetjes 30.

Pyetja 24,

kërkon të dijë nga bankat nëse ato mendojnë të zgjerojnë gamën e aktiviteteve të tyre. Nga përgjigjet rezulton se të gjitha bankat kanë plane për të zgjeruar aktivitetin e tyre.

Pyetja 25,

kërkon të zbulojë se në cilat fusha mendojnë bankat të zgjerojnë aktivitetin e tyre. Kjo pyetje ofron 5 alternativa përgjigjesh. Ajo është hartuar për të marrë përgjigje nga ato banka, që në pyetjen 24 kanë zgjedhur alternativën e parë dhe njëkohësisht lejon zgjedhjen e më shumë se një opsioni si përgjigje të mundshme. Nga përgjigjet e gjashtë bankave, që kanë pranuar të plotësojnë pyetësorët rezulton se për zgjerim aktiviteti në fushën e kredidhënies janë prononcuar të gjitha bankat; në fushën e investimeve në letrat me vlerë, është përgjigjur vetëm një bankë; zgjerimin e pranimin të depozitave e kanë pohuar katër banka; zgjerimin e shërbimeve të tjera ndaj klientëve e kanë zgjedhur pesë

banka dhe asnjë bankë nuk ka pohuar alternativën e pestë, që kërkonte specifikimin e të tjera aktiviteteve.

Pyetja 26,

është e ngjashme në natyrë me pyetjen 25, por në një kah të kundërt. Meqenëse nuk ka asnjë bankë, që në pyetjen 24 të ketë zgjedhur opsionin e dytë, pyetja 26 bie së bashku me alternativat që ajo jep.

Pyetja 27,

ka të njëjtën ide me pyetjen 24, por kërkon të dijë interesat e bankave për zgjerim të rrjetit bankar jashtë qytetit të Tiranës. Nga përgjigjet rezulton se pesë nga gjashtë bankat e përgjigjura kanë zgjedhur të thonë “Po” dhe vetëm një bankë është përgjigjur me “Jo”.

Pyetja 28,

është detajim i pyetjes 27 duke kërkuar informacion mbi qytetet e mundshme ku bankat planifikojnë të zgjerohen në një periudhë 1-2-vjeçare. Si e tillë ajo u drejtohet bankave, që kanë zgjedhur alternativën e parë në pyetjen më sipër. Nga përgjigjet rezulton se qytetet e synuara nga bankat janë Durrësi, Shkodra, Korça, Fieri dhe Vlora. Durrësi është në planet e tri bankave dhe Korça shfaqet në dy prej tyre. Megjithatë, një nga bankat është përgjigjur që kjo është një sekret dhe një tjetër ka pohuar se do të vendosë sipas zhvillimeve në përgjithësi.

Pyetja 29,

është detajim i pyetjes 27 duke kërkuar informacion mbi arsyet, që ndikojnë që bankat të mos synojnë zgjerim të rrjetit bankar jashtë qytetit të Tiranës. Si e tillë, pyetja i drejtohet bankave, që në pyetjen 27 kanë zgjedhur alternativën e dytë. Kjo pyetje ofron 5 arsye dhe lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative. Një bankë nuk mendon të zgjerojë rrjetin duke pohuar se shtrirja aktuale gjeografike i përgjigjet strategjisë së saj. Normalisht duhet të merrej vetëm kjo përgjigje. Sidoqoftë, një tjetër bankë ka zgjedhur të pohojë maturinë e saj në ekspansionin gjeografik duke pohuar se pasiguria e bën atë ngurruese të zgjerojë aktivitetin.

Pyetja 30,

kërkon të zbulojë se cili lloj banke mendohet si më i suksesshëm për Shqipërinë nisur nga këndvështrimi i bankave dhe individëve. Pyetja ofron katër mundësi zgjedhjeje duke lejuar përcaktimin e më shumë se një alternative. Nga përgjigjet rezulton se 65 për qind e të intervistuarve kanë zgjedhur bankat universale, 15

për qind bankat e specializuara, 20 për qind bankat kombëtare⁸ dhe 15 për qind bankat rajonale. Pyetja shkallëzohet më tej duke kërkuar komentet mbi zgjedhjet e bëra.

Gjithashtu, ka patur edhe të intervistuar, që janë shprehur se të gjitha tipet janë të përshtatshme ose se nuk dinë t'i përgjigjen.

Pesë banka kanë zgjedhur bankat universale si formën e mundshme.

I.2.5 Shënime në fund të pyetësorit

Pyetësi për bankat dhe individët ofron në fund dhe rubrikën “Shënime” ku secili prej të intervistuarve ka të drejtë të bëjë shënime shtesë, komente apo sugjerime si për problemet, që trajtohen në pyetësor ashtu edhe të tjera jashtë këtij pyetësi. Rezulton që asnjë nga të intervistuarit nuk i është përgjigjur kësaj rubrike.

⁸ Me termin “bankë kombëtare” nuk nënkuptohet bankë me kapital shqiptar. Ky emërtim përdoret për bankat, që kanë rrjet bankar të shtrirë gjerësisht në të gjithë vendin ose në pjesën më të madhe të tij. E kundërta e një banke kombëtare është banka rajonale, e cila ka shtrirje në zona shumë të kufizuara.

KAPITULLI II: REZULTATET E DALA NGA ANALIZA SISTEMATIKE E PYETJEVE KOMBINUARA TË TË DY PYETËSORËVE.

Për të arritur konkluzione më të qarta dhe më të sakta, që shërbejnë për të shpjeguar më mirë fenomenet apo problemet për të cilat është zhvilluar anketimi, janë kombinuar përgjigjet e disa pyetjeve, të cilat synojnë të shpjegojnë lidhjet e fenomeneve.

II.1. Rezultate të dala nga kombinimi i informacionit të pyetësorit të parë (biznese dhe zyra këmbimi valutor)

Rezultatet, sipas rastit, do të trajtohen në raport me numrin e të intervistuarve dhe/ose me numrin e të përgjigjurve për pyetjen në fjalë⁹.

II.1.1 Kombinime të pyetjeve të rubrikës “Informacion i përgjithshëm”

- I. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen II dhe III. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë nëse ka ndonjë përqendrim apo rregullshmëri në investimin e kapitalit shqiptar, atij të huaj dhe kapitalit të përbashkët.

Në tërësi bie në sy që nuk ka përqendrim të lartë në një aktivitet të caktuar. Pra, nuk mund të thuhet nëse origjina e kapitalit përcakton edhe fushën e investimit. Kështu, bizneset me kapital tërësisht shqiptar në 20.9 për qind të rasteve janë investuar në tregti (përqëndrimi më i lartë i vërejtur); si aktivitet i dytë del ndërtimi me 14.7 për qind dhe prodhimi renditet i treti me 12 për qind. Bizneset me kapital tërësisht të huaj janë përgjigjur në të shumtën e rasteve për ndërtimin (5.8 për qind) dhe më pas për aktivitetin e prodhimit (4.7 për qind). Ndërsa, bizneset me kapital të përbashkët zhvillojnë si aktivitet kryesor tregtinë, 13.1 për qind të rasteve, dhe të dytin renditin shërbimet, 4.7 për qind.

⁹ Kujtojmë që numri maksimal i mundshëm për përgjigje është 191 (187 biznese të mëdha dhe 4 zyra këmbimi). Po kështu, në rubrikat për të cilat kërkohen përgjigje vetëm nga zyrat e këmbimit do të jepen rastet e përgjigjeve pa u përpjekur të llogariten koeficientë apo të nxirren konkluzione si pasojë e numrit shumë të vogël të përgjigjeve.

Tabela 1: Shpërndarja e bizneseve sipas origjinës së kapitalit dhe aktivitetit ekonomik (%).

Aktiviteti ekonomik	Origjina e kapitalit		
	Tërësisht shqiptar	Tërësisht i huaj	I përbashkët
Prodhim	12.0	4.7	2.1
Tregti	20.9	2.6	13.1
Shërbime	10.5	3.7	4.7
Ndërtim	14.7	5.8	2.6
Të tjera	2.1		0.5
Totali me të cilin është llogaritur përqindja – 191			

II.1.2 Kombinime të pyetjeve të rubrikës së parë

II. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 1 dhe 2. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se ç'pjesë e bizneseve, që janë në dijeni se lejohet çelja e bankave private në Shqipëri, kanë menduar të çelin bankë. Kjo do të ndihmojë në krijimin e idesë së prirjes (interesi) që ka biznesi shqiptar për t'u angazhuar në biznesin bankar.

Në kapitullin e parë është thënë që një masë relativisht e madhe e bizneseve e dinë se në Shqipëri lejohet çelja e bankave private (97.4 për qind). Megjithatë, një pjesë e vogël e tyre kanë menduar të çelin bankë të vetën, vetëm 14 biznese ose 7.6 për qind, përkundrajt 92.4 për qind, që nuk e kanë menduar një gjë të tillë asnjëherë (*përqindja është llogaritur mbi numrin e përgjigjeve, që e dinë se lejohet çelja e bankave private në Shqipëri - 186. Në një rast, një biznes, që nuk e di se lejohet çelja e bankave private është përgjigjur se e ka menduar një gjë të tillë. Ky rast nuk është marrë parasysh në llogaritje*).

III. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 3.1 dhe III (në rubrikën "Informacion i përgjithshëm"). Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat lloj biznesesh, nisur nga aktiviteti ekonomik që ato zhvillojnë, deklarojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm për të çelur një bankë.

Nga 84 biznese, që deklarojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm për të çelur bankë, rreth 45.2 për qind e tyre merren me tregti, 19 për qind me ndërtim, 16.7 për qind me prodhim, 15.5 për qind me shërbime dhe 3.6 për qind me aktivitete të tjera. Është e qartë që kjo shpërndarje ndjek shpërndarjen në tërësi të aktiviteteve në të cilat janë të angazhuar bizneset e mëdha, ku aktivitet kryesor del tregtia. Për këtë arsye është e vlefshme të shihet se ç'përqindje e bizneseve, që deklarojnë se janë të angazhuar në një aktivitet të caktuar, kanë mungesë kapitali. Kështu, rreth 38.9 për qind e bizneseve të angazhuara në prodhim nuk kanë kapital të mjaftueshëm; për bizneset, që merren me tregti, kjo shifër është 54.3 për qind; për bizneset e angazhuara në shërbime rreth 36.1 për qind; për bizneset, që merren me ndërtim, 36.4 për qind; ndërsa nga 5 biznese, që deklarojnë se merren me të tjera aktivitete, 3 prej tyre nuk kanë kapital. Pra, një

numër relativisht i konsiderueshëm (po të kemi parasysh shkallën e mospërgjigjeve) deklarojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm.

IV. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 5 dhe 6. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se si konsiderohen kërkesat për licencimin e bankave nga ana e biznesit shqiptar. Gjetjet e këtij kombinimi ndihmojnë Bankën e Shqipërisë për të vlerësuar përshtatshmërinë e kërkesave për licencim. Rezultatet do të jepen në raport me numrin e të përgjigjurve për secilin kombinim. Kjo, për arsye se për të gjykuar mbi përshtatshmërinë e një kërkesë është e kuptimtë që të merret opinioni i atij grupi, që e njeh këtë kërkesë. Por, për një ide më të përgjithshme, aty ku ka kuptim, do të jepet dhe raporti me numrin total të të intervistuarve (191). Edhe pyetja 5 (shih pyetësonin në aneksin I) lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 47.1 për qind (90 biznese) njohin kërkesën për kapital minimal të kërkuar për licencimin e një banke. Interesante është të shihet që 88.9 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 5.6 për qind secila. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 41.9 për qind e tyre (afërsisht gjysma) e quajnë kërkesën të përshtatshme.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 45 për qind (86 biznese) njohin kërkesën për deklarimin e burimit të të ardhurave për licencimin e një banke. 89.7 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 4.6 për qind secila. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 40.8 për qind e tyre (afërsisht gjysma) e quajnë kërkesën të përshtatshme.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 36.6 për qind (70 biznese) njohin kërkesën për krijimin e ambjenteve të përshtatshme për licencimin e një banke. 88.7 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 5.6 dhe 4.2 për qind përkatësisht. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 33 për qind e tyre (pra 1/3) e quajnë kërkesën të përshtatshme.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 38.7 për qind (74 biznese) njohin kërkesën për planin e biznesit të nevojshëm për licencimin e një banke. 88 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 2.7 dhe 8 për qind, përkatësisht. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 34.6 për qind e tyre e quajnë kërkesën të përshtatshme.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 44.5 për qind (85 biznese) njohin kërkesën për administratorë të kualifikuar të nevojshëm për licencimin e një banke. 92.9 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 3.5 për qind secila. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 41.4 për qind e tyre e quajnë kërkesën të përshtatshme.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 31.4 për qind (60 biznese) njohin kërkesën për paraqitjen e raportit financiar sekret të nevojshëm për licencimin e një banke. 91.7 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 3.3 dhe 5 për qind përkatësisht. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 28.8 për qind e tyre e quajnë kërkesën të përshtatshme.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 31.9 për qind (61 biznese) njohin kërkesën për hartimin e procedurave dhe rregulloreve të brendshme të nevojshme për licencimin e një banke. 88.7 për qind e atyre, që e njohin këtë kërkesë, e konsiderojnë si të përshtatshme. Ndërsa, përgjigjet "konservatore" dhe "liberale" përbëjnë 4.8 për qind secila. E shprehur në raport me numrin total të të intervistuarve (191), vërejmë që 28.8 për qind e tyre e quajnë kërkesën të përshtatshme.

V. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 5 dhe 7. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cila është shkalla e informimit të publikut, dhe në rradhë të parë e biznesit, me rregullat e licencimit. Gjetjet e këtij kombinimi ndihmojnë Bankën e Shqipërisë për të vlerësuar nivelin e transparencës së saj dhe të shkallës së informimit të publikut. Edhe ky kombinim bëhet veçmas për çdo kërkesë, gjithashtu, për të ndihmuar Bankën e Shqipërisë në përcaktimin e një strategjie të detajuar për rritjen e informacionit. Rezultatet e marra nga ky kombinacion kanë akoma më tepër rëndësi nisur nga numri relativisht i madh (rreth 1/2) i bizneseve, që nuk kanë njohuri për kërkesat për licencim.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 48.2 për qind (92 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 69.6 për qind e atyre, që janë shprehur e ndjejnë nevojën për më shumë informacion në lidhje me kërkesën për kapital minimal të kërkuar për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 46.1 për qind (88 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 65.2 për qind e atyre, që janë shprehur, e ndjejnë nevojën për më shumë informacion në lidhje me kërkesën për deklarimin e burimit të të ardhurave të kërkuar për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 37.7 për qind (72 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 65.8 për qind e atyre, që janë shprehur, e ndjejnë nevojën për

më shumë informacion në lidhje me kërkesën për krijimin e ambjenteve të përshtatshme të nevojshme për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 39.8 për qind (76 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 64.9 për qind e atyre, që janë shprehur, e ndjejnë nevojën për më shumë informacion në lidhje me kërkesën për paraqitjen e planit të biznesit të nevojshëm për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 45.5 për qind (87 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 66.7 për qind e atyre, që janë shprehur, e ndjejnë nevojën për më shumë informacion në lidhje me kërkesën për administratorë të kualifikuar të kërkuar për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 31.9 për qind (61 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 62.3 për qind e atyre, që janë shprehur, e ndjejnë nevojën për më shumë informacion në lidhje me kërkesën për paraqitjen e raportit financiar sekret të kërkuar për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 31.9 për qind (61 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre. 62.9 për qind e atyre, që janë shprehur, e ndjejnë nevojën për më shumë informacion në lidhje me kërkesën për hartim rregullash e procedurash të brendshme të kërkuar për licencimin e një banke, ndërsa pjesa tjetër jo.

Nga 191 biznese të intervistuar, rreth 44 për qind (84 biznese) kanë dhënë opinionin e tyre në kombinimin e alternativës "nuk njoh asnjë kërkesë". Nga ky grup 38.2 për qind janë shprehur se kanë nevojë për më shumë informacion dhe 61.9 për qind se nuk e ndjejnë të nevojshme të kenë informacion.

VI. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 8 dhe 9. Ky kombinim ka për qëllim të konfirmojë se sa i interesuar është biznesi shqiptar për t'u angazhuar në biznesin bankar, duke përdorur edhe rrugë "gjysmë të gatshme", pra, blerjen e aksioneve të bankave, që privatizohen dhe cilat janë arsyet që mund t'i shtynjë këto biznese të mos jenë të gatshme të blejnë aksione.

Në kapitullin e parë është theksuar që 28.8 për qind e të intervistuarve deklarojnë se janë të gatshëm të blejnë aksione të bankave shtetërore të privatizuara ndërsa 71.2 për qind, jo. Vërehet që shpërndarja e përgjigjeve midis alternativave të dhëna është pothuaj e barabartë. Rreth 29.4 për qind e numrit të të përgjigjurve kanë zgjedhur alternativën e parë (nuk e konsiderojnë blerjen e aksioneve si alternativë të mirë investimi), 30.1 për qind kanë zgjedhur alternativën e dytë (nuk kanë dijeni për procedurat), 33.8 për qind kanë zgjedhur arsye të tjera dhe 6.7 për qind nuk kanë dhënë arsye për zgjedhjen e tyre (*për qindjet për secilën alternativë janë llogaritur mbi numrin e përgjigjeve, që*

shprehen se nuk janë të gatshëm të blejnë aksione të bankave shtetërore të privatizuara – 136).

II.1.3 Kombinime të pyetjeve të rubrikës së dytë

VII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 10/4 dhe pyetjet 11 e 12. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se me cilat banka është punuar për të siguruar kredi për financimin e biznesit. Në analizë merren dy grupe bankash: bankat shtetërore dhe bankat e tjera (private). Rezultatet e dala ndihmojnë për të krijuar një ide, qoftë edhe të përgjithshme, jo vetëm mbi nivelin e marrëdhënieve të biznesit me secilin grup bankash, por edhe për orientimin e ardhshëm të këtyre marrëdhënieve. Ndërsa, kombinimi i pyetjes 10/4 me pyetjen 12 është realizuar për efekt kontrolli. Nëse bizneset kanë përdorur kredinë e bankave si mjet financimi dhe në pyetjen 12 kanë zgjedhur alternativën e dytë, një gjë e tillë është e pakuptimtë. Nuk vërehet kjo lloj zgjedhjeje.

Siç është paraqitur në kapitullin e parë, vetëm 10.5 për qind (20 biznese) e të intervistuarve përdorin kredinë bankare si një mundësi financimi të aktivitetit të tyre. Rezulton që 35 për qind e tyre kanë kërkuar kredi nga bankat shtetërore dhe 65 për qind nga bankat private.

Megjithëse është një numër relativisht i vogël, përsëri vërejmë që në bankat private drejtohen për të marrë kredi gati dy herë më tepër biznese se në bankat shtetërore.

VIII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 11 dhe 12. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë shkallën e përfitimit të kredisë në secilin grup bankash (shtetërore dhe private).

Përgjigjet e dhëna tregojnë që në bankat shtetërore 18 biznese kanë kërkuar kredi dhe e kanë përfituar dhe 15 biznese kanë kërkuar kredi por nuk e kanë përfituar.

Në bankat private 23 biznese kanë kërkuar kredi dhe e kanë përfituar dhe 11 biznese kanë kërkuar kredi, por nuk e kanë përftuar.

IX. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 15 dhe pyetjen 17. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat banka janë më të ekspozuara ndaj largimit të llogarive e depozitave të klientëve, dhe në veçanti të biznesit, në rast se do të lejohej çelja e llogarive jashtë vendit.

Nga 164 biznese, që kanë deklaruar se kanë llogari në bankat shtetërore, 52 prej tyre, ose 31.7 për qind, janë përgjigjur se do ta transferonin llogarinë jashtë vendit, ndërsa 109 biznese, ose 66.5 për qind jo. Për bankat private situata

paraqitet pak më ndryshe. Nga 101 biznese, që kanë llogari në to, vetëm 40.6 për qind do ta transferonin llogarinë ndërsa 57.4 për qind jo.

- X. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 15 dhe pyetjen 18. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë shpërndarjen e llojeve të llogarive në bankat shtetërore e private.

Nga 164 biznese gjithsej të përgjigjura se kanë llogari pranë bankave shtetërore, vërejmë që 163 (99.4 për qind ose 85.3 për qind e të intervistuarve - 191) kanë llogari rrjedhëse, ndërsa 12 (7.3 për qind) kanë depozita me afat. Prej këtyre grupeve, 98.8 për qind i kanë llogaritë rrjedhëse të vendosura në lekë, ndërsa 6.1 për qind i kanë depozitat të vendosura në lekë dhe 1.2 për qind në valutë.

Po kështu, nga 101 biznese gjithsej të përgjigjura se kanë llogari pranë bankave private, vërejmë që 99 (98 për qind) kanë llogari rrjedhëse, ndërsa 11 (10.9 për qind) kanë depozita me afat. Prej këtyre grupeve, 93.1 për qind i kanë llogaritë rrjedhëse të vendosura në lekë, ndërsa 7.9 për qind i kanë depozitat të vendosura në lekë.

- XI. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 17 dhe pyetjen II (në rubrikën “Informacion i përgjithshëm”). Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat biznese janë më të prirura të transferojnë llogarinë jashtë, nisur nga origjina e kapitalit.

Nga 115 biznese me kapital tërësisht shqiptar, 32.3 për qind e tyre do ta transferonin jashtë llogarinë. Ky tregues për bizneset me kapital tërësisht të huaj dhe të përbashkët është përkatësisht 37.5 dhe 34.1 për qind.

Tabela 2. Shpërndarja e bizneseve, që do të transferojnë llogarinë jashtë, sipas origjinës së kapitalit (në raste).

Treguesit	Origjina e kapitalit		
	Tërësisht shqiptar	Tërësisht i huaj	I përbashkët
1. Biznese gjithsej	115	32	44
2. Do të transferojnë llogarinë	37	12	15

- XII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 17 dhe pyetjen III (në rubrikën “Informacion i përgjithshëm”). Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat biznese janë më të prirura të transferojnë llogarinë jashtë, nisur nga lloji i aktivitetit ekonomik.

Bazuar në aktivitetin ekonomik, në të cilin janë angazhuar, bizneset deklarojnë se do të transferojnë jashtë llogarinë 22.2 për qind e atyre që merren me prodhim; 32.9 e atyre që merren me tregti; 47.2 për qind e atyre që janë angazhuar në shërbime; 36.4 për qind e atyre që merren me ndërtim.

Tabela 3. Numri bizneseve, që do të transferojnë llogarinë jashtë, sipas llojit të aktivitetit (në raste).

Aktiviteti ekonomik	Biznese gjithsej	Do të transferojnë llogarinë
1. Prodhim	36	8
2. Tregti	70	23
3. Shërbim	36	17
4. Ndërtim	44	16
5. Të tjera	5	-

XIII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 19 dhe pyetjen 20. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë shpërndarjen e llojeve të pagesave, të ndryshme nga *cash* në bankat shtetërore e private, brenda dhe jashtë vendit.

Nga 191 biznese gjithsej të intervistuar, vërejmë që 125 (65.4 për qind) përdorin mjete pagese të ndryshme nga çeqet si brenda vendit ashtu edhe jashtë nëpërmjet bankave shtetërore. Nga 125 rastet e shënuara, 124 ose 99.2 për qind, janë pagesa me brenda. Kështu, me brenda, në 17 raste deklarohet se janë përdorur kartat e kreditit; në 122 raste çeqet dhe në 42 raste, të tjera. Për pagesat me jashtë kemi përkatësisht 1 rast me kartë krediti dhe 1 rast me çek.

Nga 191 biznese gjithsej të intervistuar, vërejmë që 83 (43.5 për qind) përdorin mjete pagese të ndryshme nga çeqet si brenda vendit ashtu edhe jashtë nëpërmjet bankave private. Nga 83 rastet e shënuara, 73 ose 88 për qind, janë pagesa me brenda. Kështu me brenda, në 9 raste deklarohet se janë përdorur kartat e kreditit; në 73 raste çeqet dhe në 18 raste, të tjera. Për pagesat me jashtë kemi përkatësisht 3 raste me kartë krediti, 11 raste me çek dhe 1 rast, të tjera.

XIV. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 23 dhe pyetjen 24. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se grupi i biznesit, i cili ndjen nevojën e përdorimit të instrumenteve dhe të shërbimeve të tjera nga bankat, cilat lloje do të preferonte më shumë. Gjetjet e këtij kombinimi mund të shërbejnë si një orientim i mirë për bankat për prezantimin e produkteve të reja.

Siç është paraqitur në kapitullin e parë, 77 për qind (147 biznese) e të intervistuarve shprehen se e ndjejnë të nevojshme të prezantohen produkte të reja. Gjithashtu, ky grup paraqet dhe disa alternativa për të justifikuar nevojën e prezantimit të produkteve të reja. Nga ky grup 54.4 për qind shprehen për letër kredinë; 73.4 për qind për kartat e kreditit; 15.6 për qind për çertifikatat e depozitave; 12.9 për qind për pranimet bankare, 29.3 për qind për shërbime arke; 17.7 për qind për investimet; 27.2 për qind për shërbimet e konsulencës; dhe vetëm 2 raste kanë dhënë të tjera instrumente.

XV. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 30 dhe pyetjen 31. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë cilësinë e plotësisht të pyetësorit apo dhënies së përgjigjes. Nëse ka përgjigje për alternativat 30/1, ose 30/2 ose 30/3 dhe njëkohësisht edhe për 31/2 atëherë përgjigjet janë pa kuptim.

Përgjigjet janë të sakta. Në asnjë rast nuk vërehet ky kombinim.

XVI. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 31 dhe pyetjen 32. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë shpërndarjen e operatorëve me të cilët kryhen transaksione.

Nga 153 biznese, që deklarojnë se kryejnë transaksione valutore, 43.8 për qind deklarojnë se punojnë me bankën, 22.9 për qind me zyrat e këmbimit valutore, 16.3 për qind me tregun paralel dhe 32 për qind kombinojnë operatorët.

XVII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 33 dhe pyetjen 34. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë arsyen (arsyet) kryesore të ndërrimit të operatorit nga ana e bizneseve.

Siç është dhënë dhe në kapitullin e parë, një pjesë e vogël e bizneseve kanë ndërruar operator, gjithsej 50 raste. Niveli i përgjigjeve për secilën arsye është si më poshtë: në 68 për qind, bizneset pranojnë se kanë ndërruar operator pasi është ofruar çmim më konkurrues; në 64 për qind për shkak se synojnë shpejtësinë në transaksion; në 12 për qind për arsye të evoluimit të biznesit; në 36 për qind është synuar korrektësia dhe siguria; në 14 për qind operatori i ri ka ofruar edhe shërbime shtesë specifike; në 20 për qind ka qenë më komode ndërrimi i operatorit; në 12 për qind janë përfutur lehtësira dhe vetëm 4 për qind shprehen se kanë ndërruar operator për arsye, që nuk varen prej tyre.

XVIII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 35 dhe pyetjen 36. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë madhësinë e atij segmenti të tregut valutore të përbërë nga bizneset e mëdha. Kjo sepse kombinon numrin e transaksioneve me vlerën e transaksionit.

Së pari, theksohet që rezultatet e kombinimit janë të kuptimta pasi niveli i përgjigjeve është i lartë. Për të dyja pyetjet nuk janë përgjigjur përkatësisht 33 dhe 34 biznese nga 191 të mundshme. Ndërsa, në kombinimin e tyre, numri i rasteve të munguara është 36 ose kemi 155 raste të përgjigjura.

Tabela 4. Shpërndarja e përgjigjeve sipas numrit të transaksioneve dhe vlerës së tyre (në raste).

Pyetja 35	Pyetja 36			
	Nën 10 000 usd	10-50 mijë usd	50-100 mijë usd	Mbi 100 000 – usd
1-2 transaksione	46	19	3	2
3-5 transaksione	21	27	3	3
Mbi 5 transaks.	13	12	4	2

Tabela 5. Shpërndarja e përgjigjeve sipas numrit të transaksioneve dhe vlerës së tyre (në %).

Pyetja 35	Pyetja 36			
	- 10 000 usd	10-50 mijë usd	50-100 mijë usd	100 000 - usd
1-2 transaksione	29.3	12.1	1.9	1.3
3-5 transaksione	13.4	17.2	1.9	1.9
Mbi 5 transaks.	8.3	7.6	2.5	1.3

Tabela 6. Mesataret e ponderuara të vlerave për çdo grup transaksioni¹⁰.

Alternativat	Vlera mesatare
1-2 transaksione	18 214
3-5 transaksione	28 056
Mbi 5 transaks.	31 452

Tabela 7. Mesatarja e ponderuar e numrit të transaksioneve për çdo grup vlerash të tyre¹¹.

Alternativat	Numri mesatar i transaksioneve
Nën 10000 usd	2.9
10000-50000 usd	3.6
50000-100000 usd	4.1
Mbi 100000 usd	3.9

XIX. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 39 dhe pyetjen 40. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë nivelin e bizneseve që janë të interesuar të investojnë në bonot e thesarit ndërmjet atij grupi që ka njohuri për to.

Rreth 117 të intervistuar janë përgjigjur se i njohin bonot e thesarit. Por, vetëm 20.5 për qind e tyre (ose 12.6 për qind e të intervistuarve gjithsej) thonë se bonot paraqesin interes për investim, ndërsa 79.5 për qind jo.

XX. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 40 dhe pyetjen 41. Pasi arrihet në konkluzionin që një pjesë relativisht e vogël e bizneseve kanë interes për të investuar në bono thesari, ky kombinim ka për qëllim të zbulojë shkaqet e këtij fenomeni.

¹⁰ Vlerat mesatare janë llogaritur duke shumëzuar mesin (mesatarja e thjeshtë arithmetike) e çdo intervali vlerash me numrin e rasteve të përgjigjura. Shuma për të gjitha alternativat pjesëtohet me numrin total të rasteve të çdo grupi transaksionesh. Intervallet e hapura janë mbyllur duke vendosur 0 në alternativën e parë dhe 150 mijë dollarë amerikanë në alternativën e fundit për të respektuar hapësirën e dy alternativave të tjera. Për shembull, për grupin "1-2 transaksione" kemi marrë: alternativa e parë 0-10000 usd; mesi 5000 usd; numri i rasteve të përgjigjura është 46; alternativa e dytë 10000-50000 usd; mesi 30000 usd; numri i rasteve të përgjigjura është 19; alternativa e parë 50000-100000 usd; mesi 75000 usd; numri i rasteve të përgjigjura është 3; alternativa e parë 100000-150000 usd; mesi 125000 usd; numri i rasteve të përgjigjura është 2. Vlera mesatare e transaksionit për këtë grup është: $[(5000 \times 46) + (30000 \times 19) + (75000 \times 3) + (125000 \times 2)] / 70 = 18214$ usd.

¹¹ Vepohet njësoj si për tabelën më sipër vetëm se nivelet e mesit aplikohen për numër të transaksioneve.


Rreth 163 të intervistuar janë përgjigjur se nuk kanë interes të investojnë në bonot e thesarit. Nga këta, 105 ose 64.4 për qind kanë si arsye natyrën e biznesit. Kapitali i tyre është tepër qarkullues dhe kuptohet nuk kanë fonde të lira për periudha afatshkurtra që të mund t'i bllokojnë. 38 biznese ose 23.3 për qind nuk kanë dijëni për procedurat dhe vetëm 7 biznese nxjerrin të tjera arsye.

XXI. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 40 dhe pyetjen 42. Pasi arrihet në konkluzionin që një pjesë relativisht e vogël e bizneseve kanë interes për të investuar në bono thesari, ky kombinim ka për qëllim të zbulojë sa është realizuar ky interes.

Rreth 26 të intervistuar janë përgjigjur se kanë interes të investojnë në bonot e thesarit. Prej tyre vetëm 3 kanë investuar, 88.5 për qind e tyre jo.

XXII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 41/1 dhe pyetjen III (në rubrikën "Informacion i përgjithshëm"). Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se si është shpërndarja e bizneseve, që deklarojnë se kapitali i kompanisë është tepër qarkullues dhe nuk mund të investojnë në bono thesari sipas aktivitetit ekonomik.

Nga 105 biznese, që kanë zgjedhur këtë alternativë, 16.2 për qind merren me prodhim; 40 për qind me tregti; 17.1 për qind më shërbime; 23 për qind me ndërtim dhe 2.9 për qind me aktivitete të tjera.



XXIII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 43/2 dhe pyetjen 44. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat janë paqartësitë më të mëdha ndër grupet e bizneseve, që kanë shprehur se nuk janë të qarta për pjesëmarrje në ankande të bonove të thesarit. Përgjigjet e dhëna shërbejnë si një orientim i mirë për të përqendruar punën për publikimin dhe propagandimin e këtyre elementeve për të përmirësuar funksionimin e tregut.

Rreth 161 të intervistuar janë përgjigjur se nuk janë të qartë për procedurat. Prej tyre gjejmë këto arsye: 3.1 për qind nuk dinë vendin ku duhet të paraqiten; 7.5 për qind nuk dinë mënyrën se si duhet të paraqiten; 69.6 për qind nuk njohin procedurat; 5.6 për qind nuk dinë kohën kur duhet të paraqiten; 6.8 për qind nuk dinë sa është fitimi, që mund të sigurojnë prej këtij investimi; 21.1 për qind japin të tjera arsye.

II.2. Rezultatet e dala nga kombinimi i informacionit të pyetësorit të dytë (banka dhe individë)

Rezultatet, sipas rastit, do të trajtohen në raport me numrin e të intervistuar dhe/ose me numrin e të përgjigjurve për pyetjen në fjalë¹² dhe do të shprehen me raste.

II.2.1 Kombinime të pyetjeve të rubrikës së dytë

XXIV. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 4 dhe pyetjen 5. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat janë arsyet, që kanë ndikuar në realizimin e planeve të bëra nga bankat për thithjen e depozitave.

Nga rezultatet e dhëna nuk mund të konkludohet se cili është shkaku kryesor, që ka ndikuar në realizimin në një shkallë të caktuar të planeve për thithje depozitash. Meqenëse kemi të bëjmë me depozita kuptohet që si arsye madhore duhej të dilte norma e interesit e aplikuar. Në fakt, kjo arsye shpjegon vetëm një rast të vetëm kur banka e ka realizuar planin e saj në masën mbi 100 për qind. Cilësia e shërbimit, po ashtu deklarohet si arsye në një rast realizimi mbi 100 për qind dhe në dy raste në masën 50-100 për qind. Pra, mund të thuhet se një cilësi jo e mirë shërbimi ndikon në mosrealizimin e planit. Në katër raste jepen arsye të tjera për realizimin në masën mbi 100 për qind (1 rast), 50 - 100 për qind (dy raste) dhe deri në 50 për qind (1 rast). Por, një fakt mund të konfirmohet, në asnjë rast publiciteti nuk del si arsye që të ketë ndikuar në realizimin e planit.

XXV. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 4 dhe pyetjen 8. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cili ka qenë, në fund të fundit, interesi i vetë bankave në lidhje me depozitimet si dhe të kontrollojë saktësinë e përgjigjes.

Konkludohet që kjo pyetje është kuptuar dhe përgjigjet janë të sakta. Klientela depozituese nuk është rritur, me ritmet e parashikuara, në 2 raste. Në të parin banka e ka realizuar planin për thithjen e depozitave deri në 50 për qind dhe kjo

¹² Kujtojmë që numri maksimal i mundshëm për përgjigje është 20 (6 banka dhe 14 individë).

është e kuptueshme që ajo ta konsiderojë se nuk janë vërtetuar ritmet parashikuara. Në rastin tjetër banka e ka realizuar planin për thithjen e depozitave nga 50 deri në 100 për qind, por ajo përsëri ka pretenduar për më tepër.

Nga ana ana tjetër, klientela depozituese është rritur me ritmet e parashikuara në 4 raste. Në dy të parat banka e ka realizuar planin për thithjen e depozitave deri në 50 për qind. Kjo nënkupton që vetë bankat nuk kanë patur interes për të qenë më agresive. Në të dyja rastet e tjera banka e ka realizuar planin për thithjen e depozitave mbi 100 për qind.

XXVI. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 6 dhe pyetjen 7. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cilat janë arsyet, që kanë ndikuar në realizimin e planeve të bëra nga bankat për dhënien e kredive.

Në këtë kombinim janë dhënë përgjigje për gjashtë raste. Njësoj si për depozitat, nga rezultatet e dhëna nuk mund të konkludohet së cili është shkaku kryesor, që ka ndikuar në realizimin, në një shkallë të caktuar, të planeve për dhënie kredish. Norma e interesit del si arsye për shpjegimin e realizimit të planit të dhënies së kredive në masën mbi 100 për qind vetëm në një rast. Cilësia e shërbimit, po ashtu, deklarohet si arsye në një rast realizimi në masën 50-100 për qind. Kuadri ligjor shpjegon vetëm një rast të realizimit të planeve deri në 50 për qind, pra në një nivel relativisht të ulët. Në tre raste jepen arsye të tjera për realizimin në masën mbi 100 për qind (1 rast), deri në 50 për qind (1 rast) dhe që nuk ka dhënë kredi (1 rast). Njësoj si për depozitat mund të konfirmohet se në asnjë rast publiciteti nuk del si arsye që të ketë ndikuar në realizimin e planit.

XXVII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 6 dhe pyetjen 9. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se cili ka qenë, në fund të fundit, interesi i vetë bankave në lidhje me kreditimet si dhe të kontrollojë saktësinë e përgjigjes.

Konkludohet që kjo pyetje është kuptuar dhe përgjigjet janë të sakta. Huamarrësit janë rritur me ritmet e parashikuara në 2 raste. Në të parin banka e ka realizuar planin për kreditim nga 50 deri në 100 për qind. Kjo nënkupton që vetë banka nuk ka patur interes për të qenë më agresive. Në rastin tjetër banka e ka realizuar planin për kreditim mbi 100 për qind.

Nga ana ana tjetër, huamarrësit nuk janë rritur me ritmet e parashikuara në 3 raste. Në dy të parat banka e ka realizuar planin për kreditim deri në 50 për qind dhe kjo është e kuptueshme që ajo ta konsiderojë se nuk janë vërtetuar ritmet parashikuara. Në rastin tjetër banka nuk ka dhënë kredi.

XXVIII. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 6 dhe pyetjen 10. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë se sa realistë janë në pretendimet e tyre për kufirin e kreditit.

Gjithsej janë gjashtë përgjigje prej të cilave 4 raste janë deklaruar se pengon aktivitetin kredidhënës të bankës. Në këtë grup, dy banka nuk kanë dhënë fare kredi dhe dy të tjerat e kanë realizuar planin e kreditimit në nivel mjaft të ulët, deri në 50 për qind.

Nga ana tjetër, dy banka, që i kanë realizuar planet e kreditimit përkatësisht 50-100 për qind dhe mbi 100 për qind, janë shprehur se kufiri i kreditit ndihmon aktivitetin huadhënës të bankës.

II.2.2 Kombinime të pyetjeve të rubrikës së tretë

XXIX. Kombinon përgjigjet e dhëna për pyetjen 27 dhe pyetjen 29. Ky kombinim ka për qëllim të zbulojë arsyet, që favorizojnë shtrirjen ose jo të rrjetit bankar jashtë Tiranës.

Në përgjigjen e vetme të dhënë banka nuk ka për synim të shtrijë aktivitetin në qytete jashtë Tiranës, pasi shtrirja gjeografike aktuale i përgjigjet strategjisë së saj.

KAPITULLI III: KOMENTE MBI REZULTATET E DALA NGA ANALIZA SISTEMATIKE E PYETJEVE TË TË DY PYETËSORËVE

Ky kapitull bën komentin e rezultateve të përfituara nga përpunimi i përgjigjeve të marra nga pyetjet e thjeshta si edhe nga kombinimi i tyre. Komentet janë renditur për të trajtuar një problem të caktuar, pra nuk ndjekin rubrikat e pyetësorëve apo një për një pyetjet e tyre. Qëllimi është që të dalin në pah problemet për çdo çështje.

III.1 – Informacioni i përgjithshëm (komente mbi rubrikën “Informacion i përgjithshëm” i pyetësorit të biznesit – pyetjet I, II, III dhe IV)


Biznesi i madh shqiptar është i organizuar kryesisht në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (80.6 për qind). Ende në Shqipëri është në nivel të ulët organizimi në formën e shoqërisë aksionere. Përveç të tjerash, ky është një tregues i traditës dhe i kulturës në zhvillimin e biznesit, që do të thotë se preferohen më tepër forma me një ose pak pronarë se sa bashkimi i shumë aksionerëve. Pra, biznesi mbetet si një aktivitet i mbyllur. Kjo deri diku ndikon edhe në shkallën e ulët të nevojave për zhvillim të tregut të kapitaleve.

Biznesi i madh, në masën më të madhe, posedohet nga shqiptarët. Rreth 60.2 për qind e bizneseve të mëdha janë me kapital tërësisht shqiptar. Shifra prej 16.8 për qind e bizneseve të mëdha me kapital tërësisht të huaj konsiderohet e ulët. Ky është një tregues i nivelit relativisht të ulët të investimeve të huaja në vend, sidomos investimeve të rëndësishme.

Biznesi i madh shqiptar merret kryesisht me aktivitetin e tregtisë (36.6 për qind) dhe të ndërtimit (23 për qind). Aktiviteti i prodhimit është në nivel relativisht të ulët, 18.8 për qind. Kjo tregon që në tërësi, biznesi i madh shqiptar është ende i angazhuar në aktivitete, që kërkojnë pak investim dhe kanë fitim më të shpejtë. Ky fenomen është i dobishëm në vitet e para për të krijuar kapitalin e nevojshëm. Pothuaj i njëjti model shpërndarjeje vërehet edhe në grupet e bizneseve të strukturuar sipas origjinës së kapitalit. Bizneset me kapital tërësisht shqiptar dhe të përbashkët si aktivitet të parë rendisin tregtinë. Ndërsa bizneset me kapital tërësisht të huaj rendisin ndërtimin. Në këtë mënyrë, edhe investitorët e huaj nuk janë shtrirë në Shqipëri në fusha, zhvillimi i të cilave do të ndihmonte rritjen e qëndrueshme të ekonomisë dhe sidomos në rritjen e eksporteve. Ky konkluzion konfirmohet dhe nga numri relativisht i ulët i bizneseve, që kanë pranuar se merren me aktivitet eksporti (pyetja 30 – pyetësi I).

Po ashtu, mund të thuhet që për të gjitha llojet e aktiviteteve, biznesi me kapital tërësisht shqiptar ka peshat më të larta krahasuar me dy llojet e tjera të kapitalit (kombinimi I).

Pjesa më e madhe e bizneseve janë themeluar në periudhën 1992-1996 (79.6 për qind e tyre) ose në një interval më të ngushtë 1992-1994 (56 për qind e tyre). Kjo është e kuptueshme pasi lejimi i veprimtarisë private në këtë periudhë krijoi hapësira që individët të angazhoheshin në biznes. Mbi gjysma e biznesit të madh ka moshë mesatare 6 vjet. Megjithatë, vërehet që zanafilla e bizneseve të mëdha është nga viti 1928. Bizneset e krijuara deri në vitin 1989 madje deri në vitin 1992 përfaqësojnë ish-ndërmarrje shtetërore, që vazhdojnë të jenë të tilla ose janë privatizuar sot dhe që kanë arritur të mbijetojnë. Megjithatë, në tërësi mosha e biznesit është më pak se 10 vjet, pra gjykohet e papërshtatshme për angazhim në aktivitete, që kërkojnë investim relativisht të madh dhe me norma fitimi më të ulëta ose me një periudhë të gjatë kohe të kthyeshmërisë së investimit siç është prodhimi apo biznesi bankar.



III.2 - Çelja e bankave private me kapital shqiptar

Prej kohësh opinionin në vend po e shqetëson fakti i mungesës së bankave private me kapital shqiptar. Ky opinion është forcuar sidomos me shpalljen e strategjisë për privatizimin e bankave me kapital shtetëror. Banka Kombëtare Tregtare u ble nga tre aksionerë kryesorë, që përfaqësojnë investitorë të huaj. Në ligjin e privatizimit të Bankës së Kursimeve, po ashtu, është përcaktuar që

synimi është të gjendet një investitor strategjik i huaj. Nga ana tjetër, sistemi bankar shqiptar aktualisht ka 11 banka private me kapital tërësisht të huaj ose ku partneri i huaj mbizotëron. Nga kjo situatë po gjen vend gjithnjë e më tepër shprehja: “Pse nuk ka banka private me kapital shqiptar?”.

Banka e Shqipërisë në pozicionin e saj si licencuese e bankave dhe rregullatore e tyre “nuk ka të drejtë morale” të bëjë diferencime midis bankave nisur nga origjina e kapitalit. Duke patur një objektiv më madhor për të arritur, që është një sistem bankar i qëndrueshëm dhe eficient, vëmendja e saj përqendrohet në ato masa, që sigurojnë arritjen e këtij objekti. Megjithatë, fenomeni i mungesës së bankave private me kapital shqiptar tërheq vëmendjen si një çështje, që ka nevojë të studjohet.

Në këtë pikëpamje, në të dy pyetësorët, atë të biznesit dhe atë të bankave e akademikëve, u kërkua opinion mbi mungesën e bankave me kapital privat shqiptar.

Është e qartë që në fillim kërkohet të dihet nëse biznesi i madh është në dijeni të faktit se lejohet çelja e bankave private (pyetja 1 – pyetësori i biznesit¹³) dhe a dihet se cili institucion të lejon të çelësh bankë (pyetja 4 – pyetësori I). Është pozitive që njihet gjerësisht rregulli se lejohet çelja e bankave private në Shqipëri dhe që 62.3 për qind e të intervistuarve e dinë se licencën e jep Banka e Shqipërisë. Megjithatë, konsiderohet e lartë edhe përqindja (rreth 20) e atyre, që këtë të drejtë ia njohin Ministrisë së Financave. Po kështu, konsiderohet si fenomen jopozitiv që ende Bankës së Shqipërisë i referohen me emërtime të tjera si Banka Kombëtare, Banka Shqiptare apo Banka e Shtetit, rreth 12 për qind e biznesit.

Si hap i dytë, ka rëndësi të thithet opinion mbi faktin nëse ka hapësira për zgjerim të sistemit bankar shqiptar (pyetja 61- pyetësori i biznesit dhe pyetja 1 – pyetësori i bankave dhe i akademikëve¹⁴). Mund të themi që shumica e të intervistuarve pranojnë se bankat ekzistuese në Shqipëri nuk janë të mjaftueshme. Biznesi mbështet idenë për çelje bankash private, pavarësisht nëse janë të huaja apo shqiptare. Kjo do të thotë që ka hapësira për zgjerim sasior, duke shtuar numrin e bankave dhe njësisive bankare.

Nisur nga qëllimi për të studjuar çështjen e çeljes së bankave private shqiptare, është kërkuar opinion nga biznesi mbi faktin nëse ai e ka menduar ndonjëherë të çelë ose jo bankë (pyetja 2 – pyetësori I). Përgjigjet e dhëna tregojnë se grupi i bizneseve, që ka menduar për çelje banke është minimal (kombinimi II).

¹³ Pyetësorit të biznesit për thjeshtësi do t'i referohemi pyetësori I.

¹⁴ Pyetësorit të bankave dhe akademikëve për thjeshtësi do t'i referohemi pyetësori II.

Përsa i përket çeljes së bankave me kapital shqiptar (pyetja 3- pyetësi I dhe pyetja 2 – pyetësi II) nuk mund të konkludohet një arsye e vetme e veçantë që pengon këtë gjë. Pra, çdo arsye ka ndikimin e vet, rezultatja e të gjithave është mungesa e këtij grupi bankash. Duhet kujtuar që, në fakt, përgjigjet për këtë çështje përbëjnë një gjykim që bankat dhe individët i bëjnë biznesit shqiptar dhe mundësive që ai ka për t'u angazhuar në biznesin bankar si dhe gjykimi që biznesi i bën vetvetes. Në përgjithësi, konkluzionet janë të ngjashme për të dyja grupet. Mungesa e kapitalit të mjaftueshëm konsiderohet si një faktor i rëndësishëm (rreth 50 për qind e bizneseve dhe rreth ¼ e bankave dhe e individëve e konfirmojnë këtë fakt). Gjithashtu, biznesi konfirmon se nuk e njej këtë lloj aktiviteti dhe për më tepër pohon se nuk ka specialistë të kësaj fushe. Por, në ndryshim nga biznesi, bankat dhe individët i kanë lënë më tepër hapësira vetes që të japin të tjera arsye për mungesën e bankave shqiptare (rreth 70 për qind kanë zgjedhur alternativën “të tjera”). Megjithëse opinionet janë individuale si për banka dhe individë përsëri vlen të theksojmë se midis tyre janë dhënë mendime racionale por dhe opinione jo tepër të vlefshme. Është mëse e vërtetë që ka mungesë besueshmërie, reputacioni dhe aftësie drejtuese apo përvoje drejtuese dhe këta janë faktorë të rëndësishëm për çeljen e një banke. Por, nga ana tjetër, mungesa e stabilitetit makroekonomik, mungesa e sigurisë dhe e rendit si dhe risku i lartë janë arsye, që do të renditeshin në fund me pak ndikim në këtë çështje, sidomos kur këto pohime bëhen nga vetë bankat. Kjo sepse, edhe në këto kushte, në Shqipëri janë çelur banka, madje banka të huaja. Për më tepër, në vitin 1997 kanë filluar aktivitetin dy banka dhe janë dhënë licenca paraprake.

Megjithatë, më tepër tërheq vëmendjen arsyeja e mungesës së kapitalit. Duke lexuar një rezultat të tillë, reagimi i parë do të ishte reduktimi i kërkesës për kapital. Prandaj është parë me interes të eksplorohet më tej duke kërkuar të identifikohet nëse bizneset, që shprehen se nuk kanë kapital të mjaftueshëm, kanë ngjashmëri nga pikëpamja e aktivitetit ekonomik që kryejnë. Vërehet që mbi gjysma e bizneseve, që merren me aktivitet tregtar, deklarojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm. Duke patur parasysh që me këtë aktivitet merret rreth 40 për qind e biznesit të madh, është e qartë që mungesa e kapitalit do të dalë si arsye kryesore. Kjo sepse aktiviteti tregtar kërkon kapital qarkullues dhe likuid. Nga ana tjetër, normat e fitimit janë me diferenca të konsiderueshme që nuk shkakton tek bizneset tregtare dëshirën e zhvendosjes (zëvendësimi i llojit të biznesit nga tregtar në bankar nuk është tërheqës).

Përsa i përket aktiviteteve të tjera, përsëri mbi 1/3 deklarojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm. Në tërësi, mendohet që biznesi i madh ende nuk ka krijuar fonde të konsiderueshme të disponueshme për investime të tilla (kombinimi III).

Një arsye, që ndikon çeljen e bankave të reja, është edhe shkalla e njohjes së rregullave të licencimit dhe përshtatshmërisë së tyre. Edhe ky faktor vlerësohet se ka një ndikim të caktuar për këtë çështje. Përgjigjet e dhëna për të dy pyetësit janë shumë të ndryshme nga njëra – tjetra.

Kështu, rreth gjysma e bizneseve deklarojnë se nuk njohin kërkesat, që ekzistojnë për çeljen e një banke (pyetja 5 – pyetësi I). Por, një numër relativisht i vogël i atyre, që i janë përgjigjur pyetësorit të dytë deklarojnë se nuk njihen rregullat e licencimit (pyetja 2 – pyetësi II).

Nëse do të studjohej shkalla e njohjes së rregullave të veçanta, nga grupi i bizneseve, që i njeh këto rregulla, do të vërehet se më pak njihet kërkesa për raportin financiar sekret dhe kërkesa për hartimin e rregulloreve të brendshme.

Tabela 8. Shkalla e njohjes së secilës kërkesë nga bizneset.

Kërkesa	Niveli i përgjigjeve (%)*
1. Kapitali minimal	89.4
2. Deklarimi i burimit të të ardhurave	85.5
3. Krijimi i ambjenteve të përshtatshme	70.1
4. Plani i biznesit	74.7
5. Administratorë të kualifikuar	84.6
6. Raporti financiar sekret	59.6
7. Hartimi i procedurave dhe i rregulloreve të brendshme	59.6

* Përqindjet janë llogaritur mbi numrin e bizneseve, që i njohin rregullat e licencimit.

Megjithatë, nga ai grup, që ka njohuri për këto rregulla, pjesa më e madhe i vlerësojnë rregullat e licencimit të përshtatshme (pyetja 6 – pyetësi I dhe pyetja 3 – pyetësi II). Në këtë mënyrë faktori “rregulla” nuk konsiderohet si pengesë për aktivitetin bankar privat shqiptar, por duhet që këto rregulla të bëhen më të njohura. Sidomos ai grup kërkesash, që sot njihet më pak dhe që sugjeron se biznesi më tepër interesohet për ato çështje (kërkesa) që i shkaktojnë kosto në periudhë afatshkurtër, pa menduar për një periudhë më afatgjatë, gjë që krijon dhe një ide mbi cilësinë e administrimit që ky biznes do t'i bënte bankave të veta, nëse do të çelehin të tilla.

Më sipër theksuam që një pjesë e konsiderueshme biznesesh deklarojnë se nuk kanë kapital të mjaftueshëm. Kërkesa për kapital vlerësohet se njihet nga një nivel i kënaqshëm biznesesh, të cilat në shumicën e tyre e gjykojnë të përshtatshme si kërkesë. Në këtë mënyrë, nga njëra anë biznesi deklaron se ka kapital të pamjaftueshëm dhe nga ana tjetër ai prononcohet për moszbutje të kësaj kërkesë (kombinimi IV).

Kështu, rreth gjysma e bizneseve pohojnë nevojën për më shumë informacion rreth kërkesave të nevojshme për çeljen e një banke (pyetja 7 – pyetësi I). Njohja e kërkesave të veçanta luhetet në intervalin 31.4 për qind (raporti financiar sekret) deri në 47.1 për qind (kërkesa për kapital). Ky nivel njohjeje nga Banka e Shqipërisë konsiderohet i ulët (kombinimi IV). Prandaj, shihet me dobi të studjohet më tej interesi që ka biznesi për të marrë më shumë njohuri rreth kërkesave të veçanta për çelje banke. Në dhënien e këtij informacioni janë prononcuar nga 31.9 për qind (kërkesa për raportin financiar sekret dhe kërkesa për hartim rregulloresh e procedurash) në 48.2 për qind (kërkesa për kapital).

Përsëri, Banka e Shqipërisë e konsideron të ulët nivelin e prononcimit. Duket që ai grup biznesesh, që njih kërkesat, është shprehur edhe për nevojën për më tepër apo më pak informacion. Gjithashtu, nëse përgjithësisht mbi 60 për qind janë përgjigjur se dëshirojnë më tepër informacion për kërkesat për licencim, grupi i bizneseve, që nuk njih asnjë kërkesë prononcohet në masën mbi 60 për qind se nuk e shoh të nevojshme marrjen e më shumë informacioni për këtë qëllim. Nga kjo shpërndarje përgjigjesh gjykohet se ka një grup të konsiderueshëm biznesi tërësisht të paiterësuar për investim në banka dhe që nuk ka të ngjarë të shfaqë interes për periudhë afatshkurtër. Nga ana tjetër, sugjerohet që ka patur mungesë serioziteti në plotësimin e pyetësorëve dhe përgjigjet janë dhënë të shkëputura pa ndjekur linjën logjike të pyetjeve (kombinimi V).

Pra, interesi i shfaqur për të çelur bankë është i lidhur pozitivisht me shkallën e njohjes së kërkesave për çelje banke dhe me interesin për të marrë më shumë informacion për to. Në të dyja rastet lidhjet janë të forta. Me fjalë të tjera, sa më i madh të jetë interesi për të çelur një bankë, aq më shumë do të rritet shkalla e njohjes së kërkesave dhe interesi për të marrë informacion për to.

Tabela 9. Koeficientët e korrelacionit (të asocimit).

Korrelacioni	Vlera e koeficientit
1. Interesi për të çelur bankë me shkallën e njohjes së kërkesave	0.80
2. Interesi për të çelur bankë me interesin për të marrë më shumë informacion për kërkesat	0.85

Kjo sugjeron që, megjithëse është bërë një punë e mirë për rritjen e shkallës së njohjes së këtyre kërkesave, përsëri Banka e Shqipërisë duhet të angazhohet në një fushatë më intensive shpjeguese tek bizneset. Kjo është akoma më e vlefshme nëse Banka e Shqipërisë do të kërkojë të nxisë zgjerimin e sistemit bankar, që vepron në Shqipëri. Pra, një rrugë e vlefshme për të nxitur interesin për çelje bankash private rezulton të jetë edukimi i biznesit me kërkesat përkatëse.

Tabela 10. Rastet e përgjigjeve.

Kërkesa	Njohin kërkesën	Duan ose jo më shumë informacion	
		Prononcimet	Duan informacion
1. Kapitali	93	92	64
2. Burimi i të ardhurave	89	88	58
3. Ambjentet e punës	73	72	48
4. Planbiznesi	77	76	50
5. Administratorë të kualifikuar	88	87	58
6. Raporti financiar sekret	62	61	38
7. Hartim rregulloresh e procedurash	62	61	39
8. Nuk njihet asnjë kërkesë	87	84	32

Në tërësi, konkludohet që bankat private shqiptare mungojnë më tepër si pasojë e mangësive të vetë biznesit shqiptar se sa nën ndikimin e faktorëve të ambientit si situata makroekonomike, stabiliteti dhe rendi, kuadri rregullativ etj.. Biznesi shqiptar nuk paraqitet i fuqishëm nga ana financiare për të qenë në gjendje të investojë për çelje bankash. Ai nuk ka as aftësitë e nevojshme për të administruar një aktivitet të tillë, është ende i prirur nga fitimi i shpejtë afatshkurtër dhe ende ka njohuri të pakta mbi mënyrën e ndërtimit të këtij biznesi. Për këtë arsye dhe interesi i shfaqur për këtë lloj biznesi është i ulët dhe gjasat janë të mbetet i tillë dhe për vitet e ardhshme.

Në këto kushte mund të propozohet që Banka e Shqipërisë të rrisë përpjekjet e saj për të shtuar shkallën e njohjes së institucionit të bankës qendrore, funksionit të saj si licencuese bankash, madje edhe vetë emrit të saj. Banka e Shqipërisë, po ashtu, ka nevojë të angazhohet në fushatë më intensive për të rritur shkallën e njohjes së kërkesave, që ajo ka për licencimin e bankave.

Është pozitiv fakti që Banka e Shqipërisë synon të zgjerojë aktivitetin bankar me banka të reja. Duket se tregu e pranon një gjë të tillë. Por, ky synim nuk duhet arritur në këmbim të zbutjes së kërkesave për licencim apo të uljes së cilësisë së përzgjedhjes së bankave të reja. Kështu, mungesa e kapitalit për bizneset, e identifikuar si faktori kryesor për mungesën e bankave private shqiptare, nuk duhet të çojë në reduktim të shumës së kapitalit të kërkuar. Së pari, Banka e Shqipërisë ka një angazhim politik për këtë kërkesë, që është përafrimi me standardin ndërkombëtar dhe trajtimi i barabartë i subjekteve rezidente dhe jorezidente. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, lehtësimi i kërkesës për kapital do të konvertohet në hyrje bankash më pak të shëndetshme duke rënduar problemet e sistemit bankar shqiptar¹⁵. Pra, aktualisht, megjithëse biznesi shqiptar mund të jetë i suksesshëm në aktivitetin tregtar, në shërbime, në ndërtim apo të tjera fusha, nuk premtion sukses në fushën bankare. Edhe mosha e tij është relativisht e ulët ("e re") dhe kështu biznesi shqiptar nuk premtion banka cilësore sepse nuk e njeh biznesin bankar dhe nuk ka as specialistët përkatës.

Në këtë kuadër, biznesit shqiptar mund t'i propozohet që të ndryshojë formën e zhvillimit të aktivitetit. Është e nevojshme që bizneset të rrisin bashkëpunimin midis tyre duke bashkuar kapitalet, ose të kalojnë në shoqëri aksionere me ofertë publike. Kjo do të sjellë më tepër kapital dhe do t'i bëjë ato më të përshtatshëm për t'u angazhuar në aktivitetin bankar.

Një mundësi e mirë që paraqitet për biznesin shqiptar është pjesëmarrja në kapitalin e Bankës së Kursimeve, e cila pritet të privatizohet.

¹⁵ Në tërësi, Banka e Shqipërisë ka adoptuar një qëndrim jokonservator në lidhje me licencimin e bankave të reja. Kështu, nga viti 1992, në Bankën e Shqipërisë janë paraqitur 13 kërkesa të plotësuara për të marrë licencë. Nga këto, janë miratuar 11 ose rreth 85 për qind e tyre.

Megjithatë, edhe ky fenomen ka pak gjasa të ndodhë. Edhe në këtë drejtim biznesi shqiptar nuk paraqitet i interesuar. Shumë pak nga bizneset dhe zyrat e këmbimit valutor janë deklaruar të gatshme të investojnë në sistemin bankar ekzistues (pyetja 8 – pyetësi I).

Nga ana tjetër, ndarja pothuajse e barabartë e gjykimit (pyetja 9 – pyetësi I) rreth arsyeve të mungesës së gatishmërisë, e vështirëson komentimin, përveç faktit se numri i atyre, që pohojnë se nuk i njohin procedurat, mbetet relativisht i madh. Del e qartë, pra, se bizneset nuk janë të gatshme të angazhohen në këtë fushë të aktivitetit ekonomik.

Praktikisht, vërehet që veprojnë të gjitha arsyet e mundshme për të mos investuar në aksione të bankave shtetërore. Një rezultat i tillë duhet të kihet parasysh nga autoritetet përkatëse gjatë procesit të privatizimit pasi kjo mungesë interesi mund të bëjë të pasuksesshme shitjen e aksioneve me ofertë publike duke i hequr dhe një mundësi (ndër të paktat që paraqiten) tregut të kapitaleve për frymëmarrje; pronari aktual duhet të përgatitet që një pjesë të aksioneve, që nuk do të shiten, t'i zotërojë përsëri vetë për një periudhë kohe më të gjatë se sa mund të jetë parashikuar; por kjo nënkupton që në privatizim i duhet kushtuar më tepër rëndësi procesit të prezantimit të përfitimeve të pjesëmarrjes në aksionet e bankës që privatizohet (kombinimi VI).

III.3 - Zgjerimi i aktivitetit bankar në të ardhmen

Më sipër u nënvizua që mendimi më i përhapur është se ka hapësira për zgjerim të aktivitetit bankar. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë përditë ndeshet me probleme të një niveli të ulët të ndërmjetësimit të sistemit bankar, dominim të tregut bankar, dominim të rrjetit bankar, mungesë produktesh të kësaj industrie etj..

Pikërisht, këto shqetësime të përditshme bënë që në të dy pyetësit të përfshihet një rubrikë apo një grup pyetjesh, që kërkojnë të marrin informacion mbi perspektivat e zgjerimit të aktivitetit bankar. Sidomos merr rëndësi kjo perspektivë trajtuar nga këndvështrimi i bankave. Pra, si e mendojnë ato vetë të ardhmen e tyre.

Së pari, të gjitha bankat e intervistuar kanë pohuar se mendojnë të zgjerojnë gamën e aktiviteteve të veta (pyetja 24 – pyetësi II). Në këtë mënyrë vlerësohet që sistemi bankar ekzistues (ose të paktën 50 për qind e tij) ka mundësi për zgjerim aktiviteti. Për më tej, planet e tyre paraqiten ambicioze (pyetja 25 – pyetësi III) dhe më tepër synojnë të zgjerohen në ato fusha të aktivitetit bankar ku aktualisht ka probleme siç janë kreditimi; thithja e depozitave dhe ofrimi i shërbimeve të tjera për klientët. Realizimi i planeve të tilla, dukshëm çon në rritje të ndërmjetësimit financiar. Madje, vetë bizneset e shohin si të domosdoshme (pyetja 23 – pyetësi I) shtimin e shërbimeve nga bankat dhe prezantimin e

instrumenteve të reja. Pra, planet e bankave për të rritur ofertën e produkteve do të ballafaqohen me një kërkesë të kënaqshme për përfitim të tyre.

Kërkesat më të larta për karta krediti dhe letër kredie tregojnë se firmat e ndjejnë nevojën e shërbimeve të reja sidomos në aktivitete, që lidhen me veprime me jashtë. Këto, në fakt, imponojnë edhe kërkesën e rritur për shërbime të reja. Nga ana tjetër, kjo vërteton stadin embrional të marrëdhënieve të pagesave dhe të shërbimeve dhe faktin që shërbimet e reja nuk janë bërë akoma eficiente në marrëdhëniet ekonomike, midis tyre dhe me bankat, brenda vendit (pyetja 24 – pyetësi I).

Përveç zgjerimit në aktivitete bankare, i rëndësishëm është zgjerimi i rrjetit dhe diversifikimi i hartës gjeografike të sistemit bankar. Në kushtet e Shqipërisë kjo është mjaft e rëndësishme pasi kemi një përqendrim të lartë të rrjetit bankar në Tiranë dhe pothuaj monopol të rrjetit bankar në 10 qytetet më të mëdha të vendit dhe monopol në pjesën tjetër të tij. Kështu në pyetjen 60¹⁶ të pyetësit të parë, vërehet që rreth 1/5 e bizneseve të përgjigjura gjykojnë se shërbimi në rrethe nga bankat është i dobët. Këtij shqetësimi i jep përgjigje pyetja 27 e pyetësit II ku bankat konfirmojnë se kanë plane të zgjerojnë rrjetin bankar. Madje identifikohen dhe rajonet, që janë në planet më të afërta (pyetja 28 – pyetësi II) të bankave. Bazuar në parimin që “banka shkon ku të jetë biznesi” kuptohet që zonat ku edhe ka aktivitet ekonomik më intensiv pritet të jenë “të zgjedhura” për çelje degësh. Nga ana tjetër, synohen qytetet e mëdha e të sigurta. Për këto arsye, si më të mundshme janë konsideruar qytetet e Durrësit dhe të Korçës por edhe Shkodrës, Fierit e Vlorës.

Ky fakt është akoma më inkurajues pasi gjysma e të intervistuarve për pyetësin e dytë mendojnë se në rrethet e Shqipërisë do të krijohet një mungesë shërbimesh bankare si pasojë e privatizimit të bankave shtetërore (pyetja 19 – pyetësi II). Kjo mbi të gjitha arsyetohet me faktin që bankat private ende nuk janë të gatshme për t’u shtrirë përtej Tiranës.

Zgjerimi i gjeografisë së rrjetit bankar nuk është konceptuar vetëm si çelje degësh të reja në qytete të tjera të Shqipërisë. Për t’u shërbyer sa më mirë klientëve ka rëndësi dhe çelja e një numri të mjaftueshëm sportesh, brenda një qyteti, si dhe vendndodhja e tyre. Edhe në këtë çështje, bizneset gjykojnë se është e nevojshme të çelen më tepër sportele nga bankat ekzistuese (pyetja 62 – pyetësi I) dhe po ashtu edhe shtrirja gjeografike ekzistuese e sporteve konsiderohet e papërshtatshme (pyetja 63 – pyetësi I). Kjo do të thotë që vetë bankat ekzistuese mund të përmirësojnë cilësinë e shërbimit për klientët edhe në këtë drejtim. Kjo do të ndikonte në zgjerimin e klientelës për sistemin bankar.

¹⁶ Kësaj pyetjeje nuk i janë përgjigjur rreth 54.5 për qind e të intervistuarve. Kjo ndoshta pasqyron faktin që bizneset janë të përqendruara në Tiranë dhe nuk mund të japin gjykim mbi cilësinë e shërbimit të bankave në rrethe. Megjithatë, fakti që 1/5 e atyre, që janë përgjigjur gjykojnë se shërbehet dobët, konsiderohet nivel i lartë.

Dhe së fundi, pohohet (pyetja 30 – pyetësi II) se janë bankat universale ato, që sigurojnë më tepër sukses në Shqipëri. Argumentet në favor të këtij fakti konfirmojnë strategjinë e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, licencimi i bankave universale.

Konkludohet që në Shqipëri sistemi bankar shqiptar ende nuk ka arritur ngopjen dhe kërkesa për shërbime bankare do të ekzistojë në nivel të konsiderueshëm. Për këtë arsye, shihet si strategji e mirë lejimi i zgjerimit të veprimtarisë bankare në disa drejtime:

- licencimi i bankave të reja (sidomos bankave universale);
- nxitja e zgjerimit të aktivitetit të bankave ekzistuese sidomos në fusha të tilla, që janë konsideruar si problem siç janë kredia etj.;
- nxitja e zgjerimit të sistemit bankar nga pikëpamja gjeografike. Kjo del mëse e nevojshme aktualisht kur bankat shtetërore po privatizohen dhe pritet krijimi i një vakuumi shërbimesh bankare në disa zona;
- nxitja e zgjerimit të aktivitetit bankar me produkte e shërbime të reja.

Për bankat e nivelit të dytë propozohet që të adoptojnë strategji më agresive si në drejtim të produkteve, që ofrojnë ashtu edhe në drejtim të përzgjedhjes së gjeografisë, apo vendeve ku i ofrojnë këto produkte. Kjo do të kishte si rezultat afrimin më të madh të klientëve tek bankat dhe për pasojë përmirësimin e funksionimit të sistemit bankar.

Banka e Shqipërisë, nga ana e saj, e lehtëson procesin e shtrirjes gjeografike pasi ajo e ka lënë të lirshme çeljen e degëve apo të njësive të tjera bankare kudo në Shqipëri. Bankat nuk ballafaqohen me asnjë kërkesë shtesë në rast se duan të ndryshojnë rrjetet e tyre.

III.4 - Shkalla e realizimit të planeve të bankave

Identifikimi i nevojës për zgjerim të aktivitetit bankar kërkon dhe një ballafaqim me realizimin e planeve të disa viteve më parë të vetë bankave. Duke identifikuar arsyet për shkallën e vërtetuar të realizimit, njëkohësisht krijohet dhe një pamje më realiste mbi të ardhmen afatshkurtër (1-2 vjeçare) të sistemit bankar shqiptar.

Në tërësi, vërehet që planet e bankave nuk janë realizuar në nivel të kënaqshëm si për aktivitetin depozitues ashtu edhe për atë kreditues (pyetjet 4 dhe 6 – pyetësi II). Rreth 1/3 e bankave nuk kanë dhënë fare kredi. Shkalla e realizimit, madje, është më e ulët për aktivitetin kreditues se sa për atë të thithjes së depozitave. Kujtojmë që këto dy aktivitete janë bazë për një bankë dhe nëpërmjet tyre realizohet ndërmjetësimi financiar. Por, në nivel të mesëm (50-100 për qind) të realizimit të planit, përsëri gjenden gjysma e bankave për aktivitetin depozitues dhe 1/3 për atë kreditues. Mesatarisht niveli i realizimit të planeve për thithje depozitash është 93 për qind, ndërsa për kredinë ndjeshëm më e ulët, 42 për qind.

Arsyet, që kanë ndikuar janë disa (pyetjet 5 dhe 7 – pyetësi II). Nuk mund të identifikohet një e vetme, por në tërësi vërejmë:

- publiciteti i bankave është një arsye që nuk ka ndikuar as pozitivisht dhe as negativisht në realizimin e planit për të dyja aktivitetet;
- norma e interesit, që logjikisht duhet të jetë një faktor përcaktues meqenëse përfaqëson çmimin e marrjes dhe të dhënies hua të fondeve, vërehet që ka një ndikim të kufizuar në kah pozitiv. Për këtë shkak, një bankë e ka realizuar mbi 100 për qind si planin e depozitave ashtu edhe të kreditimit (jo domosdoshmërisht e njëjta bankë);
- cilësia e shërbimit, po kështu, ka një veprim më të dukshëm në planin e depozitimit. Ky proces ndikohet në mënyrë të zhdrejtë me cilësinë e shërbimit. Ndërsa aktiviteti kreditues nuk e ndjen këtë faktor. Kjo ndoshta për shkak të kërkesës më të madhe për kredi në raport me depozitat dhe të ofertës së ulët për kreditim;
- ka dhe një sërë arsyesh të tjera, që konfirmohen se kanë ndikuar, por që gjithashtu, nuk mund të identifikohet një kryesore midis tyre.

I rëndësishëm paraqitet dhe vlerësimi i realizimit të planeve për thithje të numrit të klientëve. Ky ndikon në diversifikimin e subjekteve, që ofrojnë burime për bankën (klientela depozituese) dhe subjekteve, që përdorin ofertën e bankave (klientela huamarrëse). Edhe këtu vërehet diferencë midis aktivitetit depozitues e atij kreditues (pyetjet 8 dhe 9 – pyetësi II). Nëse për tërheqjen e depozituesve mbi gjysma e bankave konfirmojnë se janë realizuar parashikimet, për huamarrësit gjysma e bankave pohon se nuk i ka realizuar parashikimet. Megjithatë, në përgjigje vërehet që edhe kur plani për depozita e kredi është realizuar në masën 50-100 për qind, përsëri bankat kanë deklaruar se kanë realizuar parashikimin për numrin e depozituesve (dy banka) dhe atë të huamarrësve (një bankë). Kjo, në njëfarë mase, orienton që edhe vetë bankat nuk kanë qenë tepër ambicioze në zgjerimin e aktivitetit.

Si rregull i përgjithshëm, aktiviteti i bankës ndikohet mjaft nga publiciteti, që ajo bën. Ky faktor vlerësohet si i rëndësishëm në Shqipëri në kushtet kur tradita është që popullsia dhe biznesi të mos ketë marrëdhënie të ngushta me bankat. Për më tepër, publiciteti nuk u paraqit si faktor ndikues në realizimin e planeve për kredi e depozita. Ky fakt konfirmohet më tej ku vetëm $\frac{1}{4}$ e të intervistuarve pranon se publiciteti është i mjaftueshëm (pyetja 12 – pyetësi II). Ajo që paraqitet më shqetësuese është komentimi i pamjaftueshmërisë së publicitetit. Bankat shprehen se nuk justifikohet kostoja dhe individët se konsiderohet si një angari. Kështu, vlerësohet që publiciteti i bërë nga bankat është në nivel të ulët dhe pasojë e një strategjie joagresive, që kanë zgjedhur bankat për zgjerim aktiviteti.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme të vërehet si e gjykon biznesi këtë çështje, pra si e vlerëson nivelin e marketingut dhe të reklamës së bankave (pyetja 25 – pyetësi I). Ndër të përgjigjurit vërehet që një pjesë e konsiderueshme e vlerësojnë të pamjaftueshëm nivelin e reklamës dhe sidomos në bankat

shtetërore. Megjithatë, numri i rasteve të të papërgjigjurve për bankat private, 69 raste apo 36.1 për qind e të intervistuarve, është i madh. Kjo gjë e bën gjykimin të vështirë. Ky fakt mund të jetë një sinjal që reklama bankare për bankat private njihet pak nga bizneset.

Konkretisht, biznesi shprehet se botimi i bilancit të bankave do të rriste besimin në to (pyetja 29 – pyetësi I). Pra, biznesi pranon parimin e të qënurit transparent si një mjet, që do të ndikojë në rritjen e besimit.

Në tërësi, konkludohet që bankat në Shqipëri nuk kanë arritur një realizim të kënaqshëm të planeve të tyre. Më e lartë shkalla e mosrealizimit është në fushën e kreditimit. Për më tepër, bankat vetë nuk kanë adoptuar strategji agresive në treg. Kjo shpjegon dhe faktin që nuk gjendet një arsye e vetme që të shpjegojë shkallën e realizimit të planeve të bankave, por jepen një mori arsyes. Gjithashtu, bankat kanë qëndruar larg publicitetit, i cili, për tranditën që ekziston në Shqipëri gjykohet si tepër i domosdoshëm që të rritet ndërmjetësimi bankar. Kjo hedh dhe një hije dyshimi mbi planet ambicioze që këto banka kanë shfaqur për të ardhmen e afërt. Pra, në rradhë të parë do të ishte mirë të ndryshojë strategjia e secilës bankë. Dhe biznesi e kërkon një gjë të tillë. Si hap i parë bankat duhet të botojnë rregullisht bilancet e tyre. Banka e Shqipërisë, nga ana tjetër, është e nevojshme të kërkojë zbatim më rigoroz të detyrimeve ligjore për botim bilancesh dhe situatës financiare nga ana e bankave. Nëse këtë gjë e kërkojmë me ngulm nga bizneset, po me të njëjtën forcë duhet kërkuar edhe për bankat.

III.5 – Aktiviteti kreditues

Për të gjykuar në tërësi për aktivitetin e kreditimit dhe nivelin e përdorimit të tij janë paraqitur një grup pyetjesh.

Së pari, kërkohet nga biznesi të dihet mënyra se si ai e financon aktivitetin e vet (pyetja 10 – pyetësi I). Duke bërë pyetje kërkohet të gjendet se sa peshë ka financimi me kredi bankare.

Në përgjithësi, biznesi financohet me burime të veta (fitimin e vet) ose siç quhet ndryshe, përdor financim të brendshëm. Kjo strukturë financimi orienton që investimet janë të kufizuara. Kjo është edhe një arsye shtesë se përse biznesi i madh është i përqendruar në aktivitete me qarkullim të shpejtë të kapitalit. Pra, një alternativë e rëndësishme financimi është edhe parapagimi i porosisë. Nga rezultatet, gjithashtu, duket se firmat përdorin edhe forma të ndryshme financimi në të njëjtën kohë. Ndërsa kredia bankare vlerësohet se përdoret në nivel mjaft të ulët. Vetëm 10.5 për qind e bizneseve deklaroi se ka përdorur këtë burim financimi. Kjo shpjegon më së miri faktin që bankat nuk kanë realizuar planet e tyre për kreditim. Ndërsa, financimi nga firma të tjera (përveç marrëdhënies që krijohen si furnitor-klient), nga individët dhe në forma të tjera përfshin 14.7 për

qind të bizneseve. Duke konsideruar financimin e brendshëm, atë nga bankat dhe atë me parapagim porosie si kanalet formale të financimit, gjykohet se financimi në tregun joformal është pothuaj i barabartë me financimin e ofruar nga bankat për bizneset e mëdha dhe zyrat e këmbimit valutor. Nëse merren parasysh bizneset e vogla e të mesme, niveli i financimit në tregun formal rritet pasi për to është më e vështirë të përfitojnë kredi nga bankat. Rritja nuk do të jetë domosdoshmërisht proporcionale sepse biznesi i vogël dhe i mesëm ka të ngjarë të përdorin në shkallë më të lartë financimin e brendshëm.

E rëndësishme është të dihet edhe niveli i bizneseve, që i janë drejtuar bankës për të marrë kredi. Nëse në tërësi financimi me kredi bankare është i ulët dhe është mjaft i përhapur opinionin se bankat nuk kreditojnë, a është përpjekur, nga ana e tij, biznesi të afrohet në banka (pyetja 11 – pyetësi I). Nga përgjigjet e dhëna rezulton se bizneset shumë pak u drejtohen bankave për të kërkuar kredi (më pak se 20 për qind e tyre në secilin grup bankash). Kjo, mendohet se është shprehje edhe e mungesës së traditave dhe kulturës në këto marrëdhënie.

Nga ana tjetër, në kundërshtim me opinionin e përsëritur të vështirësive për të marrë kredi, fakti se rreth gjysma e atyre, që kanë kërkuar kredi, në bankat shtetërore apo private, e kanë përfituar atë, tregon se ky proces mund të realizohet me sukses në rast se plotësohen kërkesat e bankave dhe në rast se paraqiten më shumë kërkesa në banka (pyetja 12 – pyetësi I). Madje vërehet që numri i përfituesve të kredisë në raport me kërkuarit është më i lartë në bankat shtetërore se sa në ato private (kombinimet VII dhe VIII).

Gjithësesi, numri i atyre, që i konsiderojnë procedurat e kredisë normale është shumë i ulët (pyetja 13 – pyetësi I). Në bankat private këto procedura vlerësohen të jenë më të thjeshta.

Nga ana tjetër, kushtet e kredidhënies në bankat shtetërore janë konsideruar (pyetja 14 – pyetësi I), në përgjithësi, të pafavorshme, ndërkohë që rezulton e vështirë të vlerësosh këtë fakt për bankat private sepse mendimi ndahet pothuaj në mënyrë të barabartë. Megjithatë, kjo konfirmon deri diku që është e drejtë që Banka e Shqipërisë të këmbëngulë në reduktimin e normave të interesit.

Në tërësi, konkludohet që niveli i kreditimit të biznesit është i ulët. Bizneset e përdorin relativisht pak kredinë bankare duke u mbështetur më tepër në fitimin e vet dhe në kredinë tregtare. Kjo nënkupton mundësi më të pakta për zgjerim aktiviteti. Nga ana tjetër, niveli i ulët i financimit nga bankat shkaktohet nga disa arsye:

- * bankat kanë kushte jo shumë normale për kreditim dhe me kërkesa jo të favorshme. Kjo është e kuptueshme nisur nga fuqia financiare jo e konsoliduar e biznesit dhe nga fakti që në vend aplikohet vetëm kredia tregtare;
- * vetë bizneset u afrohen pak bankave. Nëse biznesi nuk ka marrëdhënie të vazhdueshme me bankat është e qartë që ai do të ketë dhe mundësi të vogël

përdorimi të shërbimeve, që ofrojnë bankat. Kjo është në harmoni me konkluzionin e arritur në pikën III.4 që bankat nuk kanë realizuar planet për kreditim dhe për afrim klientele kredituese.

III.5.1. Ndikimi i faktorëve të tjerë në aktivitetin kreditues

Në pikën III.4 u konkludua që planet për kreditim dhe klientelë huamarrëse janë realizuar në një masë më të ulët se sa depozitat me klientelën përkatëse. Nisur nga fakti që Banka e Shqipërisë ka aplikuar për vite me rradhë instrumentin e kufirit të kreditit dhe opinioni i përhapur se ky faktor ka penguar kreditimin e sektorit jopublik, u pa e nevojshme marrja e opinionit për këtë instrument (pyetja 10 – pyetësi II).

Mbi gjysma, katër banka, janë shprehur se kufiri i kreditit e ka penguar aktivitetin kreditues. Përballë një pohimi të tillë, Banka e Shqipërisë ka interes të detajohet më tej në arsyetimin e tij. Arsyet e dhëna, faktikisht, nuk janë vërtetuar në praktikë:

- largon klientelën. Më sipër u përshkrua se vetë bankat nuk kanë treguar agresivitet;
- nuk bazohet në potencialin kreditues të bankës. Shpërndarja e kufirit është bërë bazuar pikërisht në peshën e bankës në tregun bankar, sidomos në tregun e kredive, cilësinë e kredive, pozicionin e kapitalit etj.;
- është kufi i ulët. Në përgjithësi, është vërejtur që kufiri i vendosur nuk është realizuar dukshëm si në total, ashtu edhe nga banka të veçanta, sidomos në dy-tre vitet e fundit.

Pra, gjykohet se më tepër spekulohet me faktin që kufiri i kreditit i pengon bankat të japin kredi. Kështu, nga katër banka, që deklarojnë se kufiri është pengesë, dy prej tyre nuk kanë dhënë fare kredi dhe dy të tjerat kanë realizim të planit të kreditimit në masën deri në 50 për qind. Ndëkohë, dy bankat që shprehen se kufiri ndihmon procesin kreditues, e kanë realizuar planin në masën 50-100 për qind dhe mbi 100 për qind.

Nga ana tjetër, për gati dy vjet, po diskutohet krijimi i një zyre të regjistrimit të kredive (pyetja 11 – pyetësi II) për të cilën ka interes të dihet se si e vlerësojnë vetë bankat, që do të jenë dhe përdoruesit kryesorë të këtij informacioni. Pa ekuivok, bankat pranojnë rëndësinë dhe dobishmërinë e një zyre të tillë. Pra, ishte një veprim i mirë i Bankës së Shqipërisë, që nxiti dhe këmbënguli këtë proces. Vënia në funksionim e zyrës do të ndihmojë mjaft dhe në rritjen e cilësisë së huadhënies.

III.6 – Aktiviteti depozitues

Për të gjykuar në tërësi për aktivitetin e depozitimit janë paraqitur një grup pyetjesh.

Pothuajse të gjitha bizneset punojnë me llogari bankare të çelur në emër të shoqërisë (pyetjet 15 dhe 16 – pyetësi I) por ato preferojnë më shumë të kenë llogari në bankat shtetërore. Numri i atyre, që frekuentojnë bankat private nuk është i vogël, gjithashtu. Duket qartë se ka përdorim të gjerë llogarish në të dyja grupet e bankave. Numri më i madh i bizneseve, që kanë llogari në bankat shtetërore tregon për një ambientim dhe siguri më të lartë në këto banka (shih pikën III. 12.4).

Nga llogaritë e çelura në banka, dominojnë (pyetja 18 – pyetësi I) llogaritë rrjedhëse në lekë. Kjo është e vërtetë si për bankat shtetërore ashtu edhe ato private. Natyra e biznesit shqiptar e ka të nevojshme që të mbajë sasi të konsiderueshme në llogari rrjedhëse. Megjithatë, këtu dalin disa konkluzione. Së pari, bizneset kanë mundësi të administrojnë më mirë paratë e tyre duke i maksimizuar të ardhurat nga depozitat nëpërmjet shkallëzimit të përdorimit të të gjitha formave të tyre. Së dyti, bankat mund të prezantojnë aktivitete të reja, produkte të tjera alternative dhe me afate të ndryshme e më të shkurtra maturimi. Së treti, kjo dukuri duket se implikon probleme të tjera për kanalin e transmissioinit të politikës monetare nëpërmjet normave minimale të interesit. Në këtë mënyrë, ky instrument rezulton joeficient.

Nga përgjigjet e dhëna vërehet që bizneset kanë llogari në më shumë se një bankë (të paktën 71 biznese ose 40 për qind e të intervistuarve). Por, nuk mund të konkludohet që kjo është për arsye të një administrimi më të mirë fondesh sepse në të dyja grupet e bankave mbi 98 për qind janë llogari rrjedhëse dhe mbi 93 për qind e llogarive rrjedhëse janë në lekë (kombinimi X). Ndoshta kjo bëhet për të lehtësuar punën me bankat. Kështu, mbajtja e një llogarie në një nga bankat shtetërore deri diku është e detyrueshme si pasojë e rritit të gjerë të degëve, që zotërojnë këto banka. Po kështu, për të lehtësuar marrëdhëniet me klientët dhe furnitorët (llogaritë e të cilëve mund të jenë në banka të ndryshme) i detyron bizneset që të kenë disa llogari. Ndoshta, kufizimi që ekziston për tërheqjet ditore në *cash* dhe nevojat e mëdha të bizneseve bëjnë që ato të shpërndajnë fondet e tyre në disa banka. Nga ana tjetër, edhe administrimi i fondeve nga bizneset duket që nuk bëhet në mënyrë profesionale si pasojë e mungesës së ekonomistëve-financierë në biznese ashtu edhe moszhvillimit, nga ana e bankave, të funksionit të këshillimit të klientëve të tyre.

Gjithashtu, 1/3 e bizneseve kanë pohuar se preferojnë ta transferojnë llogarinë e tyre jashtë vendit (pyetja 17 – pyetësi I). Kjo do të thotë që bankat e nivelit të dytë mund të ballafaqohen me një largim të klientëve dhe burimeve në kushtet e

liberalizimit të llogarisë kapitale, nëse nuk përmirësojnë punën e tyre në marrëdhëniet me klientët. Numri i atyre, që do ta transferonin llogarinë jashtë konsiderohet relativisht i lartë. Në kushtet kur tendenca është liberalizimi i llogarisë kapitale, bankat duhet të përmirësojnë strategjinë e tyre për afrimin e klientëve. Nga ana tjetër, ky tregues sugjeron edhe për Bankën e Shqipërisë, si autoriteti që përcakton politikën në lidhje me llogarinë kapitale, se ky liberalizim duket se duhet të bëhet gradualisht e në mënyrë të matur.

Me interes është të shihet më në detaje ky fenomen. Për të parë ekspozimin ndaj një rreziku të mundshëm të largimit të llogarive jashtë janë bërë disa kombinime rezultatet e të cilave tregojnë:

- * më të ekspozuara ndaj largimit të llogarive (ndryshe nga ç'mendohej) janë bankat private. Përqindja e bizneseve, që kanë llogari në bankat private dhe do ta transferonin llogarinë jashtë është rreth 8.9 pikë më e lartë se sa në bankat shtetërore. Duke qenë se shërbimi në bankat private ofrohet me një cilësi më të mirë (kjo është pohuar nga vetë bizneset) duket se bizneset, që kanë zgjedhur çeljen e llogarive në një bankë private (që përgjithësisht janë të huaja) në fakt kanë realizuar një si “gjysmë-transferim” të llogarisë jashtë (kombinimi IX);
- * transferimi i llogarisë jashtë, përsëri ndryshe nga sa pritej, nuk ka lidhje me origjinën e kapitalit (kombinimi XI);
- * transferimi i llogarisë jashtë paraqet lidhje më të fortë me llojin e aktivitetit ku janë angazhuar bizneset (kombinimi XII). Për shembull, nga bizneset që merren me prodhim vetëm 1/5 do të transferonte llogarinë jashtë (niveli më i ulët), por gjysma e bizneseve të angazhuara në sferën e shërbimeve do ta transferonin llogarinë jashtë (niveli më i lartë).

III.6.1. Ndikimi i faktorëve të tjerë në aktivitetin depozitues

Aktiviteti i thithjes së depozitave ndikohet dhe nga ekzistenca e një skeme për garantimin e tyre. Rreth 85 për qind e të intervistuarve e konfirmojnë këtë fakt (pyetja 21 – pyetësi II). Ky element ka rëndësi për rritjen e besimit të depozituesve në banka dhe për rrjedhojë dhe në sistemin bankar duke rritur qëndrueshmërinë e tij; eliminon shformimet në treg sepse heq garancinë e nënkuptuar nga shteti dhe në fakt vendos subjektet mbi baza më të drejta konkurrence dhe për më tepër bëhet i nevojshëm në kushtet e kalimit në sistem bankar tërësisht privat.

Kjo konfirmon dobishmërinë e përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për hartimin e kuadrit përkatës ligjor për të institucionalizuar një skemë të tillë. Është i nevojshëm një angazhim për realizimin e kësaj skeme dhe paraqitjen e saj në një moment të tillë kohor, që të mos krijojë shformime shtesë në treg. Në këtë pikëpamje, janë të vlefshme pohimet se skema duhet të prezantohet pasi të rikapitalizohen bankat shtetërore. Aplikimi i skemës, mbi të gjitha, do të shtonte një element në rritjen e konkurrencës së bankave.

III.7 – Shërbimi i pagesave

Për të gjykuar, në tërësi, për shërbimin e pagesave janë paraqitur një grup pyetjesh.

Bizneset rezultojnë se kryejnë pagesa në një masë të madhe nëpërmjet bankave (pyetja 19 – pyetësi I) dhe për pagesat me jashtë preferohen më shumë bankat private. Kjo mund të lidhet edhe me faktin që bankat private në shumicën e tyre janë me kapital të huaj duke supozuar lidhje më të drejtpërdrejta me bankat e huaja. Gjithashtu, kjo tregon për ekzistencën e elementeve të besimit sidomos ato që lidhen me konfidencialitetin e informacionit bankar.

Megjithatë, format e pagesave të ndryshme nga *cash*-i përdoren relativisht pak (pyetja 20 – pyetësi I). Përgjigjet e bizneseve tregojnë se një masë e vogël e tyre përdorin karta krediti. Sidoqoftë, kur edhe lëvrimi i tyre është shumë i kufizuar në Shqipëri, kjo tregon se ende mungon infrastruktura e përshtatshme për të kaluar në këtë lloj veprimi. Megjithatë, kërkesa për këtë shërbim duket se është e lartë, por përdorimi konkret nuk vërtetohet.

Një tjetër shërbim bankar, që ndikon mjaft në afrimin e biznesit me bankat, është edhe cilësia e shërbimit të pagesave me jashtë (pyetja 21 – pyetësi I). Përderisa, për këtë lloj shërbimi, ekzistojnë rregulla të vendosura nga Banka e Shqipërisë është e rëndësishme të dihet se si vlerësohen rregulla të tilla. Por, rezulton shumë e lartë masa e bizneseve, që nuk i njohin këto rregulla. Kjo do të thotë punë e pakët nga bankat, shërbim i kufizuar dhe sistem pagesash primitiv.

Nga ana tjetër (pyetja 22 – pyetësi I), duke marrë në konsideratë që për bankat shtetërore 13.5 për qind e bizneseve nuk janë përgjigjur dhe për bankat private 39.9 për qind e tyre nuk janë përgjigjur, rezulton se komisioni, i vendosur nga bankat për pagesat, duhet konsideruar relativisht i pranueshëm.

Lidhur me llojet e pagesave me mjete të ndryshme nga *cash*-i vërehet që forma më e përhapur është pagesa me çek, si në bankat shtetërore ashtu edhe në ato private. Kjo formë pagese mbizotëron në pagesat me brenda. Këto të fundit më shpesh kryhen nëpërmjet bankave shtetërore pasi ato janë të shtrira gjerësisht në territorin e vendit (kombinimi XIII) Megjithatë, biznesi e ndjen të nevojshëm prezantimin e produkteve e shërbimeve të reja nga ana e bankave. Si më i nevojshëm identifikohet prezantimi i kartave të kreditit. Ndërsa, gjykohet se është ende në nivel të ulët kërkesa për shërbimet e konsulencës (kombinimi XIV).

III.8 – Aktiviteti bankar dhe rregullat e Bankës së Shqipërisë

Aktiviteti i bankave ndikohet dhe prej vendimeve të rregullatorit dhe kuadrit të rregullave, që ai miraton. Për këtë arsye, u mendua marrja e opinionit për rregulloret e Bankës së Shqipërisë (pyetja 20 – pyetësi II). Këtë opinion Banka e Shqipërisë duhet ta ballafaqojë me veprimet e saj të ardhshme. Për fat të keq jepet një opinion mjaft i shpërndarë. Megjithëse numri më i madh i të intervistuarve (35 për qind) kanë pohuar se rregulloret janë të përshtatshme, 25 për qind i konsiderojnë jo të plota, 20 për qind jo të lehta për t'u zbatuar e kuptuar dhe po aq nuk janë përgjigjur. Kjo jep disa konkluzione:

- mosdhënia e përgjigjeve më tepër nënkupton mosnjohje të tyre. Banka e Shqipërisë duhet të marrë në konsideratë rritjen e shkallës së publicitetit për rregullat që ajo miraton;
- fakti që rregullat konsiderohen jo të lehta për t'u kuptuar dhe zbatuar gjithashtu, e angazhon Bankën e Shqipërisë jo thjesht me rritjen e cilësisë së përgatitjes së rregullave, por më tepër me rritjen e shkallës së transparencës në përgatitjen e tyre dhe rritjen e shkallës së bashkëpunimit për zbatimin e tyre. Procesi i hartimit të rregullave duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me diskutime me bankat dhe institucione të tjera. Procesi i zbatimit duhet të shoqërohet me interpretim të rregulloreve. Me këtë ide, Banka e Shqipërisë ka institucionalizuar marrjen e mendimeve të bankave të nivelit të dytë për rregullat që përgatiten, por edhe të institucioneve të tjera sipas rastit. Kapërcimi i kësaj pengese kërkon angazhim edhe të palës (palëve) të tjera;
- fakti që rregullat konsiderohen si jo të plota, përsëri e angazhon Bankën e Shqipërisë me plotësim të këtij kuadri. Kjo është e nevojshme edhe në vijim të interesit të shprehur për asocim në BE, proces, i cili kërkon përafrim të legjislacionit dhe të rregullave me standardet e BE-së.

III.9 - Konkurrenca

Një tjetër element shqetësues për Bankën e Shqipërisë është mungesa e konkurrencës në sistemin bankar. Kjo pengon kryerjen me efikasitet të funksionit si autoritet monetar dhe si rregullator.

Përgjigjet e dhëna nga bankat dhe individët paraqesin një opinion të ndarë pothuaj në mënyrë të barabartë (pyetja 13 – pyetësi II). Megjithatë, fakti që 40 për qind e të intervistuarve pohojnë se nuk ka mundësi të barabarta konkurrence gjykohet i lartë. Dhe në realitet, tregu bankar është i deformuar.

Ky deformim apo situatë monopol ekziston në aktivitetin e depozitave dhe sidomos të depozitave në lekë. Kjo pohohet në masë të konsiderueshme si nga bankat dhe nga individët. Kjo tregon që në praktikë reduktohen mundësitë që

instrumenti i normës së interesit, i përdorur nga Banka e Shqipërisë të përdoret në mënyrë efikase. Ndërsa pohimet e tjera, praktikisht tregojnë që monopoli ose dominimi ekziston në pothuaj gjithë aktivitetet bankare, por në mënyrë më të spikatur në tregun e bonove të thesarit dhe në shërbimin e pagesave (pyetja 14 – pyetësi II).

Detaje të mëtejshme kërkohen për monopolin në tregun primar të bonove të thesarit (pyetja 15 – pyetësi II). Kjo sepse ky është tregu i vetëm me letra me vlerë, që operon në vend. Konkurrenca në këtë treg konsiderohet e deformuar (40 për qind e të intervistuarve). Megjithatë, është e lartë shkalla e atyre, që nuk kanë njohuri mbi këtë fakt.

E rëndësishme është që ky treg të jetë sa më pak i deformuar. Veprimet korrektuese, që mund të ndërmerren, gjithashtu, propozohen nga të intervistuarit (pyetja 16 – pyetësi II). Si një veprim i dobishëm konsiderohet rritja e investimeve të publikut dhe e kompanive. Ndërsa vetë bankat shprehen se duhet të hiqen trajtimet preferenciale e Bankës së Kursimeve dhe të eliminohet pjesëmarrja me të drejta të padiskutueshme e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, pjesa më e madhe e bankave deklaroi se preferon kërkesat konkurruese për pjesëmarrje.

Më tej, të intervistuarit rendisin dhe një sërë vërejtjesh për tregun sekondar, të cilat arrijnë deri në ekstrem se ky treg nuk ekziston (pyetja 18 – pyetësi II). Është një fakt i mirënjohur se ky treg është i përgjumur. Në të mungojnë ndërmjetësit dhe lojtarët, të cilët do t'i jepnin gjallëri dhe do ta shndërronin në një treg likuid. Po kështu, edhe për këtë treg vërehet mungesë konkurrence. Pohimi më shqetësues është klauzola ligjore, që ekziston, e cila lejon bllokimin e shlyerjes së bonove të thesarit nga ana e Ministrisë së Financave, nëse kjo e fundit e gjykon të përshtatshme. Kjo i jep hapësirë veprimeve arbitrare dhe shton rrezikun e investimit.

Konkludohet që tregu bankar shqiptar është i deformuar, në të ekziston monopoli. Kjo situatë vërehet edhe në tregun e bonove. Të dyja këto tregje, me situatën e tyre, pengojnë zbatimin me efektshmëri të plotë të vendimeve të politikbërësve në ekonomi. Kjo është një arsye e mjaftueshme që autoritetet të zbatojnë masa për nxitjen e konkurrencës. Në këtë pikëpamje, janë mjaft të dobishme masat, që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë për nxitjen e investimit të bankave private në bono, për nxitjen e ndërmjetësimit në lekë të bankave private, për nxitjen e publikut dhe të bizneseve për investimin në bono sidomos nëpërmjet zhvillimit të një fushate njohëse dhe sensibilizuese, marrjen e disa masave për reduktimin e monopoleve dhe eliminimin e deformimeve. Në fund të fundit, përmirësimi i tregjeve do të kthehet në një garanci për sukses në zbatimin e politikës monetare dhe të rregullimit bankar.

Përsa i përket tregut valutor nuk mund të arrihet në konkluzion të vetëm dhe të saktë për shkak të numrit fare të vogël të përgjigjeve (pyetjet 54, 55, 56, 57 dhe 58 – pyetëtori I). Në tërësi vërehet se tregu valutor ekzistues rezulton të jetë i segmentuar dhe i monopolizuar pjesë-pjesë. Duket sikur pranohet ideja e monopolit nga ana e zyrave të këmbimit valutor, nëpërmjet pranimin të pozicionit të “të mëdhenjve”, që përcaktojnë dhe çmimet, pozicioni i cili mund të çojë në pranimin e pozicionit monopol dhe çmimit monopol. Megjithatë, rezulton se zyrat e këmbimit valutor nuk e kanë të qartë procesin e konkurrencës dhe të mekanizmit të vendosjes së çmimit në treg. Ato udhëhiqen nga vendimet instiktive për marrjen e vendimeve.

III.10 – Tregu valutor

Banka e Shqipërisë është institucioni, i cili ka të drejtë të përcaktojë regjimin e kursit të këmbimit si dhe politikën valutore. Këto të drejta i njihen me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Duke patur parasysh këtë dhe ndikimin që ka ose që mund të realizohet nëpërmjet tregut të këmbimeve valutore në funksion të zbatimit të politikës monetare, është me mjaft rëndësi marrja e opinioneve të bizneseve dhe të zyrave të këmbimit valutor, si operatorë tregu, për këtë lloj aktiviteti. Për këtë arsye, në pyetëtorin e parë për këtë treg janë parashikuar një numër i madh pyetjesh.

Nga pyetëtori rezulton se shumë pak nga bizneset e mëdha merren me veprimtari eksporti, tregues ky jo pozitiv, sidomos për veprimtaritë prodhuese (pyetja 30 – pyetëtori I). Nga ana tjetër, firmat që kanë vetëm aktivitet të brendshëm zënë më shumë se 40 për qind të tyre, gjë që tregon karakterin ende relativisht të mbyllur të ekonomisë shqiptare.

Një numër i konsiderueshëm biznesesh deklarojnë se merren me aktivitet këmbimesh valutore (pyetja 31 – pyetëtori I). Interesant gjejmë faktin se nga përgjigjet del se transaksione valutore kryejnë më shumë biznese se sa deklarojnë që merren me eksport-import. Duke ditur që në këtë kategori janë përfshirë edhe zyrat e këmbimit valutor (gjithsej katër), kjo mund të sugjerojë që valuta përdoret edhe për të kryer pagesa të brendshme.

Nga analiza e përgjigjeve (pyetja 32 – pyetëtori I), më shumë se gjysmat e bizneseve, 55.5 për qind, kryejnë transaksione valutore në institucione këmbimi të licencuara. Gati gjysma tjetër kryen veprime të pakontrolluara e të raportuara ose nuk prononcohet. Ndërsa paraqitet pozitiv fakti që pjesa më e madhe e biznesit punon me bankat, konsiderohet i lartë niveli i atyre, që punojnë vetëm me tregun jozyrtar (rreth 1/5 e bizneseve). Deri në këtë nivel informacioni, mund të konkludohet që tregu paralel i valutës është, gjithashtu, i konsiderueshëm në aktivitetin që kryen (kombinimi XVI).

Megjithëse në përmasa jodërrmuese ndërrimi i operatorit të tregut valutor nga firmat evidentohet në përgjigjet e pyetjeve të organizuara për këtë qëllim. Shihet qartë se çmimi, shpejtësia, korrektesa dhe siguria janë arsyt kryesore (pyetjet 33 dhe 34 – pyetësori I) që e bëjnë firmën të ndërrojë operatorin në tregun valutor. Arsyet dominuese paraqiten çmimi dhe shpejtësia. Pra, bizneset ndjekin si koston e drejtpërdrejtë ashtu edhe atë oportune në transaksione të tilla dhe përpiqen t'i minimizojnë ato. Duket që aty ku tregu funksionon edhe bizneset kanë nxitje për administrim më të mirë të aktivitetit (kombinimi XVII).

Rreth gjysma e bizneseve të përgjigjura, 44.5 për qind, kryejnë 3 e më shumë transaksione valutore mesatarisht çdo muaj. Kjo përbën një sinjal për frekuencën dhe magnitudën e këmbimeve valutore në treg (pyetja 35 – pyetësori I). Nisur nga vlera mesatare e transaksioneve (pyetja 36 – pyetësori I - rreth 3.9 transaksione në muaj) të kryera nga secili rast dhe vlerës mesatare për çdo transaksion (rreth 28544 dollarë amerikanë), mund të konkludohet që për një muaj 155 rastet e përgjigjura kryejnë këmbime në vlerë totale mesatare prej rreth 17.3 milionë dollarë amerikanë ose rreth 207.6 milionë dollarë në vit. Nga këto shifra sugjerohet që vlera gjithsej e transaksioneve në tregun valutor shqiptar është disa herë më e madhe duke patur parasysh ekzistencën e operatorëve të tjerë (kombinimi XVIII).

Nga ana tjetër, niveli i lartë i mungesës së përgjigjes tregon jo vetëm mungesën e gatishmërisë për të dhënë vlerësime e për të qenë transparentë, apo mungesën e kulturës bashkëpunuese, por edhe faktin se bizneset nuk e vlerësojnë sa duhet studimin e tregut.

Pavarësisht nga magnituda e transaksioneve valutore, fakti që bizneset përgjigjen, në gati gjysmën e tyre, se kanë humbur ose kanë provuar luhatje të fitimeve si rezultat i tregut valutor, tregon se firmat e biznesit janë nën presionet e luhatjeve të kursit dhe nuk arrijnë gjithmonë të shmangin humbjet. Megjithatë, forma më e përhapur për eliminimin apo reduktimin e humbjeve është ndjekja e shpeshtë e kursit në treg (pyetjet 37 dhe 38 – pyetësori I).

III.10.1. Vlerësimi i tregut valutor nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor

Ky vlerësim ka mjaft vlerë për Bankën e Shqipërisë nisur nga fakti që zyrat e këmbimit valutor janë një operator i rëndësishëm në treg dhe aktiviteti i tyre ka ardhur duke u zgjeruar. Edhe vetë numri i zyrave ka ardhur duke u rritur. Por, në këtë përpjekje Banka e Shqipërisë nuk arriti dot të konkretizojë qëllimin e vet për shkak të nivelit të ulët të përgjigjeve. Katër zyrat, që janë përgjigjur ofrojnë një informacion të pakët dhe të shpërndarë.

Sipas këtyre përgjigjeve:

- në krahasim me tre vjet më parë¹⁷ aktiviteti i zyrave të këmbimit valutor është rritur (pyetja 48 – pyetësi I) dhe pesha e tyre në tregun valutor po ashtu;
- struktura e tregut të valutave dominohet nga dollari amerikan (pyetja 50 – pyetësi I), pavarësisht nga peshat e tregtisë me vendet europiane. Kjo strukturë nuk ka ndryshuar në periudhën kohore 1996 – 1999. Kjo të çon në konkluzionin se ende ruhet tradita e lidhjeve me dollarin amerikan. Megjithatë, prezantimi i euro-s në vitin 1999 dhe nevoja për ambjentim me këtë monedhë të re, mund të ketë ndikuar disi në këtë strukturë, e cila pasqyrohet në vitin 2000 dhe më e plotë në vitet e ardhshme. Prandaj, do të ishte me mjaft vlerë për Bankën e Shqipërisë që kjo pjesë e studimit të tregut valutor të vijojë dhe të eksplorojë më tej;
- konceptimi që zyrat e këmbimit valutor i bëjnë tregut është mjaft konfuz dhe tregu paraqitet i segmentuar. Kjo do të thotë që zyrat punojnë me një klientelë të caktuar të veçuar. Shpërndarja e klientëve në zyra nuk duket të ketë ndryshuar shumë në periudhën 1996 – 1999. Sipas komenteve të bëra, ndryshimet argumentohen me rritjen e numrit të zyrave, me sigurinë e klientit dhe me arsye të tjera. Gjithësesi, një përfundim mund të arrihet, që rritja e numrit të këtyre zyrave mund të ndikojë në një shpërndarje klientësh.

III.10.2. Tregu jozyrtar

Çdo ditë në qendër të Tiranës kryhen transaksione valutore në një treg me operatorë të palicencuar. Edhe përpjekjet, që bëri Banka e Shqipërisë për licencimin e tyre, me kërkesa minimale, nuk patën sukses. Nga ana tjetër, është e nevojshme që të fitohet një ide mbi madhësinë e këtij tregu, funksionimin e tij etj..

Për këtë arsye, u pa e përshtatshme që të kërkohej opinioni i zyrave të këmbimit valutor duke rradhitur tri pyetje rreth kësaj çështjeje. Rezulton se:

- tre vjet më parë vëllimi transaksioneve, që kryenin zyrat me tregun paralel ishte më i madh se sa me bankat (pyetja 45 – pyetësi I);
- tre vjet më pas ky raport ka ndryshuar, ndoshta jo ndjeshëm, në favor të bankave. Kjo mund të jetë arritur nëpërmjet shtimit të numrit të bankave private dhe një agresiviteti më të madh që ato kanë treguar në këtë fushë (pyetja 46 – pyetësi II);
- niveli ditor i transaksioneve në tregun valutor, si vlerë, arrin në një milion dollarë (tre zyra deklarojnë këtë shifër, ndërsa njëra 500 mijë). Me një llogaritje të thjeshtë, duke konsideruar si nivel ditor mesatar shifrën 875 mijë dollarë në ditë, në një vit¹⁸ vlera e transaksioneve është rreth 315 milionë dollarë, shifër kjo mjaft e përafërt me dërgesat vjetore të emigrantëve.

¹⁷ Siç është theksuar dhe në Kapitullin I, me tre vjet më parë kuptohet viti 1996.

¹⁸ Viti merret me 360 ditë.

Ndërsa, sipas raportimeve në Bankën e Shqipërisë, volumi mesatar ditor i bankave dhe i zyrave të këmbimit valutor arrin në rreth 2.5 milionë dollarë ose rreth 2.8 herë më i madh se tregu jozyrtar. Në këtë mënyrë, si një vlerësim i përafërt mund të merret që tregu jozyrtar me atë zyrtar qëndron në raportin 1:3. Nëse shihen të veçuar operatorët, vërejmë që në tregun jozyrtar vëllimi i transaksioneve është më i lartë se vëllimi i transaksioneve të zyrave të këmbimit valutor. Volumi mesatar për një zyrë këmbimi valutor është rreth 620 mijë dollarë amerikanë në ditë. Nga ana tjetër, vëllimi i transaksioneve të bankave, me 1.8 milionë dollarë amerikanë në ditë, është rreth dy herë më i lartë se tregu jozyrtar.

III.11 – Bonot e thesarit

Në zbatimin e politikës së saj monetare, Banka e Shqipërisë ka vërejtur se vendimet e saj transmetohen në mënyrë jo të efektshme dhe me mjaft vonesa në kohë. Kjo krijon vështirësi për arritjen e objektivit të saj. Prandaj, Banka e Shqipërisë është e interesuar për një mirëfunktionim të tregjeve dhe përmirësim të tyre. Përveç tregut valutor, i rëndësishëm paraqitet dhe tregu i bonove të thesarit.

Pasi arrihet në konkluzionin se tregu i bonove të thesarit është i deformuar (shih pikën III.9) dhe i tillë konsiderohet nga vetë bankat, ka mjaft vlerë shkalla e njohjes dhe e vlerësimit të këtij tregu nga bizneset si investitorë potencialë të tij.

Sipas pohimeve të bëra (pyetja 39 – pyetësi I), më shumë se 1/3 e bizneseve më të mëdhenj dhe zyrave të këmbimit valutor në vend nuk dinë ç'janë bonot e thesarit. Më tej, në masë bizneset kanë pohuar se nuk janë të interesuara në këtë lloj investimi (pyetja 40 – pyetësi I); rreth 1/5 e atyre që i njohin bonot mendojnë se investimi në to nuk paraqet interes (kombinimi XIX). Kjo mungesë interesi (pyetja 41 – pyetësi I) është argumentuar kryesisht me pasjen e një kapitali tepër qarkullues, që nuk lejon investim në bono. Është e natyrshme që 40 për qind të këtij grupi e përbëjnë bizneset e angazhuara në aktivitet tregtar. Këto biznese kanë nevojë për kapital likuid dhe kanë norma fitimi, që nuk mund t'i konkurrojnë këto lloj formash të tjera investimi, sidomos në periudhë afatshkurtër (kombinimi XXII). Megjithatë, rreth 20 për qind e të intervistuarve gjithsej nuk kanë dijeni për procedurat (kombinimi XX). Mungesa e qartësisë konfirmohet më tej me përgjigjen e marrë për pyetjen 43 (pyetësi I) ku 84.3 për qind e të intervistuarve shprehen se janë të paqartë për procedurat e pjesëmarrjes në ankande. Lidhur me paqartësinë për kërkesa të tjera specifike vërehet se ka biznese, që nuk dinë vendin se ku duhet të paraqiten, mënyrën se si duhet të paraqiten, kohën kur duhet të paraqiten, fitimin që sigurojnë (pyetja 44 – pyetësi I, kombinimi XXIII) etj.. Nga ana tjetër, edhe nga grupi i bizneseve tek të cilët paraqet interes investimi në bono, nuk ka investuar (kombinimi XXI).

Këto rezultate janë një shpjegim mjaft i mirë i faktit që tregu i bonove të thesarit nuk është i zhvilluar. Si nevojë më e shpejtë del rritja e shkallës së njohjes së këtij tregu, si funksionon, çfarë ofron dhe çfarë sigurohet në të. Është ide e vlefshme ajo që ka nisur të praktikojë Banka e Shqipërisë: zhvillimi i fushatës për bonot e thesarit. Kjo fushatë jo vetëm duhet të intensifikohet, por është e vlefshme që në të të angazhohet edhe Ministria e Financave madje dhe bankat e nivelit të dytë.

Nga ana tjetër, janë të dobishme seminarët dhe gjetja e rrugëve të tjera për shpjegimin e procedurave të ankandëve.

Duhet kuptuar se rritja e numrit të investitorëve në këtë treg, do të ndihmonte për të shtuar konkurrencën dhe reduktuar deformimet, do të afronte më shumë klientë në banka, do të përmirësonte mekanizmin e përcaktimit të çmimit të bonove, do të rriste likuiditetin në treg, do të krijojë mundësi për zhvillim të tregut sekondar dhe atij me pakicë dhe do të krijonte një treg të vlefshëm për zbatimin e politikës monetare.

Vetë bizneset, duke u angazhuar në këtë treg do të kenë mundësi të bëjnë investime me rrezik zero si dhe të administrojnë më mirë fondet e tyre përkohësisht të lira.

III.12 - Të tjera

III.12.1. Shkalla e ruajtjes së informacionit

Në përgjithësi, ekziston opinioni se klientët nuk afrohen në bankë pasi nuk ruhet konfidencialiteti i marrëdhënieve të tyre me bankën. Është e qartë që besimi i klientit se banka ruan konfidencialitetin e tij ndikon shumë dhe në kredibilitetin e bankës. Për këtë arsye u kërkua që të merreshin mendime si nga bizneset ashtu edhe nga vetë bankat.

Bankat gjykojnë (shumica e tyre – pyetja 22 – pyetësi II) se klientët e tyre janë të kënaqur me shkallën e ruajtjes së informacionit. Megjithatë, në shpjegimin e faktit se përse aktiviteti tregtar e prodhues (një pjesë e tij) zhvillohet jashtë sistemit bankar (pyetja 23 – pyetësi II), del si opinion i shprehur nga individët edhe mungesa e konfidencialitetit.

Nga ana e tyre, 24 për qind e bizneseve janë të pakënaqur me nivelin e konfidencialitetit, që ofrohet nga bankat (pyetja 28 – pyetësi I). Ky numër konsiderohet relativisht i madh dhe tregon se bankat nuk e kryejnë mirë ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit mbi klientin. Banka e Shqipërisë mendon se edhe 1 për qind do të ishte i papranueshëm.

III.12.2. Pse një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit prodhues e tregtar zhvillohet jashtë sistemit bankar

Për këtë çështje është kërkuar të merret një mendim profesionist prandaj kjo pyetje (23) është përfshirë vetëm në pyetësin II.

Më sipër u theksua që një arsye është mungesa e konfidencialitetit në marrëdhëniet me bankat. Gjithësesi, ky nuk është opinioni kryesor dhe përfaqësues për të shpjeguar këtë fenomen. Theksi vihet kryesisht në ngadalësinë dhe mungesën e shërbimeve, sistemin e pazhvilluar i pagesave, shmangien e dokumentimit të transaksioneve me qëllim fshehjen e informacionit (evazioni fiskal) si dhe traditën e dobët të trashëguar në marrëdhëniet bankë-klient dhe mentaliteti.

Arsyet janë të shumta dhe të mjafta për të shpjeguar situatën aktuale. Kjo konfirmon edhe një herë konkluzionin e mësipërm që është e nevojshme që bankat tregtare së pari të adoptojnë strategji më agresive për zgjerim të aktivitetit të tyre. Ka nevojë për më tepër publicitet nga bankat dhe Banka e Shqipërisë, me qëllim që të edukohet publiku me bankën, ta njohë ç'është banka, çfarë ofron ajo dhe pse është e vlefshme të punosh me bankën. Banka e Shqipërisë, në zbatim të detyrave ligjore të saj, ka nevojë për më tepër angazhim në përmirësimin e sistemit të pagesave në vend. Së fundi, ka nevojë forcimi edhe të autoriteteve të tjera (doganore, tatimore etj.), dhe rritje të eficiencës së punës së tyre, por jo nëpërmjet zbatimit të masave administrative e arbitrare¹⁹. Këto do të ndikojnë negativisht në afrimin e klientëve në banka. Në fund të fundit duhet të kuptohet që banka është një institucion besimi, jo përmbarimi ku secili klient beson intimitetin pasuror ose financiar të tij.

III.12.3. Marrëdhëniet me punonjësit e bankave

Për të zbuluar sadopak se si u shërbehet klientëve nga punonjësit e bankave, pyetësi i biznesit përmban dhe një pyetje, që kërkon një vlerësim për këtë çështje (pyetja 26). Së pari, vërehet një nivel i lartë mospërgjigjesh për bankat private, 43.5 për qind. Duke patur parasysh që vetëm 11.4 për qind e bizneseve nuk kanë llogari në bankat private (informacion i marrë prej pyetjes 15 – pyetësi I) kjo do të thotë se rreth 1/3 nuk prononcohen për këtë problem. Shumë më lehtë ka qenë vlerësimi për bankat shtetërore ku gjysma e klientëve të tyre, biznese, rezultojnë të kënaqur nga niveli i këtyre marrëdhënieve.

¹⁹ Rasti më i fundit është ai i miratimit të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" që i jep të drejtën kryetarit të degës së tatim-taksave të prekë llogaritë bankare të klientëve, të cilët paraqiten debitorë ndaj detyrimit të tatim-taksave. Sipas nenit 45, të këtij ligji, ky person mund të nxjerrë një vendim ekzekutiv për bllokimin dhe konfiskimin e llogarive bankare, duke përcaktuar, gjithashtu, se ky detyrim është i pari në rradhën e pagesave dhe banka është e detyruar ta zbatojë atë menjëherë. Në rast moszbatimi banka bëhet përgjegjëse për mospagimin e tatimit të papaguar dhe detyrohet ta paguajë atë vetë. Ky ligj, madje, është në kontradiktë me Kodin Civil, i cili parashikon si rradhën e pagimit dhe dispozitat për preken e llogarive bankare.

III.12.4. Niveli i sigurisë që ofrojnë bankat

Ky informacion është synuar të merret për dy grupe bankash: shtetërore dhe private (pyetja 27 – pyetësi I). Vërehet që, në përgjithësi, biznesi shprehet se ndihet më i sigurt me bankat shtetërore. Këtë prononcim biznesi e arsyeton me argumente të tilla si “shteti falimenton i fundit” apo “shteti të rimbursion” dhe “nga privatët u dogjëm”. Gjithashtu, ka edhe arsye të tilla si interesa më të përshtatshme, mosnjohje e privatëve, mungesa e informacionit për privatët, eksperiencia e bankave private është e vogël etj..

Në tërësi, vërehet se ka një besim të trashëguar për bankat shtetërore, i cili shpesh nuk ka një shkak të qartë të lidhur me eficiencën apo cilësinë e shërbimit. Kjo, në njëfarë mase, vepron në dëm të konkurrencës bankare. Prandaj, nëse në tërësi diskutohet që duhet të rritet niveli i publicitetit dhe i transparencës për bankat, për bankat private kjo kërkesë është akoma dhe më e domosdoshme për t’u përmbushur.

Ata që shprehen se ndihen më të sigurt në bankat private shpesh japin argumente të paqarta. Ka nga ata që shprehen se besimi tek bankat private rrjedh nga shpejtësia e shërbimit, nga njohja më e mirë e legjislacionit, nga burokracia më e vogël e deri tek pamundësia e shtetit për të ndërhyrë. Gjithashtu, edhe lehtësimi i bizneseve me kapitale të huaja të caktuara nga banka, që kanë kapital me origjinë nga vendet që vijnë këto kapitale është përmendur shpeshherë.

Në tërësi, siguria tek bankat private rrjedh nga një nivel më i mirë shërbimi. Kjo argumenton më së miri se përse bankat shtetërore nuk duhet të jenë më të tilla.

KAPITULLI IV: KONKLUSIONE DHE PROPOZIME

Paraqitja e rezultateve të vrojtimit e bërë në kapitujt I, II, dhe e konkluzioneve e rekomandimeve për çështje të veçanta në kapitullin III, natyrshëm çon edhe në renditjen e konkluzioneve më të rëndësishme në këtë kapitull. Në përputhje me konkluzionet e arritura, jemi përpjekur të renditim disa propozime, që besojmë se do të jenë të vlefshme për subjektet të cilave u drejtohen.

IV.1 – Konkluzione

Çështjet e trajtuara në secilin prej pyetësorëve dhe ballafaqimi i konsideratave të secilit grup të intervistuarish çon në këto konkluzione:

IV. 1.1. Çelja e bankave shqiptare

Aktualisht, sistemit bankar shqiptar i mungojnë bankat private me kapital shqiptar. Gjasat janë që këto lloj bankash t'i mungojnë vendit edhe për një të ardhme.

- I. Biznesi i madh shqiptar ka një moshë relativisht të re (mesatarisht gjashtë vjet). Gjatë kësaj periudhe ai është angazhuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe atë ndërtimor duke u ambjentuar me norma të larta fitimi dhe qarkullim të shpejtë të kapitalit. Kjo ka ndikuar në krijimin e një kulture biznesi, që priret nga fitimi i lartë dhe i shpejtë, nga njëra anë, dhe duke u bazuar pak në administrimin profesional të biznesit, nga ana tjetër. Në këtë mënyrë, biznesi shqiptar nuk ka prirje dhe interes për t'u angazhuar në biznesin bankar. Atij i mungojnë aftësitë e nevojshme për të administruar një aktivitet të tillë. Po kështu, ende nuk është ambjentuar me idenë që administrimi i aktivitetit, planet investuese afatshkurtra dhe afatgjata për të siguruar qëndrueshmëri në suksesin e arritur deri tani duhet të bazohen në mendimin profesionist.
- II. Biznesi i madh shqiptar, pavarësisht se përfaqëson grupin financiarisht më të fuqishëm ndër gjithë biznesin privat shqiptar, ka në dispozicion kapital të pamjaftueshëm për t'u angazhuar në biznesin bankar. Vetë mënyra e organizimit të tij, kryesisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe më rrallë si shoqëri aksionere, dhe e financimit të aktivitetit, kryesisht me fitimet e veta, e pengon biznesin të grumbullojë shuma kapitali të mjaftueshme për çelje banke.
- III. Biznesi i madh shqiptar nuk krijon banka private shqiptare jo si pasojë e ndikimit të faktorëve të ambjentit si situata makroekonomike, stabiliteti dhe rendi, kuadri rregullativ etj.. Në këtë kuadër, madje, konkludohet që biznesi i njej jokënaqshëm rregullat në fuqi për çelje bankash private. Po ashtu, biznesi nuk ka interes edhe të investojë në bankën shtetërore, që do të privatizohet.

- IV. Banka e Shqipërisë po zbaton një politikë të drejtë licencimi, duke mos bërë diferencime dhe zbutur kërkesat për bankat private shqiptare. Kjo mund të kishte një përfitim në lidhje me krijimin e këtyre bankave. Por, ky përfitim nuk është i sigurt pasi bizneset shqiptare tregohen të paimteresuara për këtë lloj biznesi dhe në tërësi janë shprehur që rregullat e licencimit janë të pranueshme. Nga ana tjetër, zbutja e kërkesave do të thoshte hyrje bankash të reja jocalësore, që do të shtonte problemet në një sistem bankar, i cili edhe aktualisht ka mjaft të tilla.

IV.1.2 - Zgjerimi i aktivitetit bankar

Sistemi bankar shqiptar ende nuk ka arritur ngopjen dhe kërkesa për shërbime bankare do të ekzistojë në nivel të konsiderueshëm edhe për një periudhë të paktën trevjeçare. Kjo ka ndodhur për arsyen se bankat, që kanë vepruar në Shqipëri deri më sot nuk janë paraqitur agresive në planet e tyre duke mos nxitur afrimin e klientëve me bankat. Nga ana tjetër, ka mungesë kulture e tradite në marrëdhëniet e biznesit me bankën.

Ky konkluzion konfirmohet:

- I. nga mosrealizimi i planeve në aktivitetet bazë bankare dhe nga planet agresive të paraqitura nga vetë bankat për zgjerimin e aktivitetit bankar në vitet e ardhshme;
- II. nga planet e vetë bankave për një shtrirje gjeografike më të gjerë;
- III. nga kërkesat që ka biznesi i madh për më tepër shërbime, sportele dhe banka të reja private dhe të huaja;
- IV. nga afrimi i kufizuar i vetë bizneseve me bankat si pasojë e mungesës së kulturës dhe traditës në marrëdhëniet me bankën.

IV.1.3 - Transparenca dhe publiciteti

Në përgjithësi, konkludohet që niveli i publicitetit dhe i transparencës në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë dhe të bankave të nivelit të dytë nuk është i kënaqshëm.

Në tërësi, pranohet që publiciteti dhe reklama e bankave është e pamjaftueshme. Kjo pranohet si nga biznesi ashtu edhe nga vetë bankat. Po kështu, nga përgjigjet e dhëna për çështje të Bankës së Shqipërisë, duket se më tepër publicitet dhe transparencë kërkohet të zbatohet edhe prej saj.

IV.1.4 - Tregu jozyrtar

Në përgjithësi, konkludohet se ekziston tregu jozyrtar për shërbimet financiare (kreditim dhe këmbime valutore), madje është treg me madhësi të konsiderueshme.

Megjithëse, qëllimi i vrojtimit nuk ishte matja e ekonomisë jozyrtare, nëpërmjet disa pyetjeve është siguruar informacion, i cili sjell një ide mbi ekzistencën dhe madhësinë e këtij tregu.

Konkretisht:

- I. bizneset kanë deklaruar se e kanë financuar aktivitetin nëpërmjet huave të marra nga individët dhe me forma të tjera financimi. Niveli i përdorimit të këtij burimi është i krahasueshëm me shkallën e përdorimit të kredisë bankare;
- II. zyrtarët e këmbimit valutor kanë deklaruar me përafërsi se në tregun jozyrtar, vëllimi mesatar ditor i transaksioneve valutore arrin mesatarisht në 875 mijë dollarë amerikanë ose rreth 315 milionë dollarë në vit. Ky nivel është rreth 3 herë më i vogël se sa tregu zyrtar (banka + zyra këmbimi valutor). Ose e thënë ndryshe, tregu bankar është afërsisht i barabartë me tregun jozyrtar dhe atë të zyrtarëve të këmbimit valutor (volumi vjetor i transaksioneve për të gjitha bankat, i raportuar në Bankën e Shqipërisë, arrin në 662.4 milionë dollarë amerikanë dhe për zyrtarët e këmbimit valutor në 222.9 milionë dollarë amerikanë)²⁰. Pra, në Shqipëri kryhet një volum transaksionesh valutore në një vit në masën rreth 1.2 miliardë dollarë amerikanë ose pothuaj i barabartë me volumin e tregtisë së jashtme (për vitin 1999 volumi i tregtisë së jashtme ka qenë 1 213 milionë dollarë amerikanë);
- III. vetë bizneset e mëdha deklarojnë se kryejnë këmbime valutore me tregun jozyrtar (rreth 16.3 për qind e bizneseve të prononcuar për nivelin e transaksioneve që kryejnë). Nëse në një vit këto biznese kryejnë një volum transaksionesh prej 144 milionë dollarë amerikanë, rreth 34 milionë i kryejnë në tregun jozyrtar.

IV.2 – Propozime

Konkluzionet e paraqitura më sipër mbi probleme të zhvillimit të sistemit bankar e shohim të nevojshme t'i shoqërojmë me disa propozime. Këto propozime, në përgjithësi, u drejtohen: bizneseve (përfshi zyrtarët e këmbimit valutor), bankave që veprojnë në Shqipëri dhe vetë Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, ato i drejtohen edhe studjuesve për të mbështetur analizat apo studimet, që mund të kryejnë në fushën e zhvillimeve të sistemit bankar. Synimi është që të renditen disa opinione, të cilat mund të ndihmojnë në zgjidhjen e disa problemeve. Është e qartë që këto propozime janë opinione personale të autorëve dhe nuk detyrojnë askënd për t'i zbatuar. Në këtë kuadër, ato mund të ndihmojnë në kryerjen e analizave të tjera më të thelluara të çështjeve të trajtuara në këtë pyetësor. Po ashtu, shërbejnë si një bazë mjaft e mirë për të trajtuar më tej një problem të

²⁰ Shifrat i përkasin raportimeve të vitit 1999, periudhë në të cilën është bërë vrojtimi dhe të cilës i referohen të intervistuarit.

caktuar në dritën e zhvillimeve të reja, që mund të jenë shfaqur gjatë vitit të fundit (nga momenti kur ka përfunduar procesi i intervistimit).

Për efekt krahasueshmërie edhe propozimet renditen sipas çështjeve me të cilat janë renditur konkluzionet.

IV. 2.1. Çelja e bankave shqiptare

Në kushtet kur konkludohet që biznesi shqiptar nuk është në gjendje dhe i interesuar të angazhohet në biznesin bankar mund të propozohet:

- I. Banka e Shqipërisë të rrisë përpjekjet e saj për të shtuar shkallën e njohjes nga publiku të funksionit të saj si licencuese bankash dhe të angazhohet në fushatë më intensive për të rritur shkallën e njohjes së kërkesave, që ajo ka për licencimin e bankave. Në kapitullin III është parë që ka një korrelacion të fortë pozitiv midis shkallës së njohjes së kërkesave për licencim dhe interesit për të çelur bankë. Kjo sugjeron që duke nxitur rritjen e njohurive mbi kërkesat në fuqi, në këmbim, Banka e Shqipërisë mund të sigurojë më tepër aplikime për çelje bankash;
- II. Banka e Shqipërisë, synimet e saj për zgjerimin e sistemit bankar me banka të reja nuk duhet t'i arrijë në këmbim të zbutjes së kërkesave për licencim apo uljes së cilësisë së përzgjedhjes së bankave të reja;
- III. biznesi shqiptar, për të siguruar një sukses të qëndrueshëm, ka nevojë të të ndryshojë formën e zhvillimit të aktivitetit; të rrisë bashkëpunimin me biznese të tjera duke bashkuar kapitalet; ose të kalojë në shoqëri aksionere me ofertë publike. Kjo do të sjellë më tepër kapital dhe do ta bëjë atë më të përshtatshme për t'u angazhuar në aktivitetin bankar;
- IV. biznesit shqiptar i paraqitet një mundësi e mirë investimi, që është pjesëmarrja në kapitalin e Bankës së Kursimeve, e cila pritet të privatizohet;
- V. autoritetet përkatëse të rrisin shkallën e njoftimit të publikut për privatizimin e Bankës së Kursimeve, ta bëjnë procesin sa më transparent dhe të edukojnë publikun me përfitimet që sjell investimi në aksionet e kësaj banke;
- VI. nxitja e interesit të biznesit shqiptar për të investuar në Bankën e Kursimeve konsiderohet si një mundësi mjaft e mirë për t'i dhënë hapësirë zhvillimit të tregut të kapitaleve.
- VII. nga ana tjetër, nëse oferta publike rezulton e pasuksesshme, pronari aktual duhet të përgatitet që një pjesë të aksioneve, që nuk do të shiten, t'i zotërojë përsëri vetë për një periudhë kohe më të gjatë se sa mund të jetë parashikuar duke u angazhuar për të luajtur rolin e pronarit pasiv për t'i lënë hapësirë pronarëve të rinj që të administrojnë bankën duke eliminuar praktikën e ndërhyrjes së shtetit në dëm të bankës.

IV.2.2 - Zgjerimi i aktivitetit bankar

Në kushtet kur tregu pranon zgjerimin e aktivitetit bankar propozohet:

- I. Vazhdimi i aplikimit të strategjisë së Bankës së Shqipërisë për të lejuar zgjerimin e veprimtarisë bankare në këto drejtime:
 - licencimi i bankave të reja (sidomos bankave universale). Më tepër publicitet duhet bërë për mjedisin ekonomik shqiptar dhe atë ç'ka ofron Shqipëria në tërësi dhe rajone të veçanta të saj për të tërhequr banka të reja;
 - nxitja e zgjerimit të aktivitetit të bankave ekzistuese sidomos në fusha të tilla, që janë konsideruar si problem siç janë kredia etj.;
 - nxitja e zgjerimit të sistemit bankar nga pikëpamja gjeografike. Kjo del mëse e nevojshme, aktualisht, kur bankat shtetërore po privatizohen dhe pritet krijimi i një vakuumi shërbimesh bankare në disa zona;
 - nxitja e zgjerimit të aktivitetit bankar me produkte e shërbime të reja.
- II. Bankat e nivelit të dytë të adoptojnë strategji më agresive si në drejtim të produkteve, që ofrojnë ashtu edhe në drejtim të përzgjedhjes së gjeografisë, apo vendeve ku i ofrojnë këto produkte, duke hequr dorë nga qëndrimi pasiv i vërejtur në tre vitet e fundit. Kjo do të kishte si rezultat afrimin më të madh të klientëve të bankat dhe për pasojë përmirësimin e funksionimit të sistemit bankar.
- III. Bankat e nivelit të dytë do të ishte e dobishme të ofronin më shumë konsulencë për klientët e tyre duke i orientuar ata në vendimet për investim dhe për administrim më efikas të fondeve. Liberalizimi i mëtejshëm i ekonomisë shqiptare do t'i vendosë bankat përballë rrezikut të largimit të një pjese të konsiderueshme të klientëve të tyre. Bankat, në strategjitë e tyre të zhvillimit, duhet të fillojnë të kenë parasysh edhe elementin e konkurrencës me bankat, që veprojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- IV. Biznesi i madh shqiptar duhet të mendojë për një administrim më profesionist të fondeve, që ka në dispozicion. Në këtë mënyrë, nëpër shoqëritë e biznesit ka nevojë që të adaptohet një funksion i ri, ai i ekonomistit financiar, që shqyrton projektet për investim dhe për administrim sa më efikas.
- V. Banka e Shqipërisë të kërkojë zbatimin e planeve të bizneseve, që kanë bërë vetë bankat dhe ta mbikëqyrë vazhdimisht atë.

IV.2.3 - Transparenca dhe publiciteti

Për traditën që ekziston në Shqipëri, nivelin e ulët të marrëdhënieve bankë-klient, publiciteti dhe transparenca gjykohen si elementë tepër të domosdoshëm në zhvillimin e këtyre marrëdhënieve dhe rritjen e shkallës së ndërmjetësimit bankar.

Në këtë kuadër propozohet:

- I. Banka e Shqipërisë, të bëjë përpjekje që të njihet më shumë në publik si institucion: çfarë përfaqëson ajo, çfarë detyrash kryen, pse duhet një institucion i tillë etj.. Një hap i mirë është botimi i materialeve shpjeguese; që destinohen për publikun e gjerë. Megjithatë, të shihen edhe mënyra të tjera për të shtuar publicitetin dhe transparecën.
- II. Banka e Shqipërisë, të bëjë përpjekje për të rritur shkallën e njohjes nga publiku të rregullave që ajo ka miratuar. Jo vetëm botimi i tyre është i vlefshëm, por në rradhë të parë diskutimi i rregullave që në fazën e hartimit me bankat dhe institucione të tjera, që gjykohen të përshtatshme, sipas rastit. Me miratimin e tyre është e nevojshme që Banka e Shqipërisë të marrë edhe rolin e interpretuesit dhe të shpjeguesit për të siguruar një zbatim sa më të mirë të tyre.
- III. Bankat e nivelit të dytë, si hap i parë duhet të botojnë rregullisht bilancet e tyre. Banka e Shqipërisë, nga ana tjetër, duhet të kërkojë zbatim më rigoroz të detyrimeve ligjore për botim bilancesh dhe situatës financiare nga ana e bankave.
- IV. Bankat e nivelit të dytë duhet të rrisin publicitetin për shërbimet, që ato ofrojnë dhe të jenë më transparente për klientët në drejtim të shpjegimit të përfitimeve dhe të kostove, që ka secili klient nga marrëdhëniet me bankat.
- V. Vetë klientët duhet të jenë më të interesuar të punojnë me bankat pasi kjo u jep hapësirë për të përdorur më shumë shërbime, në rradhë të parë për të përdorur kredinë bankare dhe për të lehtësuar dhe rritur efikasitetin në drejtimin e një biznesi.

IV.2.4 - Tregu jozyrtar

Përballë ekzistencës së tregjeve jozyrtare me madhësi të konsiderueshme, vlerësohet që duhet të angazhohen disa autoritete shtetërore për kontrollin e zvogëlimin e tyre. Megjithatë, në funksion të rritjes së efektivitetit të politikave dhe vendimeve të veta, Banka e Shqipërisë ka nevojë:

- I. të studjojë këto tregje për të zbuluar format e ekzistencës së tyre dhe madhësitë;
- II. të rekomandojë, mundësisht, mënyra për të reduktuar veprimin e tyre;
- III. të koordinojë me autoritete të tjera për të siguruar zbatimin e rregullave në fuqi;
- IV. të kërkojë nga bankat e nivelit të dytë zbatimin e planeve, që kanë për të ardhmen dhe rritjen e veprimtarisë së tyre për të konkurruar tregjet jozyrtare. Për shembull, aktiviteti i shtuar i shfaqur në fushën e këmbimeve valutore ka bërë që të ulët vëllimi i transaksioneve me tregun jozyrtar të këmbimeve.

IV.2.5 - Të tjera propozime

Banka e Shqipërisë, për të përmirësuar punën e saj analizuese e shpjeguese të fenomeneve ekonomike, për të hartuar politika e marrë vendime sa më të drejta dhe për të siguruar zbatim efikas të tyre, në mungesë të informacionit statistikor të besueshëm, të plotë e në kohë, ka një rrugëzgjdhje mjaft të vlefshme: organizimin e vrojtimeve. Këto vrojtime është e nevojshme të kryhen për çështje nga më të ndryshmet dhe sipas nevojave, që dalin si për shembull, vrojtimi i sjelljes së klientëve, i besimit dhe i pritshmërive të biznesit, i ekonomisë jozyrtare, sjellja e qytetarëve shqiptarë në drejtim të konsumit dhe të kursimit etj.. Kjo i siguron një bazë të nevojshme të dhënash në të cilën të mbështetet për vendimet e saj.

ANEKSET

ANEKS I: PYETËSORËT E SHPËRNDARË

I.1 Pyetësoni i parë- Pyetësoni për biznesin (200 bizneset më të mëdha dhe zyrat e këmbimit valutor)

PYETËSORI PËR BIZNESIN	
Të përgjithshme	
I. Cila është forma e regjistrimit të biznesit tuaj: 1. Sh.p.k 2. Sh.a (shoqëri anonime) 3. Tjetër (specifiko)	<input type="checkbox"/>
II. Cila është forma e pronësisë së biznesit tuaj: 1. Me kapital tërësisht shqiptar 2. Me kapital të huaj 3. Me kapital të përbashkët (<i>shqiptar dhe të huaj</i>)	<input type="checkbox"/>
III. Cili është lloji i aktivitetit tuaj: 1. Prodhim 2. Tregti 3. Shërbime 4. Ndërtim 5. Tjetër (specifiko)	<input type="checkbox"/>
IV. Në çfarë viti është themeluar biznesi juaj aktual? 19__	

Rubrika e I: pyetjet nga 1 deri 10 (niveli i njohurive dhe mundësitë e biznesit për të çelur një bankë.)	
1. A e dini se lejohet çelja e bankave private në Shqipëri? 1. PO 2. JO	<input type="checkbox"/>
2. A keni menduar ndonjëherë të çelni një bankë? 1. PO 2. JO	<input type="checkbox"/>
3. Nëse JO, cila është arsyeja: 1. nuk keni kapital të mjaftueshëm 2. nuk e shihni si biznes fitimprurës 3. nuk keni specialistë të kësaj fushe 4. nuk e njihni këtë lloj biznesi 5. të tjera (specifikoni) _____	<input type="checkbox"/>
4. A e dini cili është institucioni, që jep licencën për bankë? 1. PO 2. JO Nëse PO cili:	<input type="checkbox"/>

<p>5. Çfarë kërkesash njihni për çeljen e një banke?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. kapitali minimal 2. deklarimi i burimit të të ardhurave 3. krijimi i ambjenteve të përshtatshme 4. plani i biznesit 5. administratorë të kualifikuar 6. kërkesa për raportin financiar sekret 7. hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme 8. nuk njih asnjë kërkesë 	<input type="text"/>
<p>6. Nëse i njihni, si ju duken ato ?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. konservatore 2. të përshtatshme 3. liberale 	<input type="checkbox"/>
<p>7. A ndjeni nevojën për më shumë informacion rreth kërkesave për çeljen e një banke të re?</p> <p>1. PO 2. JO</p>	<input type="checkbox"/>
<p>8. A do të ishit të gatshëm të blenit aksione të bankave shtetërore të privatizuara, nëse ju ofrohen?</p> <p>1. PO 2. JO</p>	<input type="checkbox"/>
<p>9. Nëse JO, cila është arsyeja?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. nuk e shihni si alternativë të mirë investimi 2. nuk keni dijeni për procedurat 3. tjetër (specifikoni shkurt) _____ 	<input type="checkbox"/>

Rubrika e II: pyetjet nga 10 deri 60 (informacion plotësues rreth nivelit të shërbimeve, që ofrojnë bankat dhe sa i përgjigjet ky nivel kërkesave të klientëve).

<p>10. Cili është burimi i financimit të biznesit tuaj?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fitimet tuaja 2. Firma të tjera 3. Individë 4. Kredia nga bankat 5. Parapagimi i porosisë 6. Të tjera (specifiko) 	<input type="text"/>
<p>11. A keni kërkuar kredi nga:</p> <p>1. Bankat shtetërore: (a) PO (b) JO</p> <p style="padding-left: 100px;">Nëse JO pse:</p> <p>2. Bankat private: (a) PO (b) JO</p> <p style="padding-left: 100px;">Nëse JO pse:</p>	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
<p>12. A e keni përfutuar atë?</p> <p>1. PO 2. JO</p>	<input type="checkbox"/>
<p>13. Si u janë dukur procedurat e marrjes së kredisë:</p> <p>1. në bankat shtetërore: (a) burokratike (b) normale</p> <p>2. në bankat private: (a) burokratike (b) normale</p>	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
<p>14. Si u janë dukur kushtet (termat) e kredidhënies nga:</p> <p>1. bankat shtetërore: (a) të favorshme (b) të pafavorshme</p> <p>2. bankat private: (a) të favorshme (b) të pafavorshme</p>	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>

<p>15. A keni llogari të shoqërisë pranë:</p> <p>1. bankave shtetërore: (a) PO (b) JO</p> <p>2. bankave private: (a) PO (b) JO</p>	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
